

# GAZETA SHQIPTARE



Kryeredaktor: Erl MURATI  
Zv/kryeredaktore - Rezarta DELISULA  
Tel:(04)2359-104, Fax:(04) 2359-116 E-mail:gazetashqiptare@hotmail.com



Viti XXIV - Nr. 7689 E enjte 25 Tetor 2018 Çmimi, 50 lekë (1.5 euro)

Opinion

Ditës

Risi arsimore të këtij viti: nota 7 si Rkushit për t'u formuar si mësues dhe rimbursimi me vlerën e 1000 dollarëve për studentët ekselentë të mësuesisë ...

Vijon në faqen 20

Nga PELLUMB KARAMETA

Mësuesit e të ardhmes, pse na nevojiten dhe pse nuk i kemi?



Opinion

Ditës

Është një betejë dëshpëruese, për-pjekja që bën kryeministri për të dekriminalizuar shpifjen përmes paketës "antishpifje" me shumicën e kartonëve ...

Vijon në faqen 21

Nga ILIR ÇUMANI

Shpifja, gaztorë dhe triumfatorë



Të afërmit: Sherri, kur po qëronin peshk

## Drama në Fier, 10-vjeçari vret me thikë vëllain 13 vjeç në oborr

Fëmijët shkonin rrallë në shkollë. Dhimbja e gjyshit: Isha në spital kur sollën nipin...

FIER - Një sherr mes dy vëllezërve të mitur ka përfunduar në tragjedi. Në zënkë e sipër, 10-vjeçari ka goditur me thikë për vdekje vëllain e tij më të madh. Ngjarja e rëndë ku humbi jetën 13-vjeçari Gj. Veizaj ka ndodhur paraditen e djeshme në fshatin Baltëz të Fierit. Mësohet se djali është dërguar me urgjencë në spitalin rajonal të Fierit ...

Në faqen 9

## PERGJIMET/ "VELLAI I ISH-DEPUTETIT ARBEN NDOKA DHA PARA NE FUSHATE"

# PROKURORIA: TE ARRESTUARIT BLENE VOTA PER PS ME 2017

Gjykata liron 10 nga 34 të arrestuarit e operacionit "Vol-Vo 4". Mbeten në burg dy ish-deputetët, avokati Maks Haxhia: Proces i montuar nga prokuroria



(Në foto) Seanca e djeshme në Gjykatën e Krimeve të Rënda

Në faqen 2-3

NDERTIMI I RRUGEVE

Rama entuziast: Aprovim kontratës për "bypass"-et e Fierit dhe Vlorës

Në faqen 5

OPOZITA

Basha: Zgjedhje të parakohshme. Noka: Është prerë fleta e arrestit të Dakos

Në faqen 4

UNIVERSITETI

Studentët në Vlorë:

Po na zhvasin, 8 mijë lekë për një plan mësimor

Në faqen 11

INTERVISTA

Miratimi i statusit, minatorët lajmërojnë protesta: Faj kanë edhe sindikatat

Në faqen 10

TERRORI



Pako-bomba në CNN dhe shtëpitë e Sorosit, Obamës dhe Klintonit në SHBA

Në faqen 15

Bujar Alimani kthehet "duarplot" në Varshava: Ç' mendoj për shembjen e Teatrit

## "Delegacioni", një film i çmuar përtej amanetit

Regjisori që mori "Grand Prix" rrëfen sfidën e prodhimit dhe reagimin

NGA FATMIRA NIKOLLI

Të bësh në jetë atë që bën në artin tënd. Kjo është fraza e parë që më erdhi në mendje, pasi kam marrë përgjigjen për një prej pyetjeve drejtuar regjisorit shqiptar që sjell në atdhe një çmim të parë europian prej një gare të kat-



egorisë A. "Rezistenca intelektuale!" - më thotë si përgjigje Bujar Alimani, kur e pyes për atë linjë të parë që mbase nuk thuhet me zë të lartë, por është aty pas çdo skene e pas çdo dialogu në filmin "Delegacioni", i vlerësuar me "Grand Prix" në Festivalin ...

Në faqen 18-19

# OPERACIONI I POLICISE MASA E SIGURISE

74-vjeçari i prangosur humb ndjenjat në sallë. Detyrim paraqitje për 2 gratë

Klodiana Lala

Dikur zinin vendet në sallën e parlamentit si të besuarit e popullit, por këtë të mërkurë Arben Cuko e Arben Ndoka u ulën në sallën e gjyqit jo thjesht si persona në konflikt me ligjin, por të dyshuar si pjesë e një grupi të strukturuar kriminal. U gjendën përkrah njëri-tjetrit jo për shkak të miqësisë si ish-kolegë që i bashkonte e njëjta bindje politike, por të detyruar nga rrethanat. Ish-deputeti i Lushnjës, si i dyshuar për korrupsion për transferimin e një të dënuari kur mbante detyrën e drejtorit të Përgjithshëm të Burgjeve. Ndërsa lezhjani Ndoka, i dyshuar se falsifikoi dokumente e nëpërmjet tyre përvetësoi sipërfaqe të mëdha toke në Lezhë e Kurbin. Pavarësisht akuzave që rëndojnë mbi ta, ish-ligjvënësit socialistë kanë një të përbashkët: ranë në rrjetën e përgjimeve kur Prokuroria për Krime të Rënda gjurmonte prej dy vitesh shijakasin e fisit Avdyli, të cilët dyshohen si krerët e një organizatore kriminale që trafikonte kokaine, heroinë dhe hashash. Përpara Gjykatës për Krime të Rënda, të dy këmbëngulën që çështja të veçohet nga Avdyllët, duke argumentuar se nuk i lidh asgjë me ta. Ndoka shkoi edhe më tej duke kërkuar që dosja e tij të mos shpyrtohet nga Krimet e Rënda me argumentin se nuk është kompetente. Porse duhet t'i përcillet prokurorisë së Lezhës, qyteti ku lindi dhe u rrit. Kërkesat e tyre u rrëzuan nga gjykatësi Bib Ndreca dhe më pas vijoi procesi, që u zhvillua me dyer të mbyllura, por sigurisht që mes debateve të ashpra nuk u la jashtë vëmendjes edhe media, e cila u akuzua se nxori detaje nga dosja hetimore. Polici i arrestuar Ardit Gjyriqi bëri debat të ashpër me prokurorët, u kërkoi llogari përse ishte arrestuar. Shkoi edhe më tej, kur me ironi iu drejtua përfaqësuesve të institucionit të akuzës me pyetjen: "A nuk keni turp që më keni arrestuar"? Në vijim seanca u ndërpre edhe dy herë të tjera: herën e parë kur Vlash Gazulli, 74 vjeç, i implikuar në grupin kriminal të tjetërsimit të pronave humbi ndjenjat në kafazin e xhamtë e herën e dytë kur Mimoza Ndoka, motra e ish-deputetit Arben Ndoka u lejuua nga gjykata të linte sallën e gjyqit për pak minuta për të ushqyer foshnjën me gj. Më pas, të gjithë të dyshuarit hodhën poshtë akuzat dhe kërkuan lirirë. Nuk munguan as akuzat politike. Genc Zeneli shënjestroi prokurorët. "Nuk jam arrestuar për shkak të bindjes suaj si prokurorë, por ju morët urdhra nga Edi Rama", u shpreh ai. Për këtë të dyshuar gjatë seancës u zbulua edhe një çudi. Ai rezultoi sipas një kontrate fiktive shit-blerjeje prone të jetë i martuar me shtetasen Lule Zeneli, ish-punonjëse hipoteke, gjithashtu e arrestuar në kuadër të organizatës kriminale,



Një seancë maratone që ka zgjatur 10 orë, e shoqëruar me kundërshti nga ana e avokatëve. 24 nga 34 të pandehurit e çështjes "Avdyllaj" kanë mbetur në arrest me burg, mes tyre Arben Cuko dhe Arben Ndoka. Gjykatësi Bib Ndreca i ka kërkuar falje motrës së Ndokës, Mimoza duke i thënë se nuk kishte dijeni se kishte një fëmijë disa muajsh që e ushqente me gj. Maksim Haxhia tha se, "gjykata nuk ka bërë asgjë më shumë se noterinë e Prokurorisë. Ka pasur shkëputje të seancës në mënyrë që Mimoza Ndoka të ushqente fëmijën. As në kohën e komunizmit nuk ka ndodhur që të arrestojnë një nënë me foshnje për falsifikim dokumentesh", tha Maksim Haxhia. "Aty janë futur 44

tuar për shkak të bindjes suaj si prokurorë, por ju morët urdhra nga Edi Rama", u shpreh ai. Për këtë të dyshuar gjatë seancës u zbulua edhe një çudi. Ai rezultoi sipas një kontrate fiktive shit-blerjeje prone të jetë i martuar me shtetasen Lule Zeneli, ish-punonjëse hipoteke, gjithashtu e arrestuar në kuadër të organizatës kriminale,

## "Akuza skandaloze, personat s'kanë lidhje me njëri-tjetrin" "Shpërthen" avokati Maksim Haxhia: Proces i montuar nga Prokuroria, gjykatësi qesharak



veta në sallë dhe imagjinoni si shkoi procesi. Ajo që ishte më qesharake na bëjnë ne me dije se është i montuar nga organi i Prokurorisë. Gjyqtari i çështjes tha që nuk e dija që Mimoza Ndoka ishte me fëmijë të vogël.

por në të vërtetë ata nuk janë bashkëshortë. Procesi zgjati të paktën shtatë orë. Kundër prokurorisë nuk dolën vetëm ish-deputetët, por edhe pjesëtarët e fisit Avdyli e të dyshuarit e tjerë. Në fund, gjykatësi Bib Ndreca u tërhoq për vendim. Në dhomën e këshillimit, ai vnoi të paktën 3 orë të tjera. Gjykatësi Bib Ndreca nga 34

OPERACIONI "VOL-VO 4"	
■ EMRAT QE U LANE NE BURG	■ NE "ARREST SHTEPIE"
1.Hajri Seferi	1.Bledar Koci (arrest shtëpie)
2.Jasin Kala (alias Jasin Avdyli)	2.Lule Zeneli (arrest shtëpie)
3.Shkelqim Avdyli	3.Luigj Paloka (arrest shtëpie)
4.Astrit Avdyli ( alias Sulejmani)	4.Kol Lleshi (arrest shtëpie)
5.Saimir Gjepali	5.Vlash Gazulli (arrest shtëpie)
6.Altin Avdyli	6.Zef Ndoka (arrest shtëpie)
7.Jasin Avdyli	7.Vasil Nika (arrest shtëpie)
8.Fatos Llaftiu	8.Genc Zeneli (arrest shtëpie)
9.Denis Llaftiu	■ DETYRIM PARAQITJE
10.Esat Mehmeti	1.Mimoza Ndoka (detyrim paraqitje)
11.Saimir Sulejmani	2.Marjeta Perskura (detyrim paraqitje)
12.Elis Guri	
13.Ilirjan Prifti	
14.Petro Kuci ( alias Abedin Kuci )	
15.Ardit Gjyriqi	
16.Elton Shehaj	
17.Armand Spiro	
18.Arben Cuko	
19.Zef Lazri	
20.Artur Balla	
21.Arben Ndoka	
22.Gjevi Ndoka ( alias Xhevair)	
23.Bledi Ndokaj	
24.Paulin Simoni	
25.Zef Lazri	

fakte që s'kanë të bëjnë me të vërtetë dhe përgimët. Po ta shikoni dhe vetë procesin që është i montuar nga organi i prokurorisë. Po të shihnin bisedat telefonike, Cuko ka thënë që i dënuari nuk do lëvizë, sepse mund të bëhen pishllëqe", tha Haxhia. Prokuroria foli për zyrtarë të lartë të shtetit që janë përgjuar, a ka njëzë të politikës të përgjuar?  
"Jemi larg kësaj situatë. Në 13 dosjet e çështjes nuk ka absolutisht asnjëri. Nëse ka të fshehura, nuk e di", u shpreh Haxhia.

të dyshuarit, vendosi të lirojë Mimoza Ndokën, për të cilën prokuroria u tërhoq duke kërkuar masën e detyrimit për paraqitje, gjithashtu u lirua edhe e dyshuara Marjeta Perskura. Në "arrest shtëpie" u dërgua i moshuari Vlash Gazulli dhe të dyshuarit Vasil Nika dhe Luigj Paloka, për të cilët gjithashtu ishte institucionit i

akuzës që kërkoi zbutjen e masave. Gjykatësi vendosi të zbusë masën e sigurisë nga "arrest me burg" në atë të "arrestit në shtëpi" për të dyshuarit Bledar Koci, Lule Zenelin, Kol Lleshin, Zef Ndoka dhe Genc Zeneli. Të tjerët, mes tyre edhe ish-deputetët Ndoka dhe Cuko me pranga në duar u shoqëruan drejt qelive.



Dje në gjykatën e Krimeve të Rënda gjatë masës së sigurisë

### BILANCI

Policia: Numrat, 300 të arrestuar vetëm për 1 muaj

Drejtori i përgjithshëm i Policisë, Ardi Veliu tha dy ditë më parë se gjithsej janë arrestuar në kuadrin e këtij operacioni mbi 300 persona në kontrollet proaktive në territor. "Ndër ta, rreth 160 persona të identifikuar me precedentë apo prishës të rendit, të konsideruar si "të fortë" janë ndaluar apo arrestuar, ndër ta rreth 70 vetë për armëmbajtje pa leje. Gjithashtu, janë kapur e arrestuar 154 persona për të cilët ka pasur një urdhër kërkimi kombëtar dhe 14 të tjerë në kërkim ndërkombëtar, për vepra të ndryshme penale. Ndër provat e sekuestruara gjatë kontrolleve të ushtruara ndaj tyre në akset rrugore, banesa, lokale etj., janë sekuestruar 43 armë zjarri të llojeve të ndryshme, automjete dhe një sasi e konsiderueshme parash. Policia e Shtetit, duke përfutur nga rastit kërkim ndjesë, nëse në ndonjë rast kontrollet e ushtruara në ambiente publike krijojnë shqetësim, por e konsiderojmë me shumë rëndësi venien para përgjegjësive ligjore të personave që tentojnë të sfidojnë autoritetin e shtetit, nën petkun e "të fortit". Nuk ka fortë përballë autoritetit të ligjit!", deklaroi Veliu.






Përgjimet/ Implikimi i vëllait të Arben Ndokës në fushatën e vitit të kaluar

# Prokuroria: Të arrestuarit blenë vota për PS-në në zgjedhjet e 2017

"Gjevi Ndoka ofroi të holla për të votuar PS-në"

**N**ga përgjimet e pjesëtareve të familjes Ndoka, të arrestuar për tjetërsim pronash në Lezhë, prokuroria ka regjistruar edhe biseda ku flitej për blerjen e votave në zgjedhjet e vitit 2017. Më saktë, ka qenë Gjevi Ndoka, vëllai i ish-deputetit të PS-së që siç ka rezultuar nga përgjimet, merrej me blerjen e votave në Lezhë.

Lapsi.al ka veçuar një pjesë të dosjes, ku është regjistruar kjo e dhënë. "Po ashtu nga përgjimet e telefonave celular në përdorim të shtetasit Gjevi Ndoka evidentohet se ky shtetas në bashkëpunim me persona të tjerë si para dhe gjatë fushatës zgjedhore për zgjedhjet parlamentare në Republikën e Shqipërisë të vitit 2017 është përfshirë në mënyrë aktive duke ofruar dhe dhënë të holla (para) zgjedhësve për të votuar kandidatët për deputet nën siglën e Partisë Socialiste, të dhëna këto që dalin nga përgjimet ku për dokumentimin e fakteve" shkruhet në dosje.



Faksimile e përgjimeve të Gjevi Ndokës

kryesisht të ZRVPP-së Lezhë, Kurbën, në prefekturë, ALUIZNI, noterë etj., ku nga transkriptimi i përgjimeve (dhe një sërë provash të sekuestruara më pas) kanë rezultuar të dhëna për përfshirjen e Gjevi Ndokës dhe disa personave të tjerë në falsifikimin e dokumentacionit, ku në bashkëpunim me njëri-tjetrin bëjnë tjetërsimin e pasurive

nga shtetërore në private (kryesisht në emër të tyre apo të personave të tjerë duke përfutur në finale në mënyrë të parregullt pasurinë shtet me dokumente të falsifikuara). Bashkëpunimi në këtë veprimtari kriminale (e gjitha kjo në kuadër të grupit të strukturuar kriminal) vijon që me përcaktimin e parcelës, e cila është

me pronësi shtet, gjetjen e personave të interesuar për t'u pajisur me tokë, falsifikimin e dokumenteve (që nga origjina e pronës deri të certifikata e pronësisë) dhe më pas në aktin final, përfuturimin në mënyrë të parregullt të këtyre sipërfaqeve të tokës, ku shpeshherë përfuturimi final është vetë Gjevi Ndoka, lidhjet e tij shoqërore dhe familjarët e tij.

**FENOMENI: Ç'THOSHTË PREÇ ZOGAJ**

Ish-kandidati i PD në Lezhë, Preç Zogaj, i cili nuk arriti të futej në parlament, pas renditjes i katërti në listë, shkruante në 2017 për një bisedë me një kambist në qytet, i cili i kishte thënë se "në dhjetë ditët e fundit të fushatës ai këmbëu 800.000 euro, një shumë e barabartë, me punën e dy viteve".



**Bashkëpunëtorët e Ndokës për tjetërsimin e pronave**

**N**ga provat rezultojnë se ndër të tjera, personat kanë bërë ndërhyrje në dokumentacionin e disa pasurive të paluajtshme, ndër to në pasuritë me nr. 1018, 2513, 540, 4476, 131 C indeksi etj. Si bashkëpunëtorë të të dyshuarit Gjevi Ndoka punonjës në zyrat vendore Lezhë, deri më tani ndër të tjerë rezultojnë shtetasit: Eraldo Smaçi, Bledar Cara, Bled Ndoka (Shkodran), Lule Zeneli. Ndërsa personat, të cilët kanë përfutur sipërfaqe tokë nëpërmjet dokumenteve të falsifikuara dhe në kundërshtim me ligjin nr. 7051, datë 19.07.1991, të identifikuar deri më tani rezultojnë shtetasit: Kol Zef Lleshi, Vlash Gazulli, Zef Ndoka, Mimoza Ndoka, Paulin Simoni dhe Vasil Nika. Gjevi Ndoka ka bërë të mundur të sigurojë akte të marrjes së tokës me pronësi në emër të shtetasve Kol Lleshi, Vlash Gazulli, Zef Ndoka, të cilat mbajnë data fiktime për periudhën e përpilimit dhe lëshimit të dokumenteve dhe pasi kanë plotësuar praktikat përkatëse me dokumente të falsifikuara, me ndihmën e personave të tjerë punonjës në ZVRPP, kanë arritur të regjistrojnë pasuri në sipërfaqe të konsiderueshme në emër të tyre dhe personave të tjerë dhe më pas i kanë tjetërsuar, duke bërë shitje dhe blerje fiktime, pranë zyrave noteriale të noterët, shtetasi Emanuel Gjura dhe punonjësi i kësaj zyre shtetasi Zef Lazri etj.

**FALSIFIKIMET**  
Personat, të cilët kanë përfutur sipërfaqe tokë nëpërmjet dokumenteve të falsifikuara dhe në kundërshtim me ligjin nr. 7051, datë 19.07.1991, të identifikuar deri më tani rezultojnë shtetasit: Kol Zef Lleshi, Vlash Gazulli, Zef Ndoka, Paulin Simoni dhe Vasil Nika.

Duhet thënë se Arben Ndoka nuk kandidoi në zgjedhjet parlamentare të vitit 2017, pasi nuk ia lejonte ligji për dekriminalizimin. Por ai u shfaq hapur në fushatë përkrah kandidatëve socialistë dhe nuk e fshehu angazhimin në takimet me qytetarët. Asokohe opozita e akuzoi Ramën se nuk i kishte shkëputur marrëdhëniet nga Arben Ndoka, subjekt i ligjit për dekriminalizimin, por, siç tregon ky zbulim i prokurorisë, kostot që mori në zgjedhje nga ky denoncim, Edi Rama i kompensonte me votat e blera nga ish-deputeti i tij.

**DOSJA E PROKURORISË**

Nga provat e paraqitura së bashku me kërkesën rezultojnë se Gjevi Ndoka ka qenë i punësuar si zyrtar lokal në Prefekturën Lezhë. Gjatë kësaj kohe (pas vitit 2013), ai ka krijuar lidhje si shoqërore ashtu edhe varësi hierarkike në punë me disa punonjës të zyrave në ZRVPP Lezhë. Por ai rezultojnë se këto lidhje i ka krijuar edhe me punonjës të ALUIZNI-t, noterë etj.

Personi në fjalë rezultojnë të ketë komunikuar me shumë persona të tjerë të administratës shtetërore

**Prokuroria: Kërkoj që të kthehej në "pronë shtet"**

**Përgjimet e Arben Ndokës, përplasje me familjarët për tokat në bregdet**

**N**ga transkriptimi i përgjimeve në dosjen e prokurorisë, rezultojnë se ka nisur një konflikt i rëndë nga anëtarë të familjes Ndoka, kjo për një pronë bregdetare me një sipërfaqe prej 4500-5000 m<sup>2</sup>. Nga të dhënat e përfuturara gjatë hetimeve rezultojnë se pronar defacto ka qenë Arben Ndoka, i cili kishte idenë se edhe juridikisht do të ishte kaluar në emër të tij nga anëtarët e familjes.



Ndoka duke pasur idenë se anëtarët e tij të familjes kishin dalë nga rregullat "kanunore" familjare është acaruar dhe ka akuzuar vëllain më të madh të ndjerin Aleksandër Ndoka. Duke qenë se pronën që realisht duhet të ishte në emër të tij i është dhënë pa ndonjë shpjegim dhëndrit të Aleksandrit. Kujtojmë se shtetasi Aleksandër Ndoka, vëllai i ish-deputetit PS, mbeti i vrarë me armë zjarri më 9 dhjetor të 2017.

"Balkanweb" shkruan se Arben Ndoka ka kërkuar logari si nga familjarët e tij

ashtu edhe nga punonjësit në zyrat përkatëse shtetërore që prona objekt konflikti duhej kthyer me patjetër në pronë shtet, pastaj e dinte ai se si të vepronte për ta marrë. Kështu ai debaton me Gjevi Ndokën, Mimoza Ndokën, Bardhok Bardhi, inxhinier dhe Bledar Cara kushëri i tyre që punon në hipotekë. Në dosje tregohet shqetësimi që kishte sidomos Mimoza dhe Gjevi pasi kishin frikën e ndonjë përplasjeje fizike ndërmjet vëllezërve Aleksandër dhe Arben Ndoka.

## QEVERISJA AKUZAT

Vendimi i parë, anulimi i koncesioneve abuzive, prezantohen 3 pikat e programit për bujqësinë

# Qeverisja e re, Basha: Zgjedhje të parakohshme me ato vendore

"500 mln euro vidhen nga oligarkët"

Valentina Madani

Opozita kërkon që me zgjedhjet vendore të 2019-ës, të zhvillohen edhe zgjedhjet e parakohshme si emergjencë për krijimin e një qeverie të re e cila të bëjë të mundur shkëputjen e lidhjeve të krimit me pushtetin. Në takimin me fermerët të Vaut të Dejës, lideri i opozitës dje iu rikthye propozimit të hershëm të tij duke e parë si mundësi mbajtjen në të njëjtën ditë të zgjedhjeve të përgjithshme të parakohshme, me ato lokale. Sipas tij zgjedhjet e vitit të ardhshëm janë një test i madh për vendin. Basha prezantoi edhe 3 shtyllat kryesore të Partisë Demokratike për bujqësinë. Kreu i demokratëve hodhi akuzat ndaj mazhorancës, që sipas tij, po e çojnë vendin drejt gremisë, duke menduar për veten dhe oligarkët e saj. "Një test i madh po afrohet: vitin e ardhshëm do të kemi zgjedhjet vendore, të cilat mund të jenë fare mirë në të njëjtën kohë edhe me zgjedhjet e përgjithshme të parakohshme. Do të jenë një shans i jashtëzakonshëm që ju të ushtroni të drejtën që keni për të vendosur se çfarë qeverisje doni. Unë jam këtu për t'u komunikuar bindjen time se gjithë problemet mund të zgjidhen nëse ushtroni me mençuri të drejtën e zgjedhjes së drejtuesve të duhur si në nivel lokal edhe qendror", theksoi z.Basha. Duke i kërkuar shkodrancëve që të tregohen të zgjuar kur zgjedhjet të trokasin, Lulzim Basha u zotua se vendimi i parë kur të vijë në pushtet, do të jetë anulimi i kontratave dhe koncesioneve abuzive, të cilat, sipas Bashës, do i nënshtrohen ligjit antimafia. "Kontratat korruptive do anulohen dhe paratë që shkojnë për 10 veta apo 10 foka, do përdoren për prioritetet tona, mbështetja e bujqësisë dhe rinisë, përmes stazheve të punës", tha Basha. Kryetari demokrat, gjithashtu, akuzoi qeverinë për diskriminim e bashkive, që drejtohen nga e djathta. Kreu i PD-së, Lulzim Basha, në një status në Twitter, ritheksoi se vendi nuk ka më as kryeministër, as policë e as gjykatë. Sipas tij Shqipëria udhëhiqet nga një tufë politikanësh banditë që po mbajnë peng vendin. Megjithatë, ai shprehet se përballja me popullin është e pashmangshme dhe se fundi i diktaturës së krimit është afër. "Shqipëria nuk ka më as kryeministër, as Kuvend, as prokurorri, as policë, as gjykatë as qeveri, por një tufë politikanësh banditë që kanë kapur shtetin dhe marrë peng vendin. Përballja me popullin është



Kreu i PD-së, Lulzim Basha

## "Në krye të burgjeve, një përfaqësues i PS"

Bardhi: Emërimi i drejtorit të ri të burgjeve, në shkelje me ligjin

Këshilltari Ligjor në PD, Gazment Bardhi, denoncoi emërimin politik të drejtorit të ri të burgjeve, Bardhi akuzoi qeverinë Rama se po shkel në mënyrë flagrante ligjin, duke emëruar persona të politizuar në krye të burgjeve. "E vetmja meritë e Drejtorit të ri të Policisë së Burgjeve, i prezantuar me bujë nga Edi Rama, është shërbimi partiak për PS. Bardhi i Kaçorri ka qenë kryetar i KZAZ 27 në Tiranë si përfaqësues i PS në zgjedhje", shkruan Gazment Bardhi në profilin e tij në Facebook. Sipas tij kjo përbën një shkelje të ligjit pasi përcaktohet qartë se "Policia e Burgjeve është strukturë e depolitizuar". "Emërimi i komisarit të votave të PS në krye të Policisë së Burgjeve është shkelje flagrante e ligjit, që përcakton se "Policia e Burgjeve është strukturë e depolitizuar", u shpreh këshilltari për çështjet ligjore në PD. Në kundërpërgjigje, ministria e Drejtësisë Etilda Gjonaj, tha se "shpreh keqardhje për deklaratën e përfaqësuesit të PD-së z.Bardhi, që tregon se ka zbuluar se drejtori i ri i Policisë së Burgjeve është angazhuar si komisioner i PS në zgjedhjet e vitit 2013. Çfarë mund të themi ne që gjatë kësaj periudhe kemi identifikuar afro 200 punonjës me rekorde kriminale në sistemin e burgjeve, që juve s'ju kishin rënë fare në sy! Dhe më shumë se 100 të tjerë të punësuar në sistemin e burgjeve jashtë kufit ligjor!".

e pashmangshme dhe fundi i diktaturës së krimit i sigurve", shkruan Basha.

### ANKESAT

Banorët në bashkëbisedime me Bashën, kanë listuar të gjithë shqetësimet që hasin në punën e tyre të përditshme në kultivimin e prodhimeve bujqësore. Kreu i PD-së tha se kjo zonë vuan harresën e qeverisë si në sigurimin e

tregut ashtu edhe në lëvizimin e subvencioneve, të cilat sipas tij, kanë qenë premtime, por nuk janë mbajtur. "Keni aplikuar subvencione, sepse kjo qeveria ka pohuar se do të shpërndahen subvencione. Kushet e favorshme, kultura e punës është e mirë. Prodhimi është i bollshëm. Problemi është se nuk ka ndihmë nga shteti. Aksesi në treg pengohet nga shteti", theksoi z.Basha. Gjith-

### AKUZA

Kreu i PD-së akuzoi kryeministrin se nuk po lufton krimin, por në bashkëpunim me ministrin Xhafaj, po shkatërron hetimet. "3 ditë pas aksionit policor, Vangjush Dako, 'peshku i madh' i dosjes hetimore 339 vazhdon të jetë i lirë, njëllon si bosët e krimit nga Admir Hoxha të Klement Balili dhe Lul Berisha. Nuk ka luftë kundër krimit, por shkatërrim hetimesh me Ramën dhe Xhafajn, garantët e krimit në qeveri", - tha Basha.

## "Xhuxhi i dosjes 339", Noka: Të arrestohet Vangjush Dako

Partia Demokratike kërkon arrestimin e kryebashkiakut socialist, Vangjush Dako. Në një dalje për mediat, deputeti demokrat Flamur Noka tha se ka të paktën 24 orë që fletë arresti për Vangjush Dakon është prerë, por ekzekutimi i tij është bllokuar. Noka nxiti prokurorinë t'u thotë shqiptarëve pse dhe kush po ndalon arrestimin e "xhuxhit" në bazë të përgjimeve të dosjes 339. Deputeti demokrat tha se Vangjush Dako është peshku i madh i dosjes 339 dhe këtë të vërtetë askush nuk mund ta zhbëjë. "Kryetari i Bashkisë së Durrësit është peshku i madh i dosjes 339 dhe përpjekjet për të shpëtuar Vangjush Dakon janë të pashpresë! Askush nuk duhet të guxojë të prishë provat e përgjimit të Vangjush Dakos me kriminelët më të rrezikshëm të Durrësit! Çdo përpjekje për prishjen e provave, për zhdukjen e përgjimit apo për fshirjen e faqeve të transkriptuara të Vangjush Dakos me kriminelët është krim i rëndë, që paguhet me burg të gjatë. Askush nuk mund ta zhbëjë të vërtetën se kriminelët e Durrësit e të Shijakut kanë blerë vota për pushtetin e Vangjush Dakos dhe Edi Ramës dhe, si shpërblim, kanë marrë leje ndërtimi dhe tenderë miliona eurosh. Këtë fakt e denoncoi një vit më parë Lulzim Basha. Për këtë fakt, e paditi për shpifje Vangjush Dako. Me këtë fakt, me dosjen me numër 339, Lulzim Basha fitoi gjyqin"-u shpreh deputeti i PD-së.



Vangjush Dako



### DEKLARATA



Skandali me pronat në Lezhë, Salianji e denoncoi në "News 24"

Deputeti i Partisë Demokratike, Ervin Salianji denoncoi 6 muaj më parë skandalin pronat në Lezhë pas të cilat tha se fshihej edhe motra e ish-deputetit socialist Arben Ndoka. I ftuar në emisionin "Studio e hapur" në "News24" në mars të këtij viti, Salianji tha se motra e Ndokës mban postin e drejtueses së administrimit të tokës në Këshillin Bashkiak të Lezhës. Ai akuzoi publikisht se zonja në fjalë ka firmosur këtë akt të tjetërsimit të tokës nga tokë ranore në tokë pemëtoare (ose toke are). Ndërsa sjell në vëmendje deklaratat e deputetit Salianji, PD deklaroi në një njoftim për mediat se nga marsi deri në arrestimin e motrës së Arben Ndokës dhe personave të tjerë të bandës, prokuroria ka vepruar sipas interesave politikë të Edi Ramës.

rajonit shpenzojnë miliona euro në ndihmë të bujqësisë, ndërsa shqiptarët rrinë me sytë e drejtuar nga qielli. "Vlera totale e investimit që jukeni bërë në mijëra dynym në serra kap shifrat 7 milionë dollarë. Është tronditës që në 5 vite nuk keni para asnjë subvencione. Ne e dimë tashmë dhe ju e dini tashmë, sepse të gjithë shtetet sub-

vencionojnë fermerët. Ku shkojnë këta lekë, dhe ne si opozitë i kemi diskutuar. Janë 500 milionë euro që i marrin oligarkët. Maqedonia shpenzohet 150 milionë, Kosova 120 milionë euro, ndërsa shqiptarët rrinë me sytë nga qielli. Si do të konkurrojnë specit i Kosmacit, patëllxhani, si do të konkurrojnë prodhimet e rajonit", - tha kreu i PD-së.





Kryeministri: Më në fund me 'djale'! Aprovohet kontrata për "bypass"-et e Fierit dhe Vlorës

# Rama kritikon bashkitë: Kthejuni përgjigje qytetarëve

"Mediat mos i besoni, merren me filma"

Kryeministri Edi Rama e nisi ditën e djeshme me publikimin e informacionit mbi progresin e punësimit të 9 muajve të fundit nga Zyra e Punës. Sipas videoinformacionit të Ramës në periudhën janar-shtator 2018 janë punësuar 26,345 persona nga zyrat e punësimit në të gjithë vendin. Vetëm në muajin shtator janë punësuar 2650 persona. Një tjetër lajm dha dje Edi Rama, teksa në "Twitter" njoftoi se qeveria ka marrë aprovimin e fundit nga Banka Europiane për Rindërtim për lidhjen e kontratës së financuar nga kjo bankë për "bypass"-et e Fierit dhe Vlorës. Postimin e tij Rama e nis me humor duke shkruar: "Uf... më në fund me djale!". "Erdhi aprovimin i fundit i Bankës Europiane për Rindërtim dhe Zhvillim për lidhjen e kontratës së financuar nga kjo bankë për 'bypass'-et e Fierit dhe Vlorës", thekson Rama.

Kryeministria, qytetarët kryesisht të moshave të treta bënë apel që portali të jetë më i aksesueshëm. Ndërkohë, Rama tha se ka marrë fund koha kur qytetarët trajtoheshin me dallime nga institucionet shtetërore. Shefi i qeverisë shtoi mes tjerash se falë reformës kanë ndryshuar kushtet e skema e pensioneve. Ai nënvizoi faktin se në vëmendje të politikave të qeverisë do

të jenë të gjithë pensionistët e Shqipërisë. "Më vjen shumë mirë që platforma është më mekanizim që i ndihmon pa dallim që të gjithë, por edhe ato që janë më të dobët, të cilët kanë qenë pa përkrahje në zyrën e shtetit. Sepse zyra e shtetit kështu i ka trajtuar njerëzit me vite të tëra. Ne kemi një paketë solidariteti për pensionistët, që është e konsoliduar në zërat e bux-

hetit si asnjëherë më parë. Kemi kompensuar edhe boshllëqet që la pas mungesa e reformës së pensioneve. Pensionet që dalin pas reformave tona janë rritur. Sot pas reformës, tavanin nuk ekziston, pensioni bazohet tek sigurimet", theksoi z.Rama.

**SHPIFJET**

Kryeministri Edi Rama etiketoi mediat si shtypje të trurit të qytetarëve nëpërmjet ekranit. Për Ramën, mediat nuk merren me problemet e qytetarëve, por merren me incizime. "Nga shtypi mos prisni shumë shpjegime, se ata merren me filma, me incizime. Kanë gjëra më të rëndësishme për të bërë. Kanë thashetheme, kanë shpifje, kanë muhabete. Imagjino, arrijnë deri në pikën që thonë se bixhozi po ndalohet për të tërhequr vëmendjen, krimi po luftohet për të tërhequr vëmendjen. Për të hequr mendjen nga çfarë?! Nga filmat dhe nga incizimet. Llogariteni se ku kemi përfunduar me këtë shtyp. Quhet shtyp i lirë, por në fakt është shtypje e lirë e qytetarëve dmth., masazh brutal në trurin e vogël. Mjerësi kush ia lë trurin në dispozicion përpara ekranit këtyre", tha z.Rama.



Kryeministri Edi Rama

**KRITIKA**  
Si çdo të mërkurë kryeministri Edi Rama mbodhi koordinatorët e bashkëqeverisjes dhe qytetarët që kanë arritur të zgjidhin problemet e tyre me anë të platformës. Por Rama u ndal te kritikën për bashkitë që refuzojnë të kthejnë përgjigje. Gjatë eventit të bashkëqeverisjes me qytetarët në ambientet e Kryeministrit, z.Rama u ndal te Bashkia e Shkodrës, e drejtuar nga Voltana Ademi, që sipas tij refuzon çdo bashkëpunimin me qeverinë për zgjidhjen e problemeve të qytetarëve. "Bashkia e Shkodrës mban rekord, pasi refuzon çdo lloj bashkëpunimi, por edhe bashkitë e tjera. Ne përiqemi edhe me bashkitë për të zgjidhur problemet. Më vjen keq kur koordinatorët vendosin të dorëzojnë, pasi njësitë vendore e konsiderojnë platformën si instrument të palës kundërshtarë", - theksoi z.Rama.

**ANKESAT**  
Kryeministri Edi Rama gjatë takimit me qytetarët dhe prezantimit të zgjidhjeve së ankesave, të cilat janë adresuar tek portali "Shqipëriaqëduam.al", deklaroi se e gjithë vëmendja është tek njerëzit. Nga

**"Toyota Yaris", të tjera prova në Prokurori**

## Padia për shpifje, Balla: Basha do mbajë përgjegjësitë që i takojnë

Deputeti i PS-së, Taulant Balla dëshmoi dje në lidhje me padinë që ka bërë ndaj kryetarit të PD, Lulzim Basha për çështjen e 3.4 mln eurove në makinën "Toyota Yaris" që u kapën në portin e Durrësit. Balla tha se e ka paditur Bashën në lidhje me akuzat e bëra në Parlament, të cilat ai i konsideroi shpifje. "Një kallëzim penal tjetër në ngarkim të shpifësit Lulzim Basha për veprat penale të kallëzimit të rremë,



të shpërdorimit të detyrës, të vënies në rrezik të veprimeve hetimore që kanë të bëjë me veprën penale të tregtimit të sekretit hetimor dhe shtetëror. Sot erdha në Prokurori për të depozituar provat mbi të cilat unë kam bazuar këtë kallëzim penal. Dua t'ju them se ky hetim po ecën shumë mirë dhe në fund të tij, Lulzim Basha do të jetë një person, i cili sipas parashikimeve të Kodit Penal do të mbajë përgjegjësitë që i takojnë", u shpreh z.Balla.

**MBLEDHJA**  
Kryeministri Edi Rama mbledhjen e radhës së qeverisë do ta zhvillojë këtë fundjavë në Kukës. Mbledhja dyditore do të zhvillohet të premten dhe të shtunën. Kryeministri dhe ministrat do kenë takime me qytetarët, inspektive në institucione si dhe aktivitete për anëtarësimet e reja dhe bashkëqeverisjen.



**Meta me kreun e parlamentit austriak: Liberalizoni vizat për Kosovën**

Presidenti Ilir Meta takoi dje kreun e parlamentit austriak, Wolfgang Sobotka. Gjatë një vizite shtetërore në Austri, kreu i shtetit vlerësoi marrëdhëniet dypalëshe duke i konsideruar si të shkëlqyera. Ai tha se ky është momenti i duhur për të nxitur bashkëpunimin ekonomik, ndërsa vlerësoi përkrahjen e parlamentit austriak për ndihmën që i ka dhënë procesit integruar të Shqipërisë. "Parlamenti austriak është përkrahës i palëkundur i procesit të integritetit të Shqipërisë në BE", deklaroi kreu i shtetit Ilir Meta. Ai shtoi: "Mesazhet pozitive të zgjerimit për Shqipërinë dhe Maqedoninë janë shumë të rëndësishme. Shqipëria është e vendosur të bëjë të gjitha përpjekjet për pasur një vendim pozitiv për çeljen e negociatave të anëtarësimit me BE". Presidenti vuri në dukje se është me rëndësi finalizimi i liberalizimit të vizave për Kosovën gjatë Presidencës austriake të BE. "Kosova i ka plotësuar të gjitha standardet e kërkuara në këtë proces", theksoi z.Meta.

**REPUBLIKA E SHQIPËRISE**  
Zyra përbarimorë "Best 2010"

**SHPLLJE ANKANDI**

Më datë 26 nëntor 2018 nga ora 08.00-ora.16.00 tek kjo zyrë përbarimorë do zhvillohet seanca e fundit e mbledhjes së ofertave për ankandin e III-të, për shitjen e a) nr.pasurie 26/106+1-26, vol 52, fq.1, ZK.8603, sip. 105 m2 me çmim fillestar 2976750 lek; b) nr.pasurie 26/187-ND, vol 52, fq.28, sip.513.4 m2 me çmim fillestar 22640940 lek

Të dyja prona ndodhen në të njëjtin pallat (i ndodhur përballë Teatrit "Petro Marku", Vlorë) që ka ndërtuar Debitori "CO.BE.IN" shpk (NUI5 97201218L). Për sqarime të mëtejshme kontaktoni në tel: 052226000 ose cel: 0692075 644

**STRATI**  
Shoqëria përbarimorë "STRATI BAILIFFS SERVICE" Sh.p.k., njofton shpalljen për shitjen në ankand të pasurive të paluajtshme:

"Dyqan", me sipërfaqe 60 m<sup>2</sup>, ndodhur në Rruga e Durrësit, Tiranë, Zona Kadastrale 8310, regjistruar në Regjistrin Hipotekor me nr. 516, datë 13.03.2007, në pronësi të Shoqërisë "LIM-EM" sh.p.k, lënë si garanci hipotekore për Bankën Tiranë sh.a me Kontratë Hipotekë Nr. 1201 Rep., Nr. 8003 Kol., datë 13.03.2008. Çmimi fillestar i ankandit është 48,082 Euro.

Ankandi për pasurinë e mësipërme zhvillohet në datë 31.10.2018.

Ankandi për pasurinë e mësipërme zhvillohet në ora 16.00, në ambientet e Shoqërisë Përbarimorë "Strati Bailiff's Service", Rruga "Jordan Misja", Pall. 141/1, Shkalla 1, Ap. 7, Tiranë. Tel: 04 45 90 450, www.stratibailiff.com, info@stratibailiff.com

**ZYRA PËRBARIMIT GJYQESOR KORCE**

1-Me date 01.11.2018, ditën e Enjte ora 16.00 perfundon ankandi i pare per pasurine: (Apartament) me nr.pasurie 4/267+1-2,zk.8662,vol.1,fq.227 me sipërfaqe prej 52 m2 regjistruar ne Z.V.R.P.P. Korce, e ndodhur ne adresen Lagjia nr.4,Rr."Todi Vogli"pallati nr.4,Shk.a,K.4,Korce

2-Cmimi fillestar me te cilin fillon ankandi eshte 1.360.000,00,leke.

Ankandi zhvillohet ne ambientet e Zyres se Perbarimit Korce Me adrese Bulevard "Republika" Keshilli Qarkut,Kati 4, Korce tel.082245621

## DEKRETI I PRESIDENTIT SEANCA

Opozita bojkoton sërish parlamentin, në votim edhe mbyllja e lojërave të fatit

Valentina Madani

Opozita do të bojkotojë sërish seancën plenare ndërkohë që mazhoranca do të kalojë sot në seancë plenare dekretin e dytë të Presidentit Meta që ktheu për rishqyrtim në Kuvend ligjin për teatrin, por ndryshe nga sa bënë në shtator, këtë herë socialistët dhe të rrëzojnë dekretin e kreu të shtetit. Dekretet presidenciale hyjnë automatikisht në kalendarin e punimeve dhe Eduard Shalsi njoftoi deputetët e Veprimtarisë Prodhuese se do ta shqyrtojë dekretin e dytë të Metës mëngjesin e sotëm në orën 09:00, para se të nisë seancë plenare. Më pas dekreti mësohet se do t'i kalojë seancës që parashikohet të nisë një orë më pas. Këtë herë PS do ta rrëzojë dekretin e Presidentit, duke i hapur kështu rrugën shpalljes së garës dhe negociimit të kontratës me kompaninë fituese për ndërtimin e Teatrit të ri Kombëtar, në vend të godinës ekzistuese që do të shembet. Deputeti socialist, Fadil Nasufi, anëtar i Komisionit të Veprimtarisë Prodhuese paralajmëroi dje rrëzimin e dekretit. Ndryshe nga dekreti i parë ku mazhoranca ndryshoi vetëm pikën e hapjes për garën 60 ditë. "Dekreti i Presidentit do të rrëzohet me votat e mazhorancës dhe do të hapet rruga ndërtimit të Teatrit të ri Kombëtar, ashtu siç është bërë publike qysh në fillim të këtij procesi që u shoqërua edhe me një debat shterues"-tha deputeti socialist për 'Ora News'. Më tej Nasufi u shpreh, se pas vendimit të parlamentit do t'i hapet rruga procedurave të ligjit të negociimit dhe konkurimit për ndërtimin e Teatrit të ri Kombëtar me Partneritet Publik-Privat, ashtu siç është bërë publik që në fillim të këtij procesi shoqëruar dhe me një debat shterues. Në korrik Presidenti Meta e ktheu për herë të parë ligjin 37/2018 duke rënditur disa problematika, mes të cilave edhe mungesën e një gare të hapur për kompaninë ndërtuese. Kreu i shtetit nënvizoi se në ligj, me gjithë ndryshimet e bëra nuk garantohet barazia e subjekteve private në ndërtimin e teatrit. Pas një insistimi edhe të Brukselit, mazhoranca pranoi vërejtjet duke hapur të paktën zyrtarisht garën, gjë që përveç ndryshimeve në brendi sollti edhe ndryshimin në emrin e ligjit për teatrin. Këto elementë shfrytëzoi presidenti për ta konsideruar ligjin 37/2018 si ligj të ri e duke e ngulur atë për herë të dytë në vjeshtë, ndonëse një

# 'Teatri' sot në Kuvend, PS: Do ta rrëzojmë dekretin e Metës

"Procesi që u shoqërua me një debat shterues"



Bastet



EDI RAMA

"Nesër (sot) në Kuvend për Ligjin që ndalon Bixhazin (kazino), baste sportive, baste për gara qensh, kuajsh, luftëra gjelash, off apo online, pa asnjë përjashtim)! E po nesër dhe ca fjalë për Loto Opozitën e për bastet e gjysmagjelave të kazanit politik të baltës së shpijfeve e të akuzave?", shkruan Rama.

### Vakancat në KQZ, LSI nuk do çojë emër

## Vasili: Pa vendosur ligjshmërinë në parlament, s'ka diskutim

Kryetari i Grupit Parlamentar të LSI, Petrit Vasili tha se nuk do të ketë asnjë diskutim me parlamentin në lidhje me vendet vakante në KQZ. Vasili tha se parlamentin është inekzistent dhe nuk do të ketë asnjë diskutim për asnjë çështje. "Nuk kemi asnjë raport me parlamentin për këtë çështje, sepse kjo kërkesë ka lindur nga parlamenti. Dhe pa vendosur parlamentin në ligjshmërinë e tij, nuk do të ketë asnjë komunikim me parlamentin për asnjë çështje përfshirë dhe çështjen në fjalë. Pasi siç e dini janë dhe çështjet tjera që kanë të bëjnë me emërimet apo me propozime që lidhen dhe me institucione tjera për të cilat ne kemi ndërtuar këtë marrëdhënie të kushtëzuar pasi ky parlament është inekzistent. Dhe nuk mund të shkojmë të diskutojmë për këtë filan kan-



didat ndërkohë që ka çështje madhore. Është një parlament i bllokuar i kapur dhe që flet dhe funksionon në mënyrë moniste. Ndan e ndan paratë atje apo miratojnë ligje të tjera për t'i bërë alibi 1 miliard eurove të humbura lart e poshtë", - deklaroi z. Vasili. Ai akuzoi se KQZ është bllokuar nga Partia Socialiste, ndërsa u shpreh pa reformë zgjed-

### BLLOKIMI

"Është një parlament i bllokuar, i kapur, dhe që flet dhe funksionon në mënyrë moniste. Ndan e ndan paratë, atje apo miratojnë ligje të tjera për t'i bërë alibi 1 miliard eurove të humbura lart e poshtë", - tha z. Vasili.

hore KQZ nuk ka kuptim. "Nuk do të ketë asnjëherë bojkot të zgjedhjeve, të jenë të gjithë të qetë. Ju duhet të preokupoheni si KQZ është bllokuar dhe në mënyrë të njëanshme PS ka marrë dhe ka parqitur draftet e saj duke shënuar gjëra të padëgjueshme në historinë e pluralizimit shqiptar", - theksoi z. Vasili.



### Projektligji për tokën bujqësore, Braçe ultimatum qeverisë: Përgjigjen brenda nëntorit

Komisioni i Ligjeve shqyrtoi dje dy projektligjet e propozuara nga kreu i Komisionit Ekonomik të Kuvendit, Erjon Braçe, për kalimin e tokës bujqësore në pronësi të përfutuesve. Nismat që janë dorëzuar pranë Kuvendit të Shqipërisë përfshijnë ndryshime ligjore në praktikë aktuale të marrëdhënieve të pronësisë dhe përdorimit të tokës bujqësore. Gjatë fjalës së tij në komision, Erjon Braçe tha se qeveria duhet të kthejë përgjigje brenda muajit nëntor në mënyrë që nisma të hyjë në fuqi në fillim të vitit. "Duhet t'i vendoset afat qeverisë për të kthyer përgjigje për nismën. Duhet të hyjë në fuqi në datën 1 janar nisma. Çfarë do ndodhë nëse këta humbin mundësinë për marrjen e tokës në përdorim? Nuk kam asnjë ndroje të themi se ne presim qeverinë për këtë çështje, por jo më vonë se muaji nëntor. Njerëzit nuk kanë besim se do përfitojnë tokën", deklaroi z. Braçe. Kreu i Komisionit të Ligjeve Ulsi Manja shtoi: "Brenda nëntorit të kemi zgjidhjen përkatëse". Por deputeti Braçe insistoi: "Unë dua një datë nga qeveria. Nuk duhet të zgjasë një muaj kjo çështje". Manja tha: "Do e adresojmë deri në fund të nëntorit këtë çështje dhe të kemi një zgjidhje". Edhe deputeti Bashkim Fino u shpreh: "Deri në 24 nëntor qeveria të japë një përgjigje për këtë nismë".

gjë e tillë nuk lejohet nga Kushtetuta. Sipas kreu të shtetit, drafti i miratuar nuk ka marrë në konsideratë të gjitha shqetësimet e tjera të shprehura prej tij, por socialistët priten që këtë të enjte t'i

vënë vulën çështjes së Teatrit me votë. Po në seancën e sotme do të votohet edhe projektligji për mbylljen e lojërave të fatit. LSI akuzoi dje Kryeministrin Edi Rama se ka lejuar subjektet që

kanë licencën e lojërave të fatit të kryejnë evazion fiskal. Petrit Vasili shprehet se LSI ka kërkuar mbylljen e lojërave të fatit që në vitin 2016, por atëherë ishte Rama që nuk pranoi. Tashmë 2 vite

më vonë ish-aleatët në qeverisje nuk do të japë votën për këtë drafti në seancën plenare të së enjtes, 25 tetor. Por pavarësisht kësaj LSI akuzon Ramën se lojërat e fatit i kanë kushtuar buxhetit të

shtetit rreth 1 mlrd euro në 5 vite. "Të dhënat zyrtare janë 140 milionë. Kryeministri ka zbuluar se është 5-fishi. 1 miliardë euro është evazioni fiskal më i madh i këtij vendi", deklaroi LSI.



Autoriteti: Synohet të përmirësohet siguria e rrjetit rrugor

# Punime dhe mirëmbajtje në 28 segmentet rrugore

## Ja cilat janë korridoret që do të ndryshojnë

TIRANË, 24 tetor / ATSH/

Rrugët janë asetet më të mëdha publike në Shqipëri, por financimi i pamjaftueshëm dhe jo-sistematik i mirëmbajtjes së tyre e ka kthyer në sfidë ruajtjen e vlerës dhe të standardeve të sigurisë së qytetarëve. Efektet e mungesës së financimit të mirëmbajtjes së rrugëve reflektohen në ekonomi përmes kostove më të larta të transportit të mallrave dhe njerëzve si dhe në shëndetin publik, për shkak të aksidenteve. Këto efekte negative godasin më shumë shtresat në nevojë. Një projekt i qeverisë shqiptare dhe Bankës Botërore ka në fokus mirëmbajtjen dhe sigurinë e rrjetit kombëtar rrugor bazuar në rezultate konkrete. 28 segmente të rrjetit rrugor ose 1300 km të korridoreve kryesore rrugore që bartin 75% të trafikut kombëtar, do të nënshtrohen punimeve dhe mirëmbajtjes periodike. Një ndër këto segmente është ai Tiranë-Durrës. Arterja kryesore që lidh kryeqytetin me portin më të madh të vendit, Durrësin, si dhe është porta hyrëse për trafikun vendës dhe transit që kalon nga veriu në jug dhe nga lindja në perëndim të vendit. Këtu janë përqendruar edhe 40% e bizneseve dhe popullsisë së vendit. Një infrastrukturë e mirë përmirëson lidhjen me tregjet, ajo i bën mallrat dhe shërbimet më konkurruese. Segmenti nga kthesa e Patosit në drejtim të Levanit të Fierit është një aks tjetër që do të nënshtrohet mirëmbajtjes. Objektivat e projektit janë të ruajë kushtet e rrjetit të rrugëve parësore dhe parësore-dytësore (1335 km) të rrjetit kombëtar me anë të mirëmbajtjes periodike dhe asaj rutinë. Gjithashtu, synohet të përmirësohet siguria e rrjetit rrugor. Projekti do të fuqijë



zgjë praktikata e menaxhimit të aseteve rrugore e të sigurisë në përfitim të përdoruesve të rrugës. Mirëmbajtja e rrjetit rrugor ka

qenë vazhdimisht e keqfinancuar. Numri i aksidenteve me vdekje mbetet shumë i lartë, krahasuar me disa vende të rajonit dhe shumë



herë më i lartë se vendet e BE-së. Qeveria ka rritur vëmendjen ndaj reformës së sigurisë rrugore dhe synon që, deri në vitin 2020, të

redukojë me 50% numrin e fataliteteve. Realizimi i mirëmbajtjes periodike dhe i asaj rutinë të rrugëve do të menaxhohet nga Autoriteti

**SIGURIA**  
Mirëmbajtja e rrjetit rrugor ka qenë vazhdimisht e keqfinancuar. Numri i aksidenteve me vdekje mbetet shumë i lartë, krahasuar me disa vende të rajonit dhe shumë herë më i lartë se vendet e BE-së. Qeveria ka rritur vëmendjen ndaj reformës së sigurisë rrugore dhe synon që deri në vitin 2020 të reduktojë me 50% numrin e fataliteteve.

Rrugor me anë të kontratave të mirëmbajtjes, me bazë performance parashikohet për një periudhë 5-vjeçare. Gjithashtu, përfshihet dhe monitorimi i këtyre kontratave nëpërmjet shërbimeve të supervizorit, për të siguruar përpunueshmërinë me nivelet e shërbimit të përcaktuara në kontratë. Këto shërbime të monitorimit do të sigurojnë audit të sigurisë së rrugëve të projektit, si dhe do të zhvillojnë "Sistemin e transparencës sociale", ku përdoruesit e rrugës mund të japin opinionin e tyre mbi gjendjen e rrugëve.

### "Shqipëria është me të vërtetë piktoreske, është 'Kroacia e re'"

## Media australiane: Pse Shqipëria do t'ju bëjë të rishikoni listën tuaj të udhëtimit

Redaktorët e rubrikës së udhëtimit të portalit australian, "Style Magazine.au" u kanë kushtuar një artikull Shqipërisë, pas përfundimit të sezonit veror: "I kufizuar nga Mali i Zi, Greqia, Kosova dhe Maqedonia, Shqipëria ka shumë vend për eksplorim dhe për çudira. E bukura e këtij udhëtimit është se ka një vijë bregdetare të rafinuar, e shoqëruar me laguna të gdhendura thellë në male. Duke pasur një larmi të ndryshme të verërave mesd-

hetare dhe dimrave të ashpër dhe të ftohtë, peizazhi shqiptar ka nga një prejre rreth gjithçkaje. Plazhet e tyre janë sa të tejdukshme dhe të qeta sa Greqia dhe Alpet e tyre të mbuluara me borë janë atë larta dhe madhështore sa majat e Skocisë. Shqipëria është me të vërtetë piktoreske", - shkruajnë australianët, të cilët ftojnë të panjohurit me Shqipërinë të lexojnë pak për historinë e këtij vendi. "Deri në vitet 1990 vendi ishte i mbyllur, derisa hoqi dorë nga regjimi i komunizmit

dhe u formua Republika e Shqipërisë. E mbuluar në një histori aq të pasur dhe të kohëve të fundit, Shqipëria nuk është destinacion i zakonshëm. Çdo sasi e kohës së kaluar këtu është një ndërgjegjësim ndaj efekteve të luftës, por kjo gjithashtu ka bërë vendat të jenë të thjeshtë dhe të përlotur. Duhet ta pranojmë: Shqipëria është Kroacia e re. Turizmi ka marrë zhvillim, dhe është e lehtë të kuptohet pse. Ju mund ta keni vënë re kryeqytetin e Tiranës, në shumicën e sugjerimeve të 'Conti-



ki' dhe 'Top Deck'. Rrugët e Tiranës janë të mbushura me tregje të vegjël, që shesin prodhime vendore dhe i japin shumë ngjyrë. Një ish-kryetar i bashkisë, i njohur si një piktor porositi një fushatë me piktura të pallateve (loji më i mirë i fushatës) që na ngjason me një De Blob Wii. Ndërtimi i parqeve të gjelbërimit dhe pikturimi i qytetit me ngjyrë - edhe pse jo shumë politikisht

efektiv në atë kohë - kryeqytetit iu bë për një ndryshim serioz tërheqës. Ju tani mund të bridhni rrugët e Tiranës për të gjetur norma të reduktuara të krimin, ngjyra të gjalla dhe modele gjeometrike që shpërndajnë ndërtesat e një kombi krenar. Ndërsa nuk është shkëlqimi, përsosja pastel e 'Notting Hill', Tirana ofron një pamje autentike, të papërsosur të qytetit. Nëse po kërkoni një vendndodhje tjetër përveç kryeqytetit, shkoni Durrësin, Sarandën, Korçën, Krutën dhe Shkodrën - nuk ka asgjë më të mrekullueshme se sa to! E mbushur me këshjtjellat mesjetare, vëzhgimin e shpendëve, manastiret dhe këshjtjellat, bëni kërkimet tuaja dhe udhëtoni në mënyrë të sigurt thellësisht e Shqipërisë", - përfundon artikulli.

**REPUBLIKA E SHQIPERISE**  
**BANKA E SHQIPERISE**  
DEPARTAMENTI I ADMINISTRIMIT  
SEKTORI I PROKURIMIT

**TENDER I HAPUR KOMBËTAR SHOQUAR ME FTESA DIREKTE KANDIDATEVE TE HUAJ**

Banka e Shqipërisë kërkon të realizojë objektin e prokurimit: **"Automatizimi i sistemit përpluës dhe raportues të statistikave të sektorit jashtëm, për nevojat e Bankes së Shqipërisë"**

"Banka e Shqipërisë fton kandidatët e interesuar, të marrin pjesë në procedurën e prokurimit "Tender i hapur kombëtar shoqëruar me ftesa direkte kandidatëve të huaj", për realizimin e objektit të prokurimit si më sipër, me **fond limit 37,100,000 Lekë ose 296,000 Euro**".

Dokumentet e tenderit mund të tërhiqen pranë Sektorit të Prokurimeve të Departamentit të Administrimit, të Bankës së Shqipërisë, me adresë: Rruga e Dibrës, Kompleksi "Halili", Kulla A, Tiranë, Tel. 042419411(ext. 4251), çdo ditë nga ora 10.00 - 13.00 nga çdo person i autorizuar, me paraqitjen e një kërkesë me shkrim. Tërheqja e dokumenteve mund të bëhet vetëm pasi të keni bërë paraprakisht pagesën e paktyeshme prej 500 Lekë, pranë një banke tregtare në llogarinë e Bankës së Shqipërisë sipas detajeve të mëposhtme:

Përfutuesi: Banka e Shqipërisë  
BIC: STANALTR  
IBAN: AL68 1011 1008 0000 0000 2222 222L; BIC

Përkshkrimi: Blerje dokumente tenderi për tenderin me objekt: **"Automatizimi i sistemit përpluës dhe raportues të statistikave të sektorit jashtëm, për nevojat e Bankes së Shqipërisë"**

Oferta duhet të paraqitet në zyrën e Sektorit të Prokurimeve, pranë Departamentit të Administrimit, në Bankën e Shqipërisë, deri më **datë 27 Nentor 2018, ora 11:00**, kohë në të cilën do të hapet edhe tenderi, ku ftohen të marrin pjesë kandidatët ose përfaqësuesit e autorizuar të tyre.

**REPUBLIKA E SHQIPERISE**  
**BANKA E SHQIPERISE**  
DEPARTAMENTI I ADMINISTRIMIT  
SEKTORI I PROKURIMIT

**TENDER I HAPUR KOMBËTAR**

Banka e Shqipërisë kërkon të realizojë objektin e prokurimit: **"Blerje disa pajisje informatike për nevojat e Bankës së Shqipërisë"**

"Banka e Shqipërisë fton kandidatët e interesuar, të marrin pjesë në procedurën e prokurimit "Tender i hapur kombëtar", për realizimin e objektit të prokurimit si më sipër, me **fond limit 26,542,000 Lekë**".

Dokumentet e tenderit mund të tërhiqen pranë Sektorit të Prokurimeve të Departamentit të Administrimit, të Bankës së Shqipërisë, me adresë: Rruga e Dibrës, Kompleksi "Halili", Kulla A, Tiranë, Tel. 042419411(ext. 4251), çdo ditë nga ora 10.00 - 13.00 nga çdo person i autorizuar, me paraqitjen e një kërkesë me shkrim. Tërheqja e dokumenteve mund të bëhet vetëm pasi të keni bërë paraprakisht pagesën e paktyeshme prej 500 Lekë, pranë një banke tregtare në llogarinë e Bankës së Shqipërisë sipas detajeve të mëposhtme:

Përfutuesi: Banka e Shqipërisë  
BIC: STANALTR  
IBAN: AL68 1011 1008 0000 0000 2222 222L; BIC

Përkshkrimi: Blerje dokumente tenderi për tenderin me objekt: **"Blerje disa pajisje informatike për nevojat e Bankës së Shqipërisë"**

Oferta duhet të paraqitet në zyrën e Sektorit të Prokurimeve, pranë Departamentit të Administrimit, në Bankën e Shqipërisë, deri më **datë 21 Nentor 2018, ora 11:00**, kohë në të cilën do të hapet edhe tenderi, ku ftohen të marrin pjesë kandidatët ose përfaqësuesit e autorizuar të tyre.



## Maskat dhunojnë dhe lidhin me litar të moshuarin, i grabisin edhe makinën

**VLORE** - Dy persona të maskuar kanë grabitur dhe dhunuar një 70-vjeçar nga fshati Vranisht i Vlorës. Sipas burimeve nga policia e qytetit bregdetar, ngjarja ka ndodhur natën e së martës. I moshuari Nase Habilaj ishte në banesë, kur dy persona të armatosur kanë shkuar për ta grabitur. Mësohet se agre-

sorët kanë hyrë në banesë nga dritarja e tualetit dhe pasi janë përballur me të zotin e shtëpisë, e kanë goditur dhe lidhur atë. Ndërsa nën kërcënimin e armës, maskat i kanë marrë 70-vjeçarit automjetin tip "Volsvagen Golf" dhe janë larguar. Sinjalizimi është bërë nga fqinjët e tij. Këta të fundit e kanë gjetur

Nase Habilajn të lidhur, ndaj menjëherë kanë marrë policinë në telefon. Ndërkaq, mësohet se 70-vjeçari jeton i vetëm, pasi fëmijët e tij jetojnë në Itali. Nga ana tjetër, policia e Vlorës po vijon intensivisht hetimet për identifikimin dhe kapjen e autorëve të kriminit që grabitën dhe dhunuan plakun.

Kontrolli, 35-vjeçarit i gjendet dhe i sekuestrohet dhe kokainë

## Grabitën autobusin e linjës Itali-Vlorë, kapet autori i 3-të i shpallur në kërkim

*Ylli Murati me dy bashkëpunëtorët u morën pasagjerëve dhe shoferit 20 mijë euro*

TIRANË

Një muaj pas grabitjes së autobusit të linjës Itali-Vlorë, efektivitë e forcës "Shigjeta" në kryeqytet kanë arrestuar njërin prej autorëve që ishte shpallur në kërkim. Bëhet fjalë për 35-vjeçarin Ylli Murati, i cili akuzohet se në bashkëpunim me dy persona të tjerë kanë vjedhur nën kërcënimin e armës 20 mijë euro nga pasagjerët dhe shoferi i autobusit. Ngjarja ka ndodhur më 25 shtator 2018 në zonën e Skelës në Vlorë. Gjatë kontrollit të ushtruar, Murati i u gjet dhe sekuestrua një dozë kokainë. "Shërbimet e Forcës "Shigjeta", gjatë kontrolleve të ushtruara përgjatë natës dhe orëve të para të mëngjesit të sotëm kapën dhe ndaluan shtetasin Ylli Murati, banues në Tiranë. Ky shtetas është person i shpallur në kërkim nga D.V.P. Vlorë, pasi më datë 25.09.2018 në zonën e Skelës në bashkëpunim dhe me dy persona të tjerë kanë vjedhur nën kërcënimin e armëve të zjarrit shoferin dhe pasagjerët e autobusit të linjës Itali-Vlorë. Gjatë kontrollit të ushtruar, këty shtetasit u gjet dhe sekuestrua në cilësinë e provës materiale një dozë me lëndë narkotike e dyshuar ko-



Policia gjatë arrestimit të Ylli Murati

kaïnë. Po kryhen veprimet e mëtejshme hetimore dhe procedurale në ngarkim të tij", thuhet në njoftimin zyrtar të Policisë së Tiranës.

### GRABITJA

Më datë 25.09.2018, rreth orës 09:05, në zonën e Skelës, pranë stadiumit "Flamurtari", 3 persona të

**KORÇË** Banesa e një tregtareje në Korçë ka rënë pre e vjedhjes. Ngjarja ndodhi rreth orës 15:00 të ditës së djeshme në lagjen nr.17, në afërsi të Unazës. Mësohet se në banesën në pronësi të tregtarese Lina Qerollari në momentin kur ndodhi ngjarja nuk ka pasur njeri. Dyshohet se në shtëpi janë vjedhur shuma të konsiderueshme parash. Qerollari se bashku me dy fëmijët merrej prej vitesh me tregti.

maskuar kanë vjedhur nën kërcënimin e armëve të zjarrit dhe dhunës shoferin e autobusit të linjës Itali-Vlorë, si dhe disa nga

pasagjerët. Dy personat e armatosur me kallashnikov kanë qëndruar brenda në makinën "Benz", ndërkohe personi i tretë që mbante në dorë një pistoletë ka zbritur nga makina duke thirrur "Policia e Shtetit" dhe menjëherë kanë filluar t'i marrin paratë udhëtarëve. Autorët e ngjarjes pas grabitjes janë larguar menjëherë me dy automjete. Në tentativë për t'u shpëtuar forcave të policisë që ishin vënë në ndjekje të tyre, ata kanë braktisur dy makinat me të cilat u larguan nga vendi i ngjarjes tek nënkalmi i "Panajasë" dhe janë larguar në këmbë nëpër kodrat e Panajasë për t'u fshehur në pyll. Në lidhje me ngjarjen, policia ka arrestuar më herët edhe Armand Kuqi, 29 vjeç, lindur në Mamurras dhe banues në Tiranë.

### SHKURT

#### Kishte fshehur 14 kallëpe tritoli, pranga të riut

**TIRANË** - Policia e Tiranës ka vënë në pranga një të ri në Kamëz, pasi gjatë kontrollit të banesës i janë gjetur dhe sekuestruar 14 kallëpe tritoli. 22-vjeçari Fatjon Leka akuzohet për veprën penale "Prodhim dhe mbajtje pa leje të armëve dhe municionit luftarak". "Gjatë kontrollit të ushtruar në banesën e këtij shtetasi, në oborr i është gjetur e fshehur një qese plastmase, brenda së cilës kishte 14 kallëpe të dyshuara si lëndë plasëse e llojit tritol, të cilat u sekuestruan në cilësinë e provës materiale", thanë burimet policore. Materialet në ngarkim të tij u përcollën për hetime të mëtejshme prokurorisë.

#### Ndërron jetë në dhomë e paraburgimit 45-vjeçari

**TIRANË** - Në orët e para të mëngjesit të djeshëm, një i ndaluar nga policia ka ndërruar jetë në dhomë e paraburgimit të Komisarariatit të Policisë nr.3 në kryeqytet. Mësohet se viktima është Dritan Rica, 45 vjeç dhe nga këqyrja paraprake e trupit nuk rezultoi të ketë shenja në trup. Paraprakisht dyshohet se vdekja ka ardhur si pasojë e një arresti kardial. Mësohet se Rica ishte ndaluar për akuzën e vjedhjes. 45-vjeçari është dërguar tek Urgjenca e Tiranës, por nuk ka mundur të shpëtojë. Pritet raporti i mjekut ligjor për përcaktimin e shkakut të vdekjes.

#### AKU bllokoi 2.5 tonë peshk e karkaleca të ngrirë, gjobë subjektit

**TIRANË** - Autoriteti Kombehtar i Ushqimit ka bllokuar 2.5 ton peshk e karkaleca të ngrirë në një subjekt në Tiranë. Gjatë një kontrolli në subjektin "ALB ORCA", në Tiranë, me aktivitet "Magazinë Frigoriferike" u konstatua dhe u bllokua sasia prej 2.5 ton peshk dhe karkaleca të ngrirë të degraduar nga kushtet e ruajtjes (ngrijë-shkrirje e produktit si dhe kushtet higjieno-sanitare jo konforme), gjithashtu subjekti nuk dispononte dokumentacionin e duhur për gjurmueshmërinë e produktit. Për sa më sipër, ndaj subjektit u morën masa administrative me gjobë, 500.000 lekë si dhe bllokim i produktit deri në asgjësim. Ndërkaq, AKU u bën apel qytetarëve që të denoncojnë çdo rast që konstatohet apo dyshohet, pra çdo tentativë abuzimi.

## Shkak i zjarrit, luhatja e tensionit të energjisë elektrike

### Flakët përfshinë banesën, përfundon në gjendje të rëndë në spital 17-vjeçarja

**SHKODËR** - Një ngjarje e rëndë ka ndodhur në fshatin Rragam të njësies Guri i Zi në Shkodër. Një 17-vjeçare është përfshirë nga flakët e zjarrit duke pësuar dëgjie të shkaillës së parë. Ka qenë ora 21:00 e mbrëmjes të së martës, kur një shkëndijë elektrike si shkak i luhatjeve të tensionit ka shkaktuar zjarrin në banesën e shtetasit Valentin Kola. Zjarri ka përfshirë njërin prej dhomave të kësaj banese

ku ndodhej vajza, Elizabeta Kola. Ndërsa, pjesa tjetër e familjes ndodheshin në një dhomë tjetër në momentin kur ka rënë zjarri. Mësohet se 17-vjeçarja ka qenë në gjumë në momentin kur dhoma e saj është përfshirë nga flakët dhe ka tentuar që të çohet, por zjarri është përhapur në pak sekonda duke ia bërë të vështirë daljen nga dhoma. Burime për "GSH" bënë me dije se adoleshentja nuk dëgjon dhe as nuk mundet të flasë dhe kjo

ka qenë arsyeja që ajo nuk ka arritur të kërkojë ndihmë tek pjesëtarët e tjerë të familjes. Menjëherë familjarët, por edhe fqinjët kanë ndërhyrë për shuarjen e flakëve me kova uji. Në një moment është arritur që flakët të shuhen, por ka qenë vonë, sepse vajza e re ishte djegur në shumë pjesë të trupit. Familjarët dhe fqinjët nuk kanë lajmëruar zjarrfikëset, por kanë tentuar që ta shuajnë vetë zjarrin, duke parë se nuk kishte



Banesa ku ndodhi ngjarja

kohë për të pritur mjetet e zjarrfikësve. Tashmë Elizabeta Kola ndodhet në gjendje kritike për jetën, ndërsa është dërguar në Tiranë në pavionin e dëgjie-plastikës për shkak se ka dëgjie të shkaillës së parë. Në vendngjarje pas këtij zjarri kanë mbërritur forcat e policisë. Efektivët kanë lajmëruar më pas

repartin zjarrfikës në Shkodër, por pasi zjarri ishte shuar. Zjarrfikëset kanë shkuar në fshatin Rragam ku ndodhi kjo ngjarje, por vetëm për të bërë ekspertizën e këtij zjarri të rënë. Nga hetimet e paraprake dyshohet se zjarri është shkaktuar nga luhatja e tensionit të energjisë elektrike.



Gjyshi i viktimës: Isha për vizitë në spital, kur sollën nipin të vdekur

**FIER**

# Tronditet Fieri, 10-vjeçari vret me thikë vëllain 13-vjeçar në oborrin e shtëpisë

## Të afërmit: Fëmijët ishin vetëm në shtëpi, u grindën teksa po pastronin peshk

Një sherr mes dy vëllezërve të mitur ka përfunduar në tragjedi. Në zënkë e sipër, 10-vjeçari ka goditur me thikë për vdekje vëllain e tij më të madh. Ngjarja e rëndë ku humbi jetën 13-vjeçari Gj. Veizaj ka ndodhur paraditen e djeshme në fshatin Baltëz të Fierit. Mësohet se djali është dërguar me urgjencë në spitalin rajonal të Fierit nga të afërmit e tij, por mjekët kanë deklaruar se ai ka mbërritur pa shenja jete. Menjëherë pas sinjalizimit për ngjarjen e rëndë, policia ka nisur hetimet për sqarimin e plotë të rrethanave. Nga dëshmitë e dhëna nga familjarët e viktimës, mësohet se dy vëllezërit e mitur janë konfliktuar me njëri-tjetrin në ambientet e shtëpisë, teksa ishin duke qëruar peshk. "Sot në datën 24.10.2018, rreth orës 10:50, ka shkuar i shoqëruar nga familjarët në Spitalin e Fierit shtetasi Gj.V., 13 vjeç, banues në fshatin Baltëz. Nga hetimet paraprake dyshohet se pas një grindje me njëri-tjetrin, vëllai i tij i vogël, shtetasi i mitur K.V., 10 vjeç, ka marrë thikën dhe e ka goditur. Si pasojë e plagëve të mara, shtetasi Gj.V., ndërroi jetë në Spitalin e Fierit. Grupi hetimor po punon për sqarimin e plotë të rrethanave të ngjarjes", thuhet në komunikatën zyrtare të policisë së Fierit.

**VRASJA**

Mesditën e djeshme, banorët e fshatit Baltëz të Fierit janë tronditur tejet nga një ngjarje e rëndë e ndodhur në familjen rome, Veizi. Dy djemtë e mitur të kësaj familjeje kanë qenë duke pastruar në oborrin e banesës së tyre një sasi peshku, që e kishin kapur në një nga kanalet e zonës. Ata janë grindur me njëri-tjetrin. Në një moment 10-vjeçari K. Veizi ka goditur me thikë në këmbë vëllain 13-vjeçar. Kjo goditje ka qenë fatale, pasi i ka marrë jetën gjatit të madh të kësaj familjeje. Menjëherë të afërmit e tij kanë mbërritur në shtëpi dhe e kanë nisur për në spitalin e qytetit të Fierit, por i mituri nuk i ka mbijetuar dot plagës së marrë. Të shokuar nga ngjarja, të afërmit e familjes Veizi pohan dje për "Gazeta Shqiptare". "Dy fëmijët ishin në oborr duke qëruar peshk dhe kanë nisur të grinden, siç grinden fëmijët, jo mbaje ti, pse nuk e mban ti, pastroje ti... Nuk kishin për të ngrënë ishin edhe pa drita në shtëpi. Prindërit e tyre nuk ishin në shtëpi në atë moment, pasi ishin në punë. Nuk dinin gjë se çfarë ndodhi këtu në shtëpi. Nuk kishte njeri që ta ndihmonte nipin, se edhe mund të shpëronte. Atë të voglin e mori policia", tha xhaxhai i fëmijëve, Isa Veizi. Ndërsa një fëmijë u shpreh me lot në sy: "Unë isha andej nga shtëpia, kur dëgjoja se çfarë kishte ndodhur. Pashë nusen me djalin në krah. Kjo është, gjë



Banesa e familjes Veizi kundodhi ngjarja



tjetër nuk di".  
**DËSHMIA E GJYSHIT**  
I ndodhur rastësisht për një vizitë mjekësore në spitalin e Fierit, tregoi momentin kur fëmija mbërriti i pajetë. Ai pohoi se fëmijët nuk kishin shkuar në shkollë dhe

ishin vetëm në shtëpi, pasi prindërit ishin në punë në një fabrikë këpucësh në Vlorë. "Lajmin për nipin e mësova në spital, pasi isha atje isha për vizitë. Pashë një makinë që mbërriti me shpejtësi me një të plagosur. Unë u bëra



Gjyshi i 13-vjeçarit

**Dëshmia**



XHAXHAI

"Dy fëmijët ishin në oborr duke qëruar peshk dhe kanë nisur të grinden, siç grinden fëmijët, jo mbaje ti, pse nuk e mban ti, pastroje ti... Nuk kishin për të ngrënë ishin edhe pa drita në shtëpi. Prindërit e tyre nuk ishin në shtëpi në atë moment, pasi ishin në punë. Nuk kishte njeri që ta ndihmonte nipin", tha xhaxhai i fëmijëve, Isa Veizi.

kurioz dhe shkova afër makinës. Kur pashë nusen, Betën. E pyeta hë moj Beta çfarë ka ndodhur. Ajo më tha se u vra çuni i Fatmiri. E pyeta po Fatmiri dhe gruaja e tij ku janë, nusja më tha se janë në punë në Vlorë. Mësova vetëm

këtë se nipi vdiq rrugës", u shpreh gjyshi i 13-vjeçarit. Për shkak të kushteve të vështira ekonomike, dy djemtë nuk shkonin shpesh në shkollë, por njëri prej tyre të merrej me peshkim dhe tjetri të kujdesej për pulat.

## U shkarkua 3 muaj më parë, KPA lë në fuqi vendimin e KPK për Altina Xhoxhaj

**TIRANË** - Komisioni i Posaçëm i Apelit ka lënë në fuqi vendimin e KPK-së për ish-gjyqtaren Altina Xhoxhaj. Kjo e fundit u shkarkua 3 muaj më parë. Ajo mbante postin e gjyqtarës së Gjykatës Kushtetuese, ndërsa kohë më parë u shkarkua nga KPK-ja. Vendimi për ta shkarkuar u mor, pasi KPK shqyrtoi për një javë dokumentacionin e paraqitur nga Xhoxhaj për të argumentuar pasurinë e deklaruar. "Komisioni e konsideron të mbyllur procesin e rivlerësimit. Trupa gjyquese vendosi me shumicë votash sh-



Ish-gjyqtarja e Kushtetueses, Altina Xhoxhaj

karkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit", thuhet në njoftimin e KPK-së. Gjatë

shqyrtimit të dosjes së anëtares së Kushtetueses, KPK-ja konstatoi mospër-

puthje në deklarim të burimit e parave, vendime në konflikt interesi, mbajtjen e një sasive të madhe cash, mungesë të ardhurash për blerjen e një apartamenti 109 m2 në vitin 2005 si dhe probleme me një truall në Gjirin e Lalzit. Në seancën e 25 prillit KPK shtyu në momentin e fundit nxjerrjen e vendimit, me pretendimin se kërkonte më shumë kohë për të llogaritur likuiditetin në deklaratën e pasurisë së gjyqtarës, pasi pretendohet se gjyqtarja ka fshehur të ardhurat.

**SHKURT**

**Dosja "Xhisela", Rexhep Rajra shkon për gjykim**

**KRUJË** - Ditën e djeshme, Gjykata e Krutës ka vendosur që të çojë për gjykim Rexhep Rajrën, djalin e deputetit të PS-së, Drahman Rajra. i cili akuzohet se ka përndjekur ish-të dashurën e tij, Xhisela Maloku. Mësohet se avokati i Rajrës ka kërkuar gjykim të shkurtuar për kllentien e tij, por ky i fundit nuk ka pranuar akuzat për përndjekje. Raportohet se në Gjykatën e Krutës është dorëzuar edhe një deklaratë noteriale e bërë nga Xhisela dhe motra e saj, të cilat kanë pranuar se me të pandehurin kanë pasur marrëdhënie të mira.

**Vidhnin banesat, përfundojnë në pranga 4 vlonjatët**

**FIER** - Policia e Fierit ka goditur një grup prej 4 personash, të cilët kryenin vjedhje banesash në këtë qytet. Bëhet fjalë për shtetasit Emanuel Doda, 23 vjeç; Lediona Preçi, 21 vjeçe; Bledar Skënderaj, 24 vjeç dhe Klaustin Zeneli, 22 vjeç, të gjithë banues në Vlorë. Sipas bluve, 4 të rinjtë në bashkëpunim me njëri-tjetrin kryenin vjedhje banesash me thyerje në qytetin e Fierit, duke thyer bravat e dyerve të banesave që vidhnin. Konkretisht, gjatë orëve të natës së datës 23.10.2018 këta shtetas janë kapur me sende të vjedhura në banesat e shtetasve P.Th. dhe O.T. në lagjen "15 Tetor" Fier. Ndërsa, vijon puna për zbardhjen dhe dokumentimin e ngjarjeve të tjera të mëparshme në qytetin e Fierit, ku dyshohet se autorë janë këta shtetas. Gjithashtu, këta shtetas dyshohet se kanë kryer vjedhje banesash edhe në qytetin e Vlorës për dokumentimin e të cilave po punohet me specialistët e hetimit të krimin në komisariatet e policisë Vlorë. Materialet i kaluan Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Fier për hetime të mëtejshme në ngarkim të shtetasve të mësipërm për veprën penale "Vjedhje" e kryer në bashkëpunim.

## STATUSI I MINATORIT INTERVISTE

Minatori: Jemi të varfër, të braktisur e të zhgënjyer nga qeveritë e 27 viteve

Voltiza Duro

# Miratimi i statusit, minatorët paralajmërojnë me protesta e grevë urie

Mark Gjergji: Shteti e sindikatat na kanë shkelur me këmbë

Miratimi i statusit të minatorit, vazhdon të ngelet një prej problemeve më të mëdha për punonjësit e nëntokës, të cilët për 27 vite me radhë kanë protestuar fuqimisht për të drejtat e tyre. Në një intervistë për "Gazeta Shqiptare", Mark Gjergji, një prej minatorëve në pension thotë se protestat e minatorëve do të vazhdojnë pandaluar deri në miratimin e statusit dhe respektimin e të drejtave të kësaj kategorie. Ai më tej bën me dije se do të rrinë ditë e natë para kryeministrit e madje është planifikuar që të nisim grevën e urisë. Gjithashtu, Gjergji, hedh akuza të forta ndaj sindikatave të minatorëve e sipas tij sindikatat janë përpjekur ti shkelin me të dyja këmbët paturpësisht e asnjëherë nuk kanë mbrojtur të drejtat e punonjësve të nëntokës, por interesat e tyre të ngushta duke marrë fonde e duke i shpenzuar kot më kot. Aktualisht, Mark Gjergji merr një pension prej 150 mijë lekësh të vjetra në muaj, e thekson se kjo shumë i del veç për një thes me miell.

**Nesër (sot) ju si minatorë do të kërkonit para kryeministrit miratimin e statusit të minatorit. Pse mendoni se është vonuar miratimi i statusit?**

Kemi shumë vite që po luftojmë fort për të drejtat e minatorëve, e madje kemi dalë edhe në grevë urie për 21 ditë, por politikanët tanë na mposhtën. Deri më tani kemi bërë rreth 60 protesta për të mbrojtur të drejtat tona si punonjës të nëntokës. Por çdo qeveri nuk ka bërë asgjë tjetër, përveçse na ka mbajtur pezull për 26 vite me radhë. Kemi takuar shumë përfaqësues të institucioneve përkatëse, por s'kemi marrë asnjë përgjigje deri tani. Shpresojmë që pushtetarët të miratojnë statusin sa nuk është vonë se do përballem më tej me shumë minatorë që e kanë humbur durimin për gjithë këto vite. Do të kërkojmë me ngulm para Kryeministrit që të miratojë statusin e minatorit e të vënë në vend dinjitetin e të takon. Do të futen edhe 3 përfaqësues tanë brenda në kryeministri që të bisedojnë.

**Cilët do të jenë përfaqësuesit tuaj që do të zhvillojnë takimin në kryeministri?**



Një prej protestave të minatorëve



Mark Gjergji, ish-minator

### STATUSI I MINATORIT

Statusin e minatorëve duhet ta përfitojnë punonjësit e nëntokës dhe të dalin në pension me 10 vite e 6 muaj. Kush ka plotësuar 55 vite moshë, ka punuar 10 vite e 6 muaj në minierë t'i jepet e drejta e statusit të minatorit. Statusi i minatorit të shoqërohet me 50% të pensionit shtesë page.

### TRAJTIMI I MINATOREVE

Ne nuk kemi shtet këtu në Shqipëri, asnjë gjë s'po bëhet për ne, pavarësisht se i kemi dhënë kaq shumë e madje shumë prej nesh edhe jetën. Që prej vitit 1997, dola në kurbet në këmbë nga malet, e kam nxjerrë bukën e familjes me 4 vite punë aty.

Ne kemi zgjedhur Fiqiri Xibrin e Kol Nikollaj që të negociojnë për miratimin e statusit. Shpresoj shumë që të mos politizohet situata, pasi nga ky status varet jeta e shumë minatorëve që marrin pensione qesharake e mezi iu del llogaria për të blerë një copë bukë. Duam drejtësi dhe vetëm drejtësi, se janë tallur shumë me ne, e është turp për këtë shtet që na diskriminon në këtë mënyrë.

**Nëse nuk merrni një përgjigje pozitive mbi miratimin e statusit, cilat do të jenë hapat tuaj më tej?**

Protesta do të vazhdojë pa ndalim para kryeministrit, nëse nuk na japin një përgjigje pozitive për miratimin e statusit. Që në vitin 2013-të, kur kryeministri ka marrë pushtetin kanë kaluar 5 vite dhe as

është vënë uji në zjarr për ne. Asnjë nga institucionet përgjegjëse nuk ka nisur punën për miratimin e statusit, e që ne të mund të flemë të qetë pas kaq vitesh luftë me qeveritë. Kështu që nëse këtë herë nuk na japin zgjidhje ne do të luftojmë edhe më fort, madje do rrimë ditë e natë para kryeministrit deri sa nderi jonë të shkojë në vend. Madje kemi planifikuar që të nisim grevën e urisë, nëse do vazhdojnë të na shkelin, siç kanë bërë për vite me radhë.

**Pse minatorët e kërkojnë me ngulm miratimin e statusit?**

Statusin e minatorëve duhet ta përfitojnë punonjësit e nëntokës dhe të dalin në pension me 10 vite e 6 muaj. Kush ka plotësuar 55 vite moshë ka punuar 10 vite e 6 muaj në minierë t'i jepet e drejta e statusit të

minatorit. Statusi i minatorit të shoqërohet me 50% të pensionit shtesë page. Me një përllogaritje page me pagën minimale 100%. Pra, në qoftë se ka qenë paga 24 mijë të shkojë 48 mijë ose 35 mijë në 70 mijë. Kemi kërkuar që çdo vit mbi 10 vite e 6 muaj, të shoqërohet me një shtesë 3%.

**Sa keni gjetur përkrahje te sindikatat për gjithë këto vite?**

Vlen të theksoj se sindikatat në asnjë moment nuk na kanë shërbyer neve, minatorëve, por na kanë tradhtuar gjithmonë nga dita në ditë, nga viti në vit për 27 vite me radhë. Ndoshta është edhe faji ynë pasi duhet t'i kishim shpartalluar këto "gjoja" sindikata me kohë pasi është edhe roli i tyre që shteti na ka shkelur me këmbë. Sindikatat janë përpjekur të na shkelin me të dyja këmbët paturpësisht e asnjëherë nuk kanë mbrojtur të drejtat tona, por interesat e tyre të ngushta duke marrë fonde e duke i shpenzuar kot më kot.

**Si paraqitet gjendja e punonjësve të nëntokës sot?**

Jo pak minatorë lëngojnë në krevat me ilaçe që s'kanë as mundësi ekonomike për t'i blerë. Ndërkohë, që pensionet që

### KËRKESAT E MINATORËVE

1. Miratim i statusit të minatorit
2. Rritje e pensioneve të këtyre punonjësve
3. Luftë ndaj informalitetit në punë
4. Siguri dhe kushte më të mira pune
5. Rritje e pagës minimale

merr kjo kategori janë të pamjaftueshme për të përballuar jetesën. Mesa kemi informacion, shumë prej shokëve që kemi punuar bashkë janë larguar në kurbet e kanë marrë rrugët e emigrimit për një jetë më të mirë, e me pagesa më të larta se këto pensione qesharake që na jep shteti shqiptar. Por jo pak minatorë kanë vdekur pa e gëzuar atë pension të ulët për shkak të sëmundjeve të ndryshme që i ka falur kjo punë në nëntokë. Tani kemi ngulur ne, ish minatorët që kërkojmë me ngulm miratimin e statusit dhe s'do të ketë kthim mbrapa këtë herë. Jemi të varfër, të braktisur dhe të zhgënjyer nga ky shtet.

**Ju personalisht, si jeni trajtuar nga shteti pas daljes si i papunë për shkak të mbylljes së mini-**

**erës? A jeni i kënaqur me pensionin që merrni?**

Ne nuk kemi shtet këtu në Shqipëri, asnjë gjë s'po bëhet për ne, pavarësisht se i kemi dhënë kaq shumë e madje shumë prej nesh edhe jetën. Që prej vitit 1997, dola në kurbet në këmbë nga malet, e kam nxjerrë bukën e familjes me 4 vite punë aty. Nëse do e lija veten në dorë të politikave të shtetit, do isha kalbur në barakë. Tashmë jetoj në Thumanë, në Dukat të Krujës së bashku me gruan e tre djemët. Shteti shqiptar po më jep një pension qesharak prej 150 mijë lekësh të vjetra në muaj. Arrij të marr një thes miell, një bombël gazi e kaq për gjithë muajin. Jashtë Shqipërisë minatorët respektohen e paguhen kurse ne s'kemi bukë të hamë.



## UNIVERSITETI I VLORES PROBLEMATIKAT

Voltiza Duro

Viti i ri akademik 2018-2019 ka nisur me tarifa të larta për studentët e universitetit "Ismail Qemali" në Vlorë, dhe jo vetëm për pagesën vjetore. Përkatësisht, bëhet fjalë për planin mësimor, për të cilin studentët që kanë përfunduar nivelin bachelor, por edhe master duhet të paguajnë plot 80 mijë lekë të vjetra për ta marrë. Një grup studentësh në këtë universitet, kanë denoncuar pranë "Gazeta Shqiptare" dyfishimin e tarifës për planin mësimor krahasuar me vitin e kaluar. "Jam një studente që kam përfunduar vitin e tretë bachelor në universitetin "Ismail Qemali" në Vlorë. Problematika jonë është shumë e madhe pasi për të marrë planin mësimor, duhet të paguajmë 80 mijë lekë të vjetra. Nga studentët e vitit të kaluar kam dëgjuar se pagesa për vitin akademik 2017-2018 ishte 40 mijë lekë të vjetra. Nuk e kuptojmë se pse ka ardhur ky dyfishim tarife brenda një viti. Kërkojmë një zgjidhje sa më shpejt nga instancat përkatëse, pasi për mua kjo është një zhvatje e hapur që po i bëjnë xhепave të studentëve", thekson për "Gazeta Shqiptare" një prej studenteve.

### PAMUNDËSIA EKONOMIKE

Për studentët, tarifa prej 80 mijë lekësh vetëm për planin mësimor është e papërbalueshme, pasi ata duhet të paguajnë përveç kësaj edhe tarifën vjetore për vitin akademik si dhe të blejnë librat për secilin lëndë. "Duhet të paguajmë për çdo gjë, për vitin akademik, për librat e shtrenjtë, për konviktin, e tani edhe për planin mësimor. Studentët nuk kanë mundësi ekonomike



Studentët: Paguajmë 11 mijë lekë për një listë notash. MASR të japë zgjidhje

# Universiteti i Vlorës zhvat studentët, 80 mijë lekë për planin mësimor

"Po na rrjepin, sistemi arsimor është kalbur"

### LISTA E NOTAVE

"Nëse kërkojmë listën e notave, ajo kushton plot 11 mijë lekë të vjetra, ndërkohë që në universitetin e Elbasanit është vetëm 1 mijë lekë të vjetra. Si nuk kanë turp që na zhvatën në këtë mënyrë kaq të pisët", - thotë për "Gazeta Shqiptare" një tjetër student.

### "VJEDHJE E PASTËR"

"Na kanë lënë pa përgjigje, asnjë nuk do t'ia dijë për ne studentët. Dje pyeta sekretaren e departamentit ku unë studioj dhe më tha që nuk ka asnjë informacion se pse është dyfishuar tarifa këtë vit. Kjo është vjedhje e pastër", - thekson një tjetër studente

# 80

### MIJË LEKË PLANI MËSIMOR

"Për të marrë planin mësimor për këtë vit akademik, duhet të paguajmë 80 mijë lekë të vjetra. Nga studentët e vitit të kaluar kam dëgjuar se pagesa për vitin akademik 2017-2018 ishte 40 mijë lekë të vjetra. Kërkojmë një zgjidhje sa më shpejt, pasi për mua kjo është një zhvatje e hapur që po i bëjnë xhепave të studentëve", - thekson një prej studenteve.

për të përballuar shpenzime të tilla, edhe prindërit nuk kanë mundësi të na mbulojnë gjithmonë me ato rroga që marrin. Kjo është e padrejtë, universiteti po na rrjep nga lekët,

shpresojmë që të zgjidhet sa më shpejt e të gjenden fajtorët për gjithë këtë situatë skandaloze", shprehet për "Gazeta Shqiptare" një student në këtë universitet. Ndërkohë, stu-

dentët më tej kërkojnë që të ketë një tarifë fikse për çdo universitet. "Nuk po e kuptoj se pse duhet të vendoset një tarifë kaq e lartë për planin mësimor. Në fund të fundit është vetëm një fotokopje me një vulë të universitetit sipër e për këtë universiteti e quan plan mësimor dhe i vendos tarifën sipas qejfit. Kemi marrë informacion se në universitetin "Aleksandër Xhuvani" në Elbasan, në universitetin "Eqerem Çabej" në Gjirokastrë apo edhe në uni-

versitete të tjera plani mësimor kushton vetëm 10-15 mijë lekë të vjetra. Është skandaloze, ose të vendoset një tarifë fikse për çdo universitet, ose të zgjidhet problemi se kush po i vjedh studentët e Vlorës", thotë i revoltuar një tjetër student. Pavarësisht kërkesave të shumta që studentët kanë drejtuar në këtë institucion ende nuk kanë marrë një përgjigje mbi arsyen e dyfishimit të tarifës. "Na kanë lënë pa përgjigje, asnjë nuk do t'ia dijë për ne studentët. Dje pyeta sekretaren e departamentit ku unë studioj dhe më tha që nuk ka asnjë informacion se pse është dyfishuar tarifa këtë vit. Kjo është vjedhje e pastër. Ministria e Arsimit të ndjekë rastin dhe të na japë një zgjidhje sa më shpejt të jetë e mundur pasi ne vetë nuk kemi mundësi të paguajmë tarifa kaq

të larta", thekson një tjetër student.

### LISTA E NOTAVE

Studentët e universitetit të Vlorës, ngrenë edhe një tjetër shqetësim mbi pagesën e listës së notave që kushton 11 mijë lekë të vjetra. "Universiteti jonë gjithmonë do të gjejë mënyra nga më të ndryshmet për të na zhvatuar. Nëse kërkojmë listën e notave, ajo kushton plot 11 mijë lekë të vjetra, ndërkohë që në universitetin e Elbasanit është vetëm 1 mijë lekë të vjetra. Pse duhet të ketë diferencime të tilla vallë? Një listë notash 11 mijë lekë? Sistemi arsimor kështu dëshmon edhe njëherë se është kalbur, asnjë përfitim për studentët. Si nuk kanë turp që na zhvatën në këtë mënyrë kaq të pisët", thotë për "Gazeta Shqiptare" një tjetër student.

### INSTITUTE OF STATISTICS OF ALBANIA

The Contracting authority intends to award a service contract for **Support for the implementation of Population and Housing Census 2020**, Albania Location – Albania (AL) with financial assistance from the European Union. The contract notice is available at <http://www.instat.gov.al/en/about-us/census-of-population-and-housing-2020-in-albania/procurement-procedures/>

The deadline for submission of applications is 27 November 2018.

### INSTITUTI I STATISTIKAVE TË SHQIPËRISË

Autoriteti Kontraktor INSTAT, ka për qëllim dhënien e një kontrate shërbimi për "Mbështetje për zbatimin e aktiviteteve të Cens 2020" Shqipëri, Vendlodhja - Shqipëri (AL) me ndihmë financiare nga Bashkimi Europian. Njoftimi i kontratës është publikuar në: Anglisht: <http://www.instat.gov.al/en/about-us/census-of-population-and-housing-2020-in-albania/procurement-procedures/> Shqip: <http://www.instat.gov.al/al/reth-nesh/censi-i-popullsis%C3%AB-dhe-banesave-2020-n%C3%AB-shqip%C3%ABri/procedura-prokurimi/>

Data e fundit për paraqitjen e aplikimeve është 27 Nëntor 2018.



### NJOFTIM

Shoqëria "GPP Korça" sh.p.k, propozon ndërtimin dhe operimin e një termocentrali me gaz me cikël të kombinuar kogjenerimi CCCPP KORÇA 500 MW/ 80 MW/ 6 MW në zonën pranë qytetit të Korçës, saktësisht përballë Impiantit të Trajimit të Ujërave të Qytetit të Korçës. GPP Korça ka kontraktuar kompaninë ABKONS sh.p.k për realizimin e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis, si shoqëri e lincensuar për veprimtaritë e ekspertizës lidhur me ndikimin në mjedis.

Për këtë qëllim, Ju njoftojmë se në Korçë do të mbahet një Dëgjese Publike për të bërë publike rezultatet e vlerësimit mjedisor dhe për të diskutuar dhe mbledhur komentet dhe sugjerimet nga pjesëmarrësit.

Dëgjesa Publike do të mbahet në datën 26 Tetor 2018 në orën 12:00 ne sallën e takimeve tek "Grand Hotel Korça"

Emocionet e çiftit përgjatë këtyre ditëve, kujdesi i Tolgës

# Vjen lajmi i shumëpritur, Almeda Abazi në pritje të ëmbël

*"Zoti do të na bekojë me një fëmijë"*

Egla Xhemali


Almeda Abazi më në fund ka pranuar se është shtatzënë. Bukuroshja shqiptare është në pritje të ëmbël të fëmijës së saj të parë me bashkëshortin Tolgahan Sayisman. Ajo nuk e ka fshehur lumturinë e ditëve që do të jenë të mbushura me emocione. Si një besimtare e devotshme dhe me shpirtin plot për mrekullinë që shumë shpejt do jetë mes tyre falënderimet më të mëdha i ka për zotin. 'Jam shumë e lumtur, Zoti do të na bekojë me një fëmijë' është shprehur ajo. Bëhet e ditur se ish-Missi shqiptar është në javët e para të një periudhe mjaft të gëzueshme. Lajmi për shtatzëninë e saj kishte kohë që qarkullonte në mediat rozë megjithëse nuk ishte pranuar asgjë nga çifti. Almeda dhe Tolga janë një nga çiftet më simpatikë të show bizzit. Ata e kanë kurorëzuar dashurinë e tyre më 13 shkurt të vitit të kaluar në një ceremoni private në Shtetet e Bashkuara. Almeda dhe Tolga janë shfaqur gjithkund bashkë nëpër postime dhe jo vetëm. Kur bukuroshes iu besua moderimi i "Dancing with the stars" në një prej



netëve në atë finale ajo kërcëu së bashku me bashkëshortin e saj. E veshur me fustan të bardhë e ai me kostum klasik, dyshja kërcëu nën ritmet e këngës "Everything I do". Në fund të performancës që u prit shumë mirë nga publiku ata shkëmbyen puthje


rremben duartrokitje. Tolga pohoi se ishte i lumtur që ndodhej në Shqipëri dhe se e donte atë. Aktori bukurosh tha, gjithashtu, se nuk ndihej aq i zoti në kërcim se sa ndihej në aktrim dhe se Almeda ishte shumë herë më mirë se ai. Po energjitë e saj i janë

dedikuar tërësisht artist. Bukuroshja ka publikuar këngën e parë të saj duke nisur kështu një rrugëtim tjetër drejt muzikës. Për Tolgën gjithçka arrihet me punë. Aktori është duke punuar në projekte të reja filmike që shumë shpejt do të shfaqen



në ekranet e mëdha të kinemave. Ai është i përqendruar, gjithashtu, tek kujdesi ndaj Almedës në këto ditë që do jenë të veçanta për të dy. Në emër të çiftit janë adresuar urime nga më të ndryshmet nga miqtë e tyre duke e shprehur dhe ata të fundit gëzimin

që ndjejnë për lajmin e shumëpritur. Nuk kanë qenë të pakta fotot e postuara në rrjetet sociale duke vënë mbishkrime nga më të bukura. Ne urojmë që kjo kohë të eci pa probleme shëndetësore për Almedën dhe fëmija të vij shëndetplotë në jetë.






## Oriola Marashi, më seksi se kurrë me veshje provokuese

Oriola Marashi është një nga femrat më seksi të show bizz-it shqiptarë. Si gjithmonë bukurshja ka tronditur rrjetin me imazhet provokuese. Këtë herë ka pozuar e veshur me një robdeshamber, që i ka nxjerrë në pah gjoksin e saj bombastik. Pjesëtarja e grupit OTR është një nga modelet më seksi që ka tregu e këtë nuk ngurron ta shpërfaqë. Nuk janë të pakta komplimentet që merr nga fansat në rrjetet sociale.



## Larg "Procesit Sportiv", Ilda Bejleri dogji rrjetin me postimet e saj

As ajo nuk i qëndroi larg postimeve të imazheve provokuese. E kemi fjalën për Ilda Bejlerin. Moderatorja nuk di të ndalet me pozat seksi në rrjetet sociale. Fotoja e fundit që bukurshja postoi në 'Instagram' i la të gjithë pa fjalë. E veshur me të zeza me një kanotiere me dekolte mjaft të hapur ndërkohë që mbante flokët me duar Bejleri duket tejet sensuale. Reagimet e fansave nuk kanë munguar as këtë herë me like dhe komente.



## Adelina Tahiri pozon para pasqyrës, ja si duket këngëtarja

Adelina Tahiri arriti që në një kohë mjaft të shkurtër të kthejë linjat e saj perfekte pas periudhës së shtatzënisë. Bukuroshja ka pak javë që ka sjellë në jetë vogëlushin Jon. Këngëtarja i është rikthyer fuqishëm rrjeteve sociale duke postuar foto nga më të ndryshmet. Këtë herë ajo ka ndarë me të gjithë fansat e saj në 'Instagram' një foto para pasqyrës nga ku bie në sy trupi tejet në formë dhe gjoksi i ekspozuar. Shumë shpejt pritet që Tahiri të sjellë projekte të reja muzikore.



## Françeska Jaçe nuk di të ndalet, shihni fotot që po çmendin fansat

Për të nuk ka kufizime. Ajo ka zgjedhur të mos e vrasë mendjen për komentet e shumta duke postuar edhe më tepër foto provokuese. Këtë herë Françeska Jaçe i ka surprizuar të gjithë me një imazh mjaft përvëlues pasi është shfaqur pa sutjena. Modelja seksi ka një pelerinë të lehtë veshur teksa pozon nga një makinë tepër luksoze. Ajo ka tentuar t'i bashkëngjisë një emoji gjoksit të saj të madh.



Arrestohet ish-ministri i Mbrojtjes së Greqisë me gruan

# Kotzias: Kamenos merr fonde sekrete, qeveria paguhet nga Soros

## Ish-ministri: Sollën planin B në SHBA

Ish-ministri i Jashtëm Nikos Kotzias ka ngritur akuza të rënda ndaj ministrit grek të Mbrojtjes Panos Kamenos. Në një intervistë për Kreta TV, Kotzias tha: "Diskutimi për marrëveshjen e Prespës në këshillin ministror u mbulua me ton balte nga ministri i Mbrojtjes, jo vetëm për fonde sekrete, por edhe me akuza se qeveria paguhet nga Soros të blejë të huaj për interesa. I vetmi që reagoi kundër isha unë, në një qeveri që kërcënohet madje në këtë formë nuk kam vend. Tjetër ministër duhet të largohet. Por..." - tha Kotzias. Për debatin e marrëveshjes së Prespës ish-ministri theksoi se "Janë kryer 4 takime ministrore, të cilat Kamenos nuk ka pranuar të paraqitet. Kotzias ka bërë të qartë se marrëveshja mund të arrinte në dhjetor në parlamentin grek, çfarë binte në kundërshtim me interesat e ministrit të Mbrojtjes Panos Kamenos, që paraqiti dhe një plan B, pa dijeninë e tij në Amerikë. "Madje, ky plan B u paraqit dhe si strategjia serioze e palës greke, duke e nënvleftësuar marrëveshjen e Prespës si jo primare për qeverinë", tha ish-ministri i Jashtëm Nikos Kotzias, në komentet kundër anëtarit të vogël të koalicionit qeveritar, Panos Kamenos. Ndërkaq, nga ana tjetër, policia greke ka arrestuar gjatë natës së të martës ish-ministrin e Mbrojtjes dhe një nga politikanët korifë të Pasok, Ja-



Ish-ministri i Jashtëm, Nikos Kotzias

nis Papantoniou. Bashkë me të është arrestuar dhe bashkëshortja e tij Stavroula Kuraku. Çifti Papantoniou akuzohet për korrupsion dhe 2.8 milionë euro para të zeza, nga kontrata për 4 fregata moderne e pajisje të tjera ushtarake. Ministri është kaluar para kamerave me pranga në duart rreth orës 23:00 të mbrëmjes së djeshme, ndërsa mbi duart e tij ishte hedhur një xhakë, në mënyrë që mediat të mos arrinin që ta filmo-

nin këtë moment. Ioannis (Janos) Papantoniou, i lindur në 1949 ka qenë që nga viti 1981 deputet me Pasok. Ministër i Ekonomisë në vitin 1994, ripërsëritet 1996-2001. Ministër i Mbrojtjes 2001-2004. Llogaria e parë sekrete që hapi dosjen u zbulua me listën Lagarde. Papantoniou është i dyti ish-ministër i Mbrojtjes që ndodhet prapa hekurave. Për korrupsion është arrestuar dhe po vuan dënimin edhe Akis Xohaxopoulos.

### NIKOS KOTZIAS

"Diskutimi për marrëveshjen e Prespës në këshillin ministror u mbulua me ton balte nga ministri i Mbrojtjes, jo vetëm për fonde sekrete, por edhe me akuza se qeveria paguhet nga Soros të blejë të huaj për interesa. I vetmi që reagoi kundër isha unë, në një qeveri që kërcënohet madje në këtë formë nuk kam vend. Tjetër ministër duhet të largohet. Por..." - tha Kotzias.



200 refugjatë bllokojnë kufirin mes Bosnjës dhe Kroacisë

Është mbyllur kalimi kufitar midis Bosnjës dhe Kroacisë pasi qindra emigrantë dhe refugjatë u përpoqën të hyjnë në vendet e BE. Gjatë tentativës për të vijuar rrugën drejt vendeve të Europës, refugjatët dhe emigrantët krijuan trafik duke bllokuar kështu rrugën kryesore. "Rreth 200 emigrantë dhe refugjatë bllokuan rrugën kryesore drejt kalimit kufitar të Bosnjës me Kroacinë të mërkurën në mëngjes, duke rezultuar në mbylljen e kontrollit të kufirit Maljevac për të gjithë trafikun, njoftoi policia kufitare e Bosnjës. "Emigrantët janë ulur në rrugë, duke bllokuar trafikun dhe deri tani nuk janë regjistruar incidente", tha zëdhënësi i policisë kufitare Sanela Dujković në një njoftim për shtyp. Mediat lokale, gjithashtu, raportuan se rreth 90 emigrantë dhe refugjatë nuk janë lejuar të zbrisin nga treni në të cilin ndodheshin. "Autobusët me emigrantë nuk do të lejohen të hyjnë në kantonin Una Sana për shkak të mungesës së kapacitetit akomodues në këtë zonë", tha Mujo Korić, komisioneri i policisë. Shtimi i emigrantëve dhe refugjatëve në drejtim të kufirit filloi të hënën dhe vazhdoi sërish të martën, kur rreth 400 vetë u mblodhën në kufirin me Bosnjën me Kroacinë, pasi qarkulluan zëra se Bashkimi Evropian do të hapte dyert, por kjo rezultoi në mashtrim, shkruan IBNA. Emigrantët kanë kaluar natën në mes të rrugës duke shpresuar se do të vijë dita për një kalim drejt destinacionit të vendeve të Bashkimit Evropian. Që nga fillimi i vitit deri më 17 tetor, rreth 18,000 emigrantë dhe refugjatë u regjistruan si të hyrë në Bosnje dhe Hercegovinë, shumë prej të cilëve po udhëtojnë në rrugën e re të ashtuquajtur "Rruga e Ballkanit" në Evropën Perëndimore, e cila kalon nëpër Shqipëri, Mali i Zi, Bosnja dhe në disa raste edhe nga Serbia.

## Vuçiç: Kosova, pengesa e vetme për rrugën evropiane të Serbisë

Presidenti serb Aleksandar Vuçiç tha se ruajtja e paqes, stabilitetit dhe sigurisë për qytetarët serbë në Kosovë do të jetë më e vështirë, "sepse është edhe më se e qartë se nuk do të ketë zgjidhje kompromisi, për shkak të atmosferës në Serbinë qendrore, në Kosovë, si dhe faktorëve të jashtëm që nuk dëshirojnë një marrëveshje", transmeton "Zëri.info". Problemi më i madh në rrugën tonë evropiane është çështja e Kosovës" - tha Vuçiç për TV Pink. Ai, gjithashtu, përmendi se mbështetësit e regjimit të mëparshëm, ata nga DS, "Plus fashistët", deklaratat e tilla, siç janë ato të Johannes Hahn, dëshirojnë t'i mbërthejnë në vetëm një interpretim, dhe kjo është se problemi i Serbisë është sundimi i ligjit. "Por problemi më i madh është Kosova. Në raportin e saj, Komisioni Evropian do të shënojë progresin më të madh në sundimin e ligjit. Ata e dinë atë. BE-ja në qoftë se do të deklarohet se problemi i vetëm është Kosova, do të merrte pikë negative, dhe të pafatë nga skena politike e Serbisë këtë nuk e kuptojnë", tha ai. Vuçiç theksoi se ai vëzhgon me kujdes atë që po ndodh në BE dhe se Serbia dëshiron të jetë pjesë e saj.

### ALEKSANDAR VUÇIÇ

"Ruajtja e paqes, stabilitetit dhe sigurisë për qytetarët serbë në Kosovë do të jetë më e vështirë, sepse është më se e qartë se nuk do të ketë zgjidhje kompromisi, për shkak të atmosferës në Serbinë Qendrore, në Kosovë, si dhe faktorëve të jashtëm që nuk dëshirojnë një marrëveshje. Problemi më i madh në rrugën tonë evropiane është çështja e Kosovës" - tha Vuçiç.

## Sherr mes tre burrave në Prishtinë, i përfshirë vëllai i presidentit

### Thaçi sulmoi fizikisht shefin e Byrosë së Sigurimeve dhe një drejtor privat sigurimesh

Ditën e djeshme, policia e Kosovës ka konfirmuar për Telegrafin se rreth orës 12:00 ka marrë informacionin se në rrugën "Lidhja e Pejës", në Prishtinë, ka ndodhur një përleshje fizike mes tre personave. Mësohet se në sherr janë përfshirë Gani Thaçi, vëllai i presidentit Hashim Thaçi dhe dy persona të tjerë. Mediat kosovare raportojnë se Thaçi dyshohet se ka sulmuar fizikisht shefin e Byrosë Kosovare të Sigurimeve, Blerim Pushkollin, dhe një drejtor të një kompanie private të sigurimeve. Policia theksoi se menjëherë pas marrjes së këtij informacioni në vendin e ngjarjes kanë dalë të gjitha



njësitë e nevojshme policore, të cilat sipas rekomandimeve të prokurorit të shtetit, i cili po ashtu ka dalë në vendin e ngjarjes po ndërmarrin veprimet e mëtejme hetimore. Ndërkaq prokuroria Themelore në Prishtinë kon-

firmoi pas ngjarjes së ndodhur se vëllai i Presidentit të Kosovës, Hashim Thaçi, Gani Thaçi, ka qenë i përfshirë në një përleshje në mjediset e Byrosë Kosovare të Sigurimeve. Prokurori përgjegjës për komunikim me media në Prokurorinë Themelore në Prishtinë, Ibrahim Berisha, e ka konfirmuar për Kallxo.com se Gani Thaçi bashkë me shoferin e tij, janë duke u hetuar si të dyshuar për këtë incident. "Të dyshuarit janë Gani Thaçi dhe shoferi i tij. I dëmtuar është z. Blerim Pushkollin. Rasti ka nisur si sulm. Ende nuk është marrë vendim për paraburgim", ka thënë Berisha.



## Tensionet Greqi-Turqi, anijet luftarake zbarkojnë në Egje

### Tsipras: Sipas ligjit ndërkombëtar mund të zgjerojmë hapësirën detare me 12 milje



Anijet luftarake në Egje

Deklaratat politike të qeverisë greke dhe kundërpërgjigja turke janë përkthyer me lëvizje intensive të anijeve luftarake në Egje në pritje të urdhrave për të vepruar. Kryeministri Tsipras nga pozicioni i Ministrit të Jashtëm ka publikuar një deklaratë zyrtare ku thuhet: Greqia ka të drejtë në bazë të ligjit ndërkombëtar që të zgjerojë hapësirën e saj detare me 12 milje. Zëdhënësi i Ministrisë së Jashtme greke, Alexandros Gennimatas, tha se zgjerimi i ujërave territoriale të Greqisë bazohet në ligjet ndërkombëtare. Zëdhënësi i Ministrisë së Jashtme turke Hami Aksoy iu përgjigj ho-

mologut grek me faktin se Asambleja e Madhe Turke në deklaratën e votuar më 8 qer-

shor 1995 ka sanksionuar se nëse Greqia zgjeron ujërat territoriale në detin Egje,

përtej gjashtë miljeve, parlamenti turk do t'i japë qeverisë "të gjitha kompetencat", duke përfshirë fuqitë ushtarake, për të mbrojtur interesat e Turqisë. Turqia dërgoi anijen e shpim kërkimit Hayreddin Pasa dhe dy fregata ushtarake në Mesdheun lindor në një zonë që përfshin një segment të shefit kontinental të Greqisë për të eksploruar gazin natyror. Hayreddin Pasa u detyruar të tërhiqej pasi marina greke lëshoi një paralajmërim për radio. Më parë këtë javë, Ankaraja lëshoi një teleks lundruës duke thënë se kishte planifikuar të eksploronte

për gazi rreth zonës ekonomike ekskluzive të Qipros. Ministria e Jashtme turke tha se Turqia po ushtronte të drejtën e saj sovranë për të eksploruar për gaz, duke thënë se pretendimet greke të sovranitetit ishin joreale dhe të dëmshme për marrëdhëniet dypalëshe dhe stabilitetin rajonal. Gjiganti i naftës së SHBA ExxonMobil do të eksplorojë, gjithashtu, për gazin natyror në zonë këtë vjeshtë, një vendim që mund të intensifikojë më tej tensionet midis Uashingtonit, Ankarasë dhe Athinës.

Vijojnë sulmet me bombë në SHBA. Këtë javë ishte duke u regjistruar rasti i tretë i sulmit me bombë të dërguar me postë në një nga mediat më të njohura në mbarë botën. Një pako e dyshimtë është gjetur ditën e djeshme në redaksinë e CNN, ka shkruar Russia Today. Lajmi është bërë i ditur nga një gazetar i kësaj redaksie, i cili shkruan në Twitter se po largohen nga zyrat. Të gjithë gazetarët dhe stafit janë evakuuar me policinë që ka filluar hetimet e menjëhershme. CNN i ka redaksitë qendrore në qytetin e Nju Jork në Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Pako me eksplozivë u gjetën ditën e sotme edhe në shtëpitë e dy ish-Prezidentëve, Bill Clinton dhe Barack Obama. Dy "pako të dyshimta" të ndara u janë dërguar në sekretari ish-sekretares së Shtetit dhe kandidatës për presidencën amerikane, Hillary Clinton, dhe ish-presidentit amerikan, Barack Obama. As Clinton e as Obama nuk i kanë marrë personalisht paket, të cilat u kapën "gjatë procedurave të kontrollit rutinë" dhe u identifikuan si "pajisje të mundshme shpërthyes", dhe për këtë arsye situata po "menaxhohet siç duhet". Kjo është thënë nga agjencia përgjegjëse për mbrojtjen e tyre. Shërbimi Sekret Amerikan tha se në rastin e Bill dhe Hillari Clinton, bomba u gjet

Sulmet me eksploziv në SHBA, bazë shtëpitë e Klintonit dhe Obamës

# Pako e dyshimtë në redaksinë e 'CNN', evakuohen gazetarët

Bombë në shtëpinë e George Sorosit, policia nis hetimet



Studio e CNN

postare nga një prej punonjëset e Sorosit, e cila njoftoi autoritetet përpara se ta çonte atë në një zonë me pemë. Incidenti, sipas BBC, ndodhi pasditën e së hënës dhe po hetohet nga FBI. Kritikant ndaj Soros janë bërë të zakonshme nga grupet e djathta, për shkak të mbështetjes që ai ka dhënë për kauza liberale. Biznesmeni mësohet se nuk ndodhej në shtëpinë e tij në Bedford, në Westchester County në kohën e incidentit. Kush është Soros? Biznesmeni hungarez-amerikan e fitoi pasurinë e tij falë spekulimeve inteligjente financiare. Ai ka shpenzuar miliardë në projekte për të drejtat e njeriut dhe në sipërmarrje liberale e demokratike nëpër botë dhe është një prej donatorëve më të mëdhenj të Partisë Demokratike në SHBA. Në të shkuarën, ai ka mbështetur fushatat elektorale të Barack Obamës dhe Hillari Clinton, ndërsa presidentin amerikan Donald Trump e ka cilësuar si "uzurpues". Ekzistojnë disa ëmbishte me teori konspirative nga të djathtët në Amerikë, që pretendojnë se Soros qëndron pas disa ngjarjeve të kohëve të fundit në SHBA, si dhe pas krizës globale. Ata e kanë akuzuar si të përfshirë në rekrutimin e protestuesve kundër Trump, në marshimin e grave në mars dhe madje edhe si organizator i dhunës në Charlottesville. Soros është kthyer, gjithashtu, në personin më të sulmuar në mbarë botën nga nacionalistët dhe populistët, të cilët e akuzojnë atë si një mjeshtrë manipulues të demokracisë.

natën e së martës në zyrat që ish-presidenti dhe ish-sekretarja amerikane e shtetit kanë në kuadër të qëndrimit të tyre në vendpushimin e Chappagua në shtetin e Nju Jorkut. Në rastin e Barak Obamës, eksplozivi i dyshimtë u gjet në mëngjes në postën e zyrës së tij në Uashington. Të dy pajisjet janë të ngjashme me ato që gjenden në shtëpinë, gjithmonë në shtetin e New York, e miliardërit-filantropist George Soros, një financues i madh i Partisë Demokratike dhe i akuzuar nga e djathta dhe nga disa republikanë për krahës të Donald Trump se qëndrojnë prapa çështjes së karvanit të migrantëve që vijnë në kufirin jugor të SHBA. Ka qenë policia e New York, ajo e cila arriti që të shkatërronte me sukses një zarf brenda së cilit kishte bombë. Pakoja u zbulua në një kuti

## SHKURT

### SHBA, gjashtë fëmijë vdesin nga një virus në spital

Gjashtë fëmijë me patologji të rënda janë shtruar në një spital në SHBA dhe kanë vdekur nga një infeksion nga adenovirus. Edhe dhjetëra të tjerë janë infektuar, sipas asaj që raporton BBC. Autoritetet e shtetit kanë konfirmuar që në total janë rreth 18 raste me adenovirus mes pacientëve pediatrik të qendrës për kurim dhe rehabilitim të Wanaque, në Ne Jersey. Normalisht adenovirus shkakton simptoma jo të rënda, por fëmijët që janë goditur nga ky virus 'kanë qenë të brishtë nga pikëpamja mjekësore dhe më një sistem imunitar delikat', thanë burimet. Autoritetet shtetërore kanë hapur një hetim për rastin, ndërsa shtrimet e pacientëve të rinj janë pezulluar.

### Turqi, shuhet në aksident familja prej 4 anëtarësh


Një familje me 4 anëtarë është shuar në një aksident të rëndë automobilistik në Ankara të Turqisë. Sipas "Hurriyet", 36-vjeçari Onur Elitok humbi kontrollin e mjetit në zonën e Etimesgutit duke u përplasur me shtyllën e tabelave rrugore, mbremjen e së martës. Në vendngjarje mbërritën menjëherë policia, zjarrfikësit dhe shërbimet shëndetësore, por asgjë nuk mund të bëhej për drejtuesin e mjetit dhe bashkëshorten e tij Hilal Elitok (36), të cilët humbën jetën në vendngjarje. Dy fëmijët e çiftit, An'1, 2 vjeç dhe Furkan Emir, 9 vjeç, u dërguan me shpejtësi në spital, por nuk arritën t'u mbijetojnë plagëve të marra, duke e bërë aksidentin edhe më tragjik.

### Uragani "Willa" godet Meksikën

Uragani i fuqishëm "Willa" goditi brigjet perëndimore të Meksikës. Erërat e fuqishme arritën në 195 kilometër në orë, ndërsa autoritetet e kategorizuan atë në nivelin 3 të rrezikut. Pavarësisht se konsiderohet si rrezik për jetën e banorëve të zonave që përshkon, deri më tani nuk raportohen viktima nga uragani, përveç dëmeve materiale. Në fillim të këtij muaji, një tjetër uragani i fuqishëm goditi brigjet lindore të Shteteve të Bashkuara duke i marrë jetën 27 personave.

## RIKTHEHET 'TITANIKU', KROÇERA INAUGUROHET NË 2022

'Titaniku' kthehet në det. Projekti për të ndërtuar një kopje të anijes së famshme, e mbytur në Atlantik, ishte ndërprerë për probleme financiare, por tani ka nisur sërish dhe 'Titanik II' do të bëjë kroçerën e parë në 2022.



FOTOLAJMI

## ERNESTO CHE GUEVARA DOSSIER II

Historia e vrasjes, Che Guevara iu lut ushtarëve të mos shtinin mbi të

# Bolivia, aventura apo misioni i fundit i Ernesto Che Guevarës

*Enveri: Përse duhet ta vajtojmë vrasjen e Che-së, në fund të fundit revolucionarët vriten!*

Spartak Topollaj



(vijon nga numri i kaluar)

I sapo kthyer në Kubë, pas dëshimit dhe zhgënjimit afrikan, ku kish marrë dizenterinë dhe pati kaluar një tjetër krizë akute të astmës kronike, Che përgatitet moralisht dhe materialisht për misionin, apo aventurën e fundit. Me bindjen e palëkundur se në një vend latino-amerikan mund të përsëriste suksesin e revolucionit kuban, zgjodhi Bolivinë e diktatorit Rene Barrientos Ortuño, si vendin ku mund të realizonte ëndrrën delirante të tij. I maskuar në mënyrë të përkryer, duke u paraqitur si një biznesmen, me dokumente false nën emrin Adolfo Mena Gonzales, Che mes 3 dhe 4 nëntorit 1966 mbërrin nga Montevideo në La Paz, ku nuk vonon dhe merr kontakt me kreun e Partisë Komuniste Boliviane, Mario Molina Monje, më 31 dhjetor 1966. Të përçarë në disa rryma, udhëheqësit komunistë bolivianë nuk është se e mirëpritën atë për të mos thënë që s'u morën vesh për asgjë, madje Che, pak më vonë i klasifikoi edhe si tradhtarë ata. Kështu Che Guevara, po i hynte detit me këmbë, si i themi ne shqiptarët. Në krye të 58 vetëve, (29 bolivianë, 25 kubanë, 3 peruanë dhe Tanja) mori malet dhe pyjet në Kordiliere (Ande) dhe përgjatë lumit Nancahuazu me shpresën se fshatarët bolivianë do i përkrahnin, do i mbështetnin, do i ndihmonin e do i bashkoheshin, siç pat ndodhur dikur me ata të Sierra Maestra-s në Kubë. Çeta e tij, nëse mund të quhet e tillë, bëri disa përpjekje të vogla me forcat qeveritare, por pa asnjë rezultat të dukshëm. Më 16 prill 1967, Che publikon "Mesazh për Tre Kontinentalin", ku hap tazi kërkon 2, 3, e më shumë vietnamezë, ndërkohë që katër ditë më pas, arrestohen dy intelektualë të majtë francezë, të afërt me guerilet, Regis Debray dhe Ciro Bustos, të cilët gjykohehen dhe dënohen me nga 20 vite burg (Franca ndërrohet rrymë gjatë, deri sa ia mbërriti të lirshen pas katër vitesh). Në maj mbërrijnë në Bolivi forcat speciale amerikane, që filluan stërvitjen e trupave qeveritare për luftë



kundër guerillasve. Më 1 korrik Presidenti Barrientos, njofton publikisht se Che ndodhet në Bolivi dhe udhëron dërgimin e dy batalioneve me rreth 1800 trupa, për të asgjësuar rebelët e armatosur. Nga ana tjetër, në Havana, Fideli bën edhe një përpjekje të fundit, natyrisht pa sukses, të sigurojë mbështetje për luftën guerilase në Konferencën e Solidaritetit të Amerikës Latine, (31 korrik-10 gusht), ku Che-së iu rezervua edhe karrigia e nderit. Më 4 gusht, një prej guerillasve dezerton dhe tradhtisht tregon bazën e Che dhe emrat e luftëtarëve të tij. Të rrethuar nga të

gjitha anët, një pjesë e guerillasve shkëputet nga grupi dhe më 31 gusht bien në një pritë të mirorganizuar të forcave qeveritare, duke u asgjësuar të gjithë, përfshi dhe Tanjën e Che-së. Mes pyjeve, maleve të larta dhe hummerave, grupi i komanduar nga Che, të mbetur pa ushqime e municion, pa ndërlidhje e komunikim me Havanën (valët e dy radiove defektuoz nuk mbërritën kurrë në Kubë) dhe të rrethuar në darën e forcave speciale të shumta në numër, të humnera El Juros, pranë fshatit Higuera në provincën Vallegrande, bënë rezistencën e fundit më 8 tetor

Shumica syresh u vranë, disa u plagosën dhe u dorëzuan, ndër ta edhe vetë Che-ja. Për dorëzimin dhe orët e fundit të Che, ka dëshmi të shumta. Mbetur i plagosur, me pushkën gjysmautomatike vetëmbushëse M2, të papërdorshme nga dëmtimi dhe me revolverin pa karikator, siç tregon biografi i tij Jon Lee Anderson, që i referohet rreshterit Bernardino Huancana, dëshmitar në ngjarje, Che iu lut ushtarëve të mos shtinin mbi të, se kur të mësonin kush ishte, do të kuptonin pse ai u duhej i gjallë! Ashtu të plagosur, e lidhën dhe e izoluan në shkollën e fshatit, ku tentuan ta marrin në pyetje. Che refuzoi të përgjigjej dhe të vetmen gjë që kërkoi ishte një qese me duhan për llullën e tij, kërkesë që iu plotësua nga piloti i helikopterit ushtarak, Jaime Nino de Guzman, i cili kish sjellë posaçërisht kolonelin Zenteno Anaya dhe superagjentin amerikan me origjin kubanë, Felix Ismael Rodriguez Mendigutia (1941), mbajtës i katër pseudonimeve në karrierën e gjatë e të suksesshme. Të nesërmen, pra më 9 tetor 1967, Presidenti Barrientos urdhëroi ekzekutimin e tij, edhe pse amerikanët e deshën të gjallë, për ta transportuar e marrë në pyetje në Panama. Ai i trembej një arratisjeje të mundshme të Che, apo qoftë edhe një gjyqi, që mund t'a vishte Che me petkun e heroit. E habitshme mbetet edhe vetë vdekja e Barrientos në një aksident ajror në Kocabamba më 27 prill 1969 dhe mikut të ngushtë, Ministrin të Brendshëm, Antonio Arguedas Mendieta, që kish qenë një marksist dhe njëkohësisht agjent i fshehtë i CIA-s, arratisur nga Bolivia e kthyer më në fund në La Paz, ku duke përgatitur një bombë artizanale gjeti vdekjen, pasi ajo i shpërtheu në dorë në vitin 2000. Ishte ky, që i dorëzoi CIA-s Ditaret e Che-së. I pranishëm në orët e fundit të Che, ishte siç e përmendëm, edhe superagjenti i famshëm CIA-s i iku nga Kuba, Felix Rodriguez, dërguar posaçërisht me mision. Femra e fundit që Che takoi sa që gjallë, ishte mësuesja 22-vjeçare e shkollës së fshatit La Higuera, e quajtur Julia Cortez, e cila dëshmoi se në orët e fundit, Che kishte një shikim zhbirues, ishte i qetë dhe ironik. Ekzekutimin e tij e mori përsipër vullnetarisht apo me short një tjetër rreshter, që njihej si i alkoolizuar, 27-vjeçari Mario Teran, në shenjë hakmarrjeje për vrasjen nga guerillasit, vetëm disa ditë më parë të tre



shokëve të njësisë së tij, që për coincidençë, kishin edhe ata të njëjtin emër, Mario. Pasi ushtarët bënë foto me Che-në e lidhur, Teran hezitoi disa sekonda, deri sa me një karabinë M2, shtiu plot 9 herë mbi trupin e Guevatonin pse ai u duhej i gjallë! Ashtu të plagosur, e lidhën dhe e izoluan në shkollën e fshatit, ku tentuan ta marrin në pyetje. Che refuzoi të përgjigjej dhe të vetmen gjë që kërkoi ishte një qese me duhan për llullën e tij, kërkesë që iu plotësua nga piloti i helikopterit ushtarak, Jaime Nino de Guzman, i cili kish sjellë posaçërisht kolonelin Zenteno Anaya dhe superagjentin amerikan me origjin kubanë, Felix Ismael Rodriguez Mendigutia (1941), mbajtës i katër pseudonimeve në karrierën e gjatë e të suksesshme. Të nesërmen, pra më 9 tetor 1967, Presidenti Barrientos urdhëroi ekzekutimin e tij, edhe pse amerikanët e deshën të gjallë, për ta transportuar e marrë në pyetje në Panama. Ai i trembej një arratisjeje të mundshme të Che, apo qoftë edhe një gjyqi, që mund t'a vishte Che me petkun e heroit. E habitshme mbetet edhe vetë vdekja e Barrientos në një aksident ajror në Kocabamba më 27 prill 1969 dhe mikut të ngushtë, Ministrin të Brendshëm, Antonio Arguedas Mendieta, që kish qenë një marksist dhe njëkohësisht agjent i fshehtë i CIA-s, arratisur nga Bolivia e kthyer më në fund në La Paz, ku duke përgatitur një bombë artizanale gjeti vdekjen, pasi ajo i shpërtheu në dorë në vitin 2000. Ishte ky, që i dorëzoi CIA-s Ditaret e Che-së. I pranishëm në orët e fundit të Che, ishte siç e përmendëm, edhe superagjenti i famshëm CIA-s i iku nga Kuba, Felix Rodriguez, dërguar posaçërisht me mision. Femra e fundit që Che takoi sa që gjallë, ishte mësuesja 22-vjeçare e shkollës së fshatit La Higuera, e quajtur Julia Cortez, e cila dëshmoi se në orët e fundit, Che kishte një shikim zhbirues, ishte i qetë dhe ironik. Ekzekutimin e tij e mori përsipër vullnetarisht apo me short një tjetër rreshter, që njihej si i alkoolizuar, 27-vjeçari Mario Teran, në shenjë hakmarrjeje për vrasjen nga guerillasit, vetëm disa ditë më parë të tre

**A ka ardhur në Shqipëri Ernesto Guevara në marsin e vitit 1960?**

Che Guevara duhet të ketë ardhur në Shqipëri në pranverën e vitit 1960 dhe unë rreshtohem mes atyre që e besojnë këtë, por nga ana tjetër, mbetet enigmatike; pse u mbajti kaq gjatë ky mister nga të dy palët, që edhe sot mbulohet nga një tisi i errët! Si shpjegohet që atë, nuk e prit diktatori Hoxha, gjë të cilën, si më parë, ashtu edhe më vonë, ai e kish bërë dhe do e bënte, për figurën dhe personalitetin e rangut shumë më të ulët se Che?! Ende Enveri, që sapo i kish kaluar të pesëdhjetat, mbahej mirë me shëndet, madje pak muaj më vonë ai do merrte rrugën e gjatë, mes acarave politike të "Dimrit të Vetmisë së Madhe", siç e ka përcaktuar gjeniu Kadare dhe acarit të njohur të motit në Moskën e nëntorit 1960, aq e famshme për shizmnën e madhe të komu-






nizmit. Njeriu që ka folur më gjatë për këtë vizitë, është Zeqi Agolli, i pari sekretar personal i diktatorit, kur ai ende jetonte dhe punonte në hotel "Dajti", e që më pas u bë një nga diplomatët dhe funksionarët më jetëgjatë të Ministrinë e Punëve të Jashtme.

I thirrur nga kryeministri Shehu, Zeqi Agolli tregon se u urdhërua prej tij të priste në aeroportin e porsandërtuar nga të burgosurit në Rinas, një delegacion miqsh të huaj, të cilëve nuk u duhej bërë asnjë pyetje. Vetë Agolli, mesa duket e kuptoi mirë detyrën. I shoqëroi ata në zyrën e kryeministrit dhe mori edhe vetë pjesë në takim. Ai, rrefëson se u fol gjatë spanjisht mes tyre dhe pati shkëmbim pikëpamjesh, më të cilave edhe nga ato që nuk përputheshin mes tyre. Che injoronte dhe nënvlerëson te partitë politike, qofshin edhe revolucionare ato dhe rolin udhëheqës të tyre (me sa duket nisej nga shembulli kuban). Ai parapëlqente ndezjen e vatrave lokale, të cilat do e përhapnin flakën e revolucionit kudo. Nga ana tjetër, Che ashtu si edhe Fidelit, ende nuk kish një qëndrim të prerë, se anën e kujt duhej të mbante në konfliktin ideologjik mes komunistëve sovjetikë dhe atyre kinezë. Këto pikëpamje Shehu,

duhet t'ia ketë transmetuar menjëherë Enver Hoxhës dhe në mënyrë të padiskutueshme, këto duhet të ketë qenë edhe arsytet e vërteta, pse ai nuk denjoi ta sajdisë as për kortezi Che Guevarën, që priti më kot dy net në vilën luksoze të Erebarave, dibranëve atdhetarë e intelektualë të shquar e të pasur; të cilëve regjimi ua kish shtetëzuar atë fill pas luftës. Ai e kaloi kohën pa dalë nga vila duke luajtur me një automatik, dhuratë surprizë kjo e Shehut, domethënien e çuditshme të së cilës, edhe sot e kemi të vështirë ta kuptojmë, po të kemi parasysh, se në mars të 1960, ende Shqipëria nuk prodhonte armë, pasi akoma s'ishte ndërtuar Uzina e Armëve e Gramshit, e vetmja e këtij lloji në vendin tonë, që prodhoi me teknologji dhe çelik kinez e më pas suedez, "Kallashnikovë" dhe "Karabina" vetëmbushëse "Simonov" dhjetëshe dhe njëzetëshe (dhe jo siç thuhet shpesh gabimisht e Policanit, ku prodhoheshin vetëm fishekë e predha).

Che-së nuk i mungonin armët, qofshin amerikane trofe, apo sovjetiket dhe kinezet! Si mund të shpjegohet fakti, që edhe pse Che, tashmë nuk ishte në ilegalitet, madje de facto ishte nr. 2 i regjimit kastrist, vizita në Shqipëri u mbajt "top secret", ndry-



she nga vizitat e së njëjtës periudhë në disa nga vendet e tjera socialiste, që u bënë të gjitha publike. Asnjë proces verbal, asnjë fotografi dhe asnjë filmim i vizitës dhe takimit me Shehun nuk është gjetur deri më sot, edhe pse regjimi ynë diktatorial u kushtonte rëndësi të veçantë këtyre, deri në detajet më të imta. Vetë diktatori e ka përmendur vetëm njëherë Che-në, gjatë një bisede me dy drejtues të Partisë Komuniste (M-L) të Ekuadorit plot 50 vite më parë, më 21 tetor 1968, ku ai e quan atë "një luftëtar të mirë të majtë", por jo një marksist-leninist dhe vazhdon: "Përse duhet ta vajtojme vrasjen e Che-së, në fund të fundit revolucionarët vriten"! Me sa duket, Hoxha nuk mund ta prantonte dhe miratonte dorëzimin e Che-së!

Interesant mbetet edhe një fakt tjetër. Në një intervistë të dhënë vite më parë për autorin pasionant të disa librave për Che Guevarën, të cilin duket haptazi që e ka idhull, Jovan Jano, studiues apartiak i majtë, Zeqi Agolli, edhe pse tregon për vizitën e Che-së në Tiranë, befasom me anonimitetin e tij lehtësisht të kuptueshëm e të zbulueshëm, duke mos pëlqyer të identifikohet! Por vite më pas, teksa po i afrohet 100 viteve, duket se e "harron" këtë, madje shfaqet publikisht me zë dhe me figurë, në një ekskluzivë të para disa javëve në "Top Channel", dhënë gazetarit Marin Mema, ku pasi thotë që edhe pse flas pjesë gjuhë, duke mos ditur spanjisht, unë nuk kuptova asnjë fjalë nga biseda Shehu-Che! Natyrisht, kuptohet me lehtësi, që këtu ka diçka që nuk shkon. Së fundmi, mund të arsyetojmë në favor të faktit që Che e ka vizituar Tiranën, edhe me dy argumente të tjera: së pari, Che merretë pjesë, siç dëshmon Zonja Pogaç, bashkëshorte e ambasadorit shqiptar në Kubë, në pritet që ambasada jonë atje jepte në raste festash dhe kjo s'ishte rastësi, e së dyti, ai ishte drejtuesi i vetëm i lartë, që vizitoi dhe bisedoi në një nga salelet e hotelit ku ishin akomoduar, me anëtarët e delegacionit më të lartë qeveritar të Tiranës, dërguar ndonjëherë në Kubë, kryesuar nga Ministri i Drejtësisë, Bilbil Klosi (nëse kishin të një të tillë Shqipëria komuniste!), e natyrisht edhe kjo s'mund të ishte rastësi. Të tjerë shqiptarë që kanë takuar Che-në, mund të përmendim Kiço Ngjelen, ish-ministër i Tregtisë (dënuar më vonë), Eleni Pashko Terezi, aparatikë të lartë të Komitetit Qendror si Mihallaq Gjiniqasi e Qemal Myrseli, diplomatë si ambasadori Pogaç, Labo Abazi, Pertef Hasanmataj, atashme tregtar, Tiri Çollaku e ndonjë tjetër.

**E vërteta ndryshe për Ernesto Che**

**Guevarën dhe një përfundim**

Do të ishte naivitet, nëse autori i këtij shkrimi për Che Guevarën do ta konsideronte shterues atë. Për Che-në, është e vërtetë që janë shkruar libra dhe publicistikë e shumë, janë bërë filma e dokumentarë kinematografikë dhe televizivë, madje për të janë bërë edhe këngë (ku më e pëlqyera mbetet ajo e këngëtares së famshme kubane Nathalie Cordona "Comandante Che Guevara"). Të famshëm atë e bëri dhe fotografia e Alberto Kordës "Guerrillieri heroik", vlerësuar nga një Institut Artesh në Merilend, si fotoja më e bukur e shekullit të XX-të, e stampuar në miliona bluza, të shitura, sa për propagandë, poaq edhe për biznes, apo e stampuar si tatu (fjalë e njëjtë me një nga pseudonimet e Che-së), në trupin e Tajsonit dhe Maradonës.

Ekzekutimi i Che-së ndodhi në prelude e Pranverës Revolucionare të Rinisë më 1968 (sidomos në Francë) dhe mjeshttrat e mëdhenj të palodhshëm të propagandës së majtë, të trushpëlarjes dhe trulllojes së njerëzve, e shfrytëzuan dhe e përdorën në favor të tyre shembullin e tij, sidomos mes rinisë studentore. Ata shfrytëzuan po kaq mirë dhe takimin e vlerësimit e parë të Sartrit (Jean-Paul Charles Aymard Sartri 1905-1980), babait të ekzistencializmit dhe Dë Bovuarit (Simone Ernestine Marie Bertrand de Beauvoir 1908-1986), bashkëjetuese e Sartrit, me Che-në në zyrën e tij në Havana, mars 1960, për t'i bërë më pas atij një publicitet të amplifikuar. Më vonë, Sartri ky filozof i madh frëng, i rishikoi qëndrimet dhe vlerësimet e tij të majta, duke pranuar se kishte gabuar (sidomos për socializmin e llojit sovjetik, ku krimet e tmerrshme dhe varfëria e skajshme për miliona njerëz, ishin ambalazhuar me një cipë të sheqerosur nga propaganda e fuqishme zhdanoviane e Stalinit e pasuesve të tij).

Edhe në Shqipëri është shkruar jo pak për Che Guevarën, por është interesantë të thuhet se në gjallje të Enver Hoxhës, kjo nuk ndodhi dhe natyrisht, jo vetëm për shkaqet që treguar më sipër; që çuan në mospërfilljen ndaj tij, por edhe për faktin se Partia Komuniste kubane dhe Kastro u konsideruan shpejt revizionistë nga Hoxha, ndaj dhe nuk guxoi kush të shkruajë për të. Nostalgjia për Che-në, çuditërisht shpërtheu te ne, fill pas përmbyesjes së regjimit. Më shumë se për Che-në, kjo ishte nostalgji për mënyrën afërsisht të ngjashme me të cilën erdhen në pushtet komunistët shqiptarë dhe si një justifikim për terrorin dhe krimet që ata bënë, si gjatë, ashtu dhe pas Luftës, duke kompromentuar rëndë

heroizmin, sakrificat dhe gjakun e derdhur kundër pushtuesve nazifashistë. Ndryshe, si duhet kuptuar fshheja e anëve të errëta, krimet dhe terrori, që deri personalisht edhe ndaj bashkëluftëtarëve, madje dhe miqve të ngushtë zbatoi Che-ja, kur ishte guerilas dhe fill pas marrjes së pushtetit, kur i kërkoi Fidelit emërimin në postin e komandantit të burgut të tmerrshëm "Kabanja" që më 2 janar 1959, në më pak se 6 muaj u ekzekutuan deri 105 persona!

A nuk ngjan ai me kryeterroristin shqiptar Enver Hoxha, kur "dekoronte" me plumba pas koke, Anastas Lulën, Zai Fundon, Mustafa Gjinishin e shumë të tjerë, burgoste e interronte Ymer Dishnicën, Sejfulla Malëshovën, Zef Malën, Gjini Markun etj., për të mos përmendur listën pa fund të anëtarëve të Politbrosë, të Komitetit Qendror, ministrave, gjeneralëve, deputetëve e shumë kuadrove të larta, që shkoi deri te Mehmet Shehu, të ekzekutuar; burgosur e internuar nga "Fideli" ynë!

Me të drejtë mund të pyesë dikush: Pse Che-ja nuk u ngrit të organizonte në luftën për liri, barazi, demokraci dhe drejtësi kundër borgjezisë kapitaliste dhe latifondistëve, popullin e tij argjentinas, por mori rrugët e malit deri në Kubë, Afrikë e Bolivi, mijëra e mijëra km larg?! Pse Che-ja nuk e nisi barazinë nga familja e tij, pasurinë e madhe të së cilës, mund t'iu a shpërndante të varfërvë, duke i shpëtuar edhe nga shtypja e shfrytëzimi kapitalist, që me aq paqion ai, përpigjet t'i shpjegojë në tre librat e shkruar; apo publicistikën e tij? A nuk del qartë dyfytërsia e Che-së, në pasionin e egër të tij për t'iu a marrë tokën, fabrikat, pronat të tjerëve, kur kryesonte komisionet apo dikasteret për shtetëzimet dhe reformat, e shpesh, duke iu a marrë edhe jetën!

A nuk ishte e Che-së përgjegjësia për dështimet e rënda të industrisë, bujqësisë dhe financave kubane, konstatuar herët nga ekonomistat i famshëm francez René Dumont, e shumë të tjerë?! Po për moralin e Che-së, ç'mund të na thonë idealizuesit tanë të majtë?! Lidhjet e para të njohura me një femër: ishin ato me një grua të martuar; 30 vite më e madhe se ai, vajza e madhe e dy herë Presidentit hondurian, Ponciova Leiva Madrid dhe gruaje e biznesmenit amerikan Henry Holst, marksist e majtë e Aleancës për Gruan, farkëtuar në kudhrën e komunizmit në Bashkimin Sovjetik dhe Kinë?! Pa u divorcuar ende nga Hilda, nëna e femijës së parë të tij, që aq shumë u investua për të, ai kalonte netët e nxehta pyjeve me Aleidën, e cila edhe pse nëna e katër fëmijëve me të, tradhetohej lehtësisht prej tij në xhunglat e Afrikës dhe në pyjet e Andeve, me shoqen komuniste Tanja, që po të ishin partizanë në Shqipëri, do të kishin pasur fatin e Ramizë Gjebresë e Zaho Kokës, të cilët "moralit" partizan i goi drejtë vdekjes, moral ky, që për trojëkën Hoxha-Shehu-Kapok nuk vlient!

Ky pra ishte Ernesto Guevara, i mbiqajtur "Che" prej miqve të tij kubanë, që kur u njoh në Meksikë me ta, të cilëve u bënte përshlyetje përdorimi i shpeshitë i fjalës "Che", që rëndom përdoret nga argjentinasit dhe ka kuptimin miqësor "hej", glorifikimi majtist gjysmëshekullor i figurës së tij, duket se është "ndihmuar" sadopak edhe nga kartizma, që do ia kishin zili edhe aktorët e Hollivudit, por kjo vetëm për filma, se në jetë shkishin pse të zgjidhnin vetë sakrificimin e jetës, falë delirit të madhësisë dhe protagonizmit.

(Diplomat e opinionist)



## INTERVISTA

# BUJAR ALIMANI: “Delegacioni”, për rezistencën intelektuale

Fatmira Nikolli

Të bësh në jetë atë që bën në artin tënd. Kjo është fraza e parë që më erdhi në mendje, pasi kam marrë përgjigjen për një prej pyetjeve drejtuar regjisorit shqiptar që sjell në atdhe një çmim të parë evropian prej një gare të kategorisë A.

“Rezistenca intelektuale!” - më thotë si përgjigje Bujar Alimani, kur e pyes për atë linjë të parë që mbase nuk thuhet me zë të lartë, por është aty pas çdo skene e pas çdo dialogu në filmin “Delegacioni”, i vlerësuar me “Grand Prix” në Festivalin e Filmit në Varshavë. Më flet pastaj për lirinë dhe raportin e vështrirë që ne kemi me të, për të qenit të dashuruar e se si kjo ndjese vjen pasi e ke vrarë frikën. Përtej asaj që Alimani pohon unë marr prej tij shpresë, se përtej gjithë zhgënjimeve ka nga ata që qëndrojnë, e që e tregojnë të shkuarën duke e parë të tashmen e të ardhmen në sy për t'i thënë “mos i ngaj!”.

Muajt e fundit debatet publike kanë sjellë një tronditje mes njeriut e artistit, vijën që i ndan, atë që i bashkon, besnikërinë ndaj asaj që recitojnë a përpojnë me punën që bëjnë, e mandej thyerjen e të gjithave kur lenë sheshxhirimin a skenën, në raportin personal të secilit me (pu)shitetin. Si rënia e një perdeje, të madhe e gjigande jemi rrezuar, rezistenca intelektuale e Alimani më ofron një tjetër dimension.

Atë që Alimani e thotë me regjinë dhe me rrëfimin e pohon edhe anëtarja e jurisë, Joanna Kos-Krauze, kur thotë: “Për pesëshen e anëtarëve të jurisë, ishte filmi më i përbushur...Mendua që ishte i tillë në çdo aspekt, që nga skenari, përmes një regjisure shumë të ndërgjegjësuar, karakteret e



Alimani në Varshavë

*Regjisor i qmori ‘Grand Prix’ në Varshavë, në një bisedë për filmin, lirinë e kauzën e Teatrit Kombëtar*

ndërtuara në mënyrë të shkëlqyer, aktorët në të gjitha episodet ishin fenomenalë, vlerësuam, gjithashtu, që ky ishte një ndër filmat e parë, në kinematografinë shqiptare, duke qmë filmi ishte me buxhet të ulët, por sakaq, shumë i mençur i mirëmenduar në produksion, film, që, gjithashtu, ka nevojë për mbështetje, por ky nuk ishte aspak argumenti kryesor, por vetëm një argument anësor, por në fund të fundit, një kinematografi e shkëlqyer, njerëz të ndërgjegjshëm dhe të pjekur kanë realizuar: (...) pastaj, nuk është e thjeshtë të bësh një kinematografi politike, e cila të prekë ndjenjat, të provokojë dhe në fund të jetë edhe humoristike. Prandaj, me të vërtetë një punë e shkëlqyer, ua rekomandoj të gjithëve, tekefundit, ky është një verdikt që do të shkaktojë bujë. Verdikti ishte unanim!”.

Skenari i filmit, shkruar nga Artan Minarolli, vendoset në tetor të 1990-ës. Një delegacion evropian vjen në Tiranë për të monitoru-



Alimani në Varshavë

ar vënien në jetë të reformave nga ana e qeverisë. Luani, protagonist i interpretuar nga Viktor Zhusti, nxirret fshehtas nga një burg i largët e sillet në kryeqytet. Ka qenë i burgosur politik për 15 vjet. Tani është kthyer në një aset shumë të vyer për qeverinë. Delegacioni evropian kryesohet nga një shok i vjetër shkolle i Luani. Detyra e tij është të verifikojë progresin e të drejtave të njeriut në Shqipëri.

Luani mund ta bindë atë se gjithçka shkon mirë. Por asgjë nuk shkon siç është planifikuar. Në film luajnë aktorët Viktor Xhusti, Ndrim Xhepa, Xhevdet Feri, Kasem Hoxha, Rovenal Lule, Blisim Muçaj, Selman Lokaj, Mehmet Xhelili, Kristaq Skrami. Pjesë e kastit është edhe aktori gjerman Richard Sammel (që ka luajtur te “Inglorius Basterds”, “La vita è Bella”) dhe Inva Mula që interpreton kolonën zanore të filmit, punuar nga Etleva Turkeshi Minarolli dhe Ilir Bajri.

Sot, të gjithë do të duam të marrim prej suksesit të tij, por pak prej nesh do të duam të pranojmë parimet e tij, sepse parimet bien ndesh me rregullat e me politikën, por ky është një film e kjo është një intervistë, për lirinë, rezistencën intelektuale dhe zërin që nuk pranon të bëhet fortatofolës, por dëshirën të mbetet vetëm zë, i qartë, i kthjellët dhe i pastër, është zëri i njeriut të lirë, që është i gatshëm ta paguajë lirinë e vet.

Më poshtë intervista.

**-Një Grand Prix për “Delegacionin” në Varshavë film Festival. Në mesin e festivaleve të filmit, çfarë vendi zë Varshava dhe çfarë domethënie ka një Grand Prix për kinemanë shqiptare?**

Festivali Ndërkombëtar i Varshavës hyn në listën me 15 Festivale të njohur si të kategorisë A nga Konfederata e Producentëve Botërorë të kinematografisë ku përfshihet dhe Berlioni, Kana, Venecia, Locarno etj. Të fitosh një GRAND PRIX në një festival të tillë është një gjë e jashtëzakonshme. Me çmimin që mora në Varshavë kinematografia shqiptare bën që ekspozicioni të rikthejë vëmendjen nga ajo.

**-Kenë punuar gjatë me të dhe e kishit si “amanet” ta çonit në fund. E prisnit ju një vlerësim të tillë?**

Që të jem i singërtë e “mërmërisja” nëpër dhembë një



Alimani në sheshxhirim

sukses të tillë. E dëshiroja pa dëshim dhe kjo është e natyrshme. Ky projekt më ka marrë rreth 11 muaj nga jeta e koha ime përfshirë dhe fazën përgatitore. Vështirësia ka qenë se më duhet të lija familjen në Nju Jork e të punoja në Evropë, gjë e cila nuk ka qenë e lehtë.

Përfundimi i filmit precizonte kryerjen e amanetit. Por unë nuk mund të mjaftohesha me kaq. Për mua ishte filmi im i tretë dhe duhet të ishte përtej amanetit, një vepër e plotë artistike. Dhe e kam projektuar veç si të tillë.

**-Një punë e nisur nga Minarolli. Një kastë e mirë aktorësh. Si e bëtë përzgjedhjen e tyre? Sa e vështirë ishte të realizoheshin rekuizitat e skenografitë për fillimvitet 1990, nga krevatet e dhomat, te veshjet e transporti?**

Artan Minarolli u nda nga jeta sapo e kish nisur projektin. Kish mundur të përcaktonte dy prej aktoreve kryesore Ndrim Xhepën dhe Xhevdet Ferrin. Gjithë pjesa tjetër u përcaktua prej meje më vonë. Na duhej të studionim me stafin fotografik dhe video të asaj periudhe. Për fat të mirë kishim një artist të jashtëzakonshëm me një eksperiencë të gjatë në kinematografi. I ndjeri Andon Koja, i cili u nda para një viti nga jeta. Dhe personalisht jam rritur në komunizëm dhe e njoh mirë atë periudhë me gjithçka ajo përmblante.

**-Kemi kaq kohë që u fshihemi të “huajve”, që iu fshihim realitetin tonë delegacioneve, që strukemi në dhimbjen tonë duke ua fshetur të tjerëve. Sa u perceptua kjo ndjese të publiku?**

“DELEGACIONI” është një trajtim i vërtetë dhe i thellë i atij realiteti. Në film ruhet një e mesme e artë mes jo denoncimit plakat të sistemit dhe nostalgjisë për të. U thelluam në marrëdhëniet e karaktereve kryesore që të bëjmë të besueshme një dramë, e cila në pamje të parë duket kaq klasike e që rrezikon të matesh me të duke rënë në trajtime formale.

**-Si u prit nga publiku i festivalit realiteti shqiptar në film? Çfarë komentesh morët? A është disi i panjohur për ta?**

Polakët nuk dinin shumë gjëra për Shqipërinë. Izolimi komunist



Skena nga filmi







dhe më tej "fluturimi" i Polonisë drejt Evropës krijoi një hendek kontakti, kështu që interesi i publikut ishte i madh njësoj si të zbulonin një vend që është pranë, por që nuk e kanë vënë re kurrë. Më tepër, pyetjet kishin të bënin me realitetin e sotshëm shqiptar dhe sesa influencë të çdo lloj forme ka e kaluara komuniste ndër ne sh-

qipetarët.  
**-Cili që motivacioni me të cilin u vlerësua filmi?**  
 "DELEGACIONI" mori dy çmime, një GRAND PRIX dhe CMI-MI ECUMENICAL për humanizmin, dashurinë dhe paqen që filmi i përcjell si mesazhe.  
 GRAND PRIX u motivua si një trajtim krejt modern i një teme te-

jet të vështirë siç është e kaluara komuniste.

**-Kur merrje urimet, përgëzimet apo review për filmin, çfarë të vinte në mendje?**

Më vinte ndër mend nëna ime që ishte në Shqipëri e priste dhe vajza ime në Nju Jork që, gjithashtu, ishte në ankth.

**-Nëse ka një ide kryesore, një linjë të parë që mbase nuk thuhet me zë të lartë, por është aty pas çdo skene e pas çdo dialogu, cila do ishte ajo?**

Rezistenca intelektuale.  
**-Duket se ende, tri dekada pas kohës në të cilën përquendrohet filmi, ne i fshihemi lirisë, apo jo?**

Është shumë e bukur, por shumë e vështirë të jesh i lirë. Shpesh njerëzit mendojnë se janë të lirë ose u pëlqen të ndjehen të tillë. Liria mendoj se ka një dimension krejt tjetër nga çfarë ne kemi perceptuar këto tri dekada. Shpesh duket se historia veçanërisht me ne shqiptarët bën riciklimet e veta. Që të jesh i lirë, do të thotë të jesh i dashuruar. Që të jesh i dashuruar, do të thotë të kesh vrarë frikën në çdo aspekt. Nuk e di në qoftë se këto të dyja ekzistojnë fort ndër ne.

**-Nga larg ti e ke ndjekur debatin për mbrojtjen e teatrove kombëtarë. Ke mbajtur dhe qëndrimin tënd herë pas here. A të janë mbyllur dyer për këtë? A je ndjerë ndonjëherë i vetëcensuruar për këtë?**

Unë nuk kam mbajtur qëndrim herë pas here, por kam mbajtur vetëm një qëndrim. Jam që Teatri Kombëtar të mos priset dhe që të kemi jo një, por disa teatro të tjerë. Fakti që flas hapur dhe pozicionohem nuk do të thotë aspak se vendosëm në formacione të përcaktuara politike. Unë nuk aderoj në asnjë parti dhe kam vlerësuar e vlerësuar çdo vendim qeveritar, i cili është në të mirë të artistëve të vendit tim. Në Shqipëri shpesh gjërat përplasen bardh e zi - o me ne, o kundër nesh. Mendoj se mund të jemi më tolerante në diversitetin e mendimeve për kauza të caktuara.

BOTIMI

“GURËTE VETMISË”  
 Autori misterioz Tom Kuka, një roman për masakrën e Çamërisë

Fatmira Nikolli



Një e folme çame, mes shqipes më të hershme se e ditëve tona e prapë shqipe e ëmbël, të zë pritë që në faqen e parë të romanit. Aty është nënë Zisja që i ka shkuar jeta dëm, aty janë kujtimet për Avdylin që doli nga shtëpia i veshur dhëndër e u kthye në qivur, aty është Paramithia dhe një takim ku burrat priten në besë, edhe pse një ditë qenë ulur; patën pirë e kënduar, duke u mburrur se kush e kërcente më mirë Osman Takën.

Aty janë legjendat, por është edhe historia që na kërkohet ta harrojmë për hir të integritimit e fqinjësisë së mirë, është gjaku i patharë dhe një fushë e madhe ku prehen të ikurit, ndanë lumit prej ku u dëgjohej ende zërat. Ky është një roman për dashurinë, për luftën, për lirinë, për familjen, për shpirtrat e humbur e të mbetur në mesrrege, për të tradhtuarit që u sakrifikuhan në emër të kujt, në fakt? Aty është e shkuara jonë, e gjyshërve që na e kanë treguar si përrallë, na e vunë në nënkresë në vend të princërve e princeshave, sepse ne patëm vetëm një mbretëri, atë të luftës dhe s'patëm kohë të mësojmë për dashurinë. Është rrëfimi i një dhimbjeje ku ndërthuren dy kohë, është një ankth që përçohet, nënë dhe vona ku fletë pas flete, kalon jetën e nënë Zises.

"Gurët e vetmisë", është romani i dytë i autorit që shkruan me pseudonimin Tom Kuka. Romani i tij i parë, "Hide mbi kalldrëm", u botua në nëntor 2017, po nga Botime Pegi. Ngjarjet vendosen në një vend diku mes kufijsh dhe mandej shfaqen një grusht njerëzish që përpiqen të ndërtojnë jetën dhe të ardhmen e tyre, aty ku kanë pasur rrënjët e të parëve, nën hijen e së shkuarës, duke u ruajtur nga pabesia e armikut. Shënimi i botuesit vëren se e shkuara, e sotmja dhe e ardhmja gërshetohen dhe rrjedhin lirshëm nga njëra të tjetra si të ishin enë komunikuese, retrospektiva dhe kujtimet herë pas here bëhen njësh, dhe vetë personazhet gjenden në një kohë të pakohë. Por, boshti i romanit përsillet rreth masakrës së Paramithisë, ku 72 burra, bujarë të dyerve më të mëdha çame u thirrën nga mitropolit grek me pretekstin për të vendosur paqen mes palëve, por u prenë në besë dhe u vranë të gjithë në përroin e Selanit. "Atje do të na presin në besë. Plot 72 burra. Besuat me dega e ullirit dhe zërat e butë, por do na e ngulën thikën pas shpine. Do i lëmë shtëpitë pa tra e gratë me kërti në bark. Duan që të shkullemi, por ne nuk kemi si dëgjojmë nga ai vesh, prandaj do na therin si bagëti. Ne shkruam që të piqeshim në Paramithi e të gjenim fjalën, por nuk donin as ta lëshonin fjalën, se na e prenë gurmazin me brisk. Kjo do të ndodhë, kur bari yt të jetë lartuar sa një bojë njeriu, por fara jote do të lulëzojë, kur të puqet me farën time", shkruan autori në vepër.

Shpirtrat e tyre, të ngecur mes dy botësh, nuk gjejnë paqe dhe përsillen mbi një barkë në lumë, si Karonti që shpinte të vdekurit në Had. Avduli fantazmë kërkon të paralajmërojë jo vetëm të birin, në të ardhmen, por edhe Feritin, në të shkuarën për mynxyrën e madhe që po gatitet.

Oguret e zeza që përshkojnë kohërat duan t'i nxitin njerëzit të lënë laçkë e plaçkë e të ikin, të shpëtojnë kokën. Armiku kërkon jo vetëm kamjen e tyre, por të ndërrojë gjuhë e emër, të asimilohen krejtësisht, derisa t'u shuhet fara. Shënimi i shtëpisë botuese vë në dukje se autori përçon jetën e përditshme të fshatit, të ndarë vetëm teorikisht mes kaurësh dhe muhamedanësh, shoqëruar gjithnjë me nota humorit, të shkaktuara hera-herës nga frika e së resë dhe padituria si në rastin e biçikletës; ka sjellë dhembjen e dashurisë që lëshon shigjeta reale sa ta bën trupin gjak, erodin që ta humbet mendjen deri në delirë. Kjo është një përrallë nga e kaluara, me djem gjaknxehtë e vajza lozonjare, me valle ndjellëse e shtjella kumtesh, që nxijnë lulet e lotojnë gjak. Këtu nuk ka prijës të shquar e fjalëmëdhenj, por ka vetëm njerëz shpirtmirë: qejflin, sedërlinj e besëplotë, që ngulmojnë për paqe. Historia e tyre plekset me mite e legjenda, të cilat jo vetëm janë pjesë e një përditshmërie të shtruar e të thjeshtë, por janë pjesë e thelbit të këtij populli të vogël e të harruar. Këta njerëz me rrënjë të thella, të ndërthurura në gëzime e hidhërime të moçme, jetojnë të zhytur në një fatalizëm që është njëherazi shpëtimtari dhe përndjekësi i tyre më i ashpër. Romani nuk ka stërhillime, gjykime e as leksione, por vetëm kujtime dhe mall. Kjo është një rrëfenjë epike për atë që ka nodhur vërtet një shekull më parë në tokat shqiptare. E, megjithatë, kjo mund të ishte historia e shumë të tjerëve, e çdo kombi të nëpërkëmbur, të tradhtuar e të braktisur. Ngjarjet që rrefehen këtu kanë ndodhur dje, por mund të ndodhin edhe sot.

Sabina Kodra:  
 Kërkohen shqiptarë për Shqipërinë

Isha në Romë datë 20 tetor kur mbërriti lajmi se Bujar Alimani kishte fituar çmimin e madh në Varshavë me filmin "Delegacioni". Mend m'u mbushën sytë me lot nga gëzimi. Jo se jam shumë altruiste e madhe (zot na ruaj ditët e sotme kjo do të ishte herezi e vërtetë) por sepse fitorja e Bujarit vinte në një moment kaq kompleks e të ngarkuar emocionalisht për të gjithë ne. Sepse Artan Minarolli edhe i vdekur fitoi çmimin që e kishte ëndërruar gjithë jetën. Zot çfarë ironie! Në kufijtë e mrekullisë. Nejshe përtej të gjitha notave melodramatike a patetike doja të ndaloja e të numëroja disa fakte se pse desh u quravista në hollin e hotel "Bernini" aty ku zhvillohej mer-

kato e MIA në orën 18:30 të datës 20 tetor (besoj nuk do ta harroj sa të jem gjallë këtë moment, vetëm nëse më zë alzaimeri apo demenca):  
 1. Fitorja e Bujarit është fitorja e të gjithëve, imja, jotja e të gjithëve. Ndoshta pak kush e di se çfarë konkurrence dhe vështirësie është te prodhosh sot një film, tani mendoni te shkosh në një festival të kategorisë A (janë vetëm 9 në të gjithë Evropën, ku pranohen vetëm 11-13 filma për kompeticion, ndërkohë që prodhohen mijëra filma në botë atë vit prodhimi që t'i konkurron). Imagjino të fitosh çmimin e madh. Është sikur Shqipëria të kishte fituar kampionatin evropian të futbollit.  
 2. Bukur se ky krahasimi i fundit më pëlqeu shumë, imagjino sikur Shqipëria të kishte fituar kampionatin evropian të futbollit

do të ishte ngritur i madh e i vogël e do të kishte shkuar në Rinas të priste kombëtarën. Nuk po merrem fare me atë se si u prit Bujari në Shqipëri. Artistët janë natyra të duruara, e dinë se kryqi që mbajnë mbi supë është i rëndë e gëzimi i suksesit është vetëm një shkallë drejt një mali akoma më të vështirë. ARTI dhe KULTURA do të na shpëtojnë! Ndoshta duket si slogan komunisto-bolshevik, ndoshta, por jam e bindur se nuk është larg dita që energjia krijuese në këtë vend do të arrijë të ndryshojë faqen.  
 3. Sepse flamuri shqiptar u ngrit triumfues në Varshavë, e ne shqiptarët nuk ishim lajmi i kronikës së zezë, por faqebardhës kulture. FALEMINDERIT, Bujar Alimani për këtë fitore madhështore!

Opinion i Ditës

# Mësuesit e të ardhmes, pse na nevojiten dhe pse nuk i kemi?

Nga Pëllumb Karameta

(vijon nga faqja 1)

... Risi që sigurisht i vlejné cilësive së formimit të mësuesve të ardhshëm. Nga ana tjetër, fakultete dhe qendra trajnimit, vendase dhe të huaja, kontribuojnë për trajnimin e mësuesve në detyrë. Me sa ofrohet, lexohet shqetësimi se si të përgatiten nxënësit për botën e ndërlikuar të së nesërme. Por, edhe pse ka shumë diskutime për nevojat e nxënësve dhe si të përmbushen më së miri ato, tek ne, por edhe në botë, janë të ngathtë diskutime se si duhet të jenë mësuesit e "shekullit të 21-të", apo si mund të orientohen mësuesit e sotëm "drejt së ardhmes". Çka, sigurisht, është hendek i madh. Sistemi arsimor i së ardhmes nuk mund të bëhet pa mësuesit që kuptojnë dhe përkushtohen për të bërë çfarë nevojitet. Ndërkaq, studimet konstatojnë se shumë nga mësuesit e sotëm nuk janë të përgatitur si duhet për këtë punë; se shumica e kurrikulave universitare dhe e programeve trajnuese për mësuesit në detyrë nuk janë hartuar për të shkicuar llojin e "praktikës mësimore të së nesërme".

Çfarë cilësi do t'i dallojnë mësuesit e shekullit 21? Deri në ç'masë, këto cilësi ndryshojnë nga cilësitë e mësuesit të shekullit të shkuar? Si mund të zhvillohen më mirë cilësitë e reja? A duhet të presim që të gjithë mësuesit t'i zhvillojnë njëherësh këto cilësi? A mund t'i shtohen repertorit profesional të mësuesit të shekullit 20 këto cilësi? Pyetje që kërkojnë përgjigje. Ndërkaq, literatura arsimore thotë pak mbi cilësitë e nevojshme të mësuesit të së ardhmes.

Në vitet e fundit të shekullit 20, termat "nxënia e shekullit 21", "nxënia në të ardhmen" (dhe terma të tjerë, p.sh., Arsimi 3.0) filluan të përdoren për t'iu referuar një grupi idesh që do të ndihmonin shkollat të plotësonin nevojat e nxënësve / shoqërisë së shekullit 21. Tani, pas një dekade e gjysmë, literatura për këto ide është e gjërë. Idetë janë vendosur në kontekste të ndryshme, të përshtatura nga disiplina të ndryshme, në mbështetje të qëllimeve të ndryshme politike. Rezultati është se këto terma, tani, janë pak më shumë se sa slogane. Ato përdoren për të nënkuptuar çdo gjë dhe asgjë. Potenciali i tyre transformues është zvogëluar. Cili është ky grup idesh? Dhe pse ndryshimi është i nevojshëm?

Në punën akademike dhe politike për të ardhmen e arsimin, pohohet që sistemet arsimore nuk po i plotësojnë "qëllimet për të cilët funksionojnë". Nuk po ndjekin zhvillimet në botën jashtë



arsimit, ndaj, nevoja për ndryshim është urgjente. Sistemi aktual u krijua për të përmbushur nevojat e ekonomisë së shekullit 20: riprodhimi i dijes që çmohej në kontekstin e Erës Industriale, si dhe përgatitja e klasifikimi i të rinjve për format e punësimit të asaj periudhe. Ndërsa kjo u bë mirë, bota e shekullit 21 ka nevojë për gjëra të reja. Kërkimet në fushë, identifikojnë tri "shtysa" kyçe të ndryshimit:

· Nevoja për performancë më të mirë të sistemit (më shumë nxënës / student të arrijnë nivele më të larta).

· Ndryshimet e mëdha ekonomike (ekonomitë e reja të parën, sidomos në kontekstin e politikave, ka qenë sipërfaqësor diskutimi i rrjedhës që kanë dy të tjerat në arsim. Sidoqoftë, ka arsye përse e para tërheq vëmendjen.

· Ritmi eksponencial i ndryshimit teknologjik.

Ndërkohë që flitet shumë për të parën, sidomos në kontekstin e politikave, ka qenë sipërfaqësor diskutimi i rrjedhës që kanë dy të tjerat në arsim. Sidoqoftë, ka arsye përse e para tërheq vëmendjen. Si rezultat i ndryshimeve të mëdha dhe të vazhdueshme ekonomike dhe teknologjike (si dhe sociale dhe politike), kanë ndodhur dy gjëra që kanë rëndësi të madhe për arsimin. Njëra është kuptimi i ri i dijes në "shoqëritë e reja të dijes", i cili vë në pikëpyetje gjithçka në sistemet e arsimin të shekullit 20 (P.Karameta "Kulti tradicionalist i dijes po zhvlerësonin diplomat", Gazeta Mapo, 2011). Tjetra është "revolucionin digjital" që po ndryshon dramatikisht konceptin për punën dhe punësimin. Kjo vë në pikëpyetje bazat e edukimit të shekullit 20. Këto dy ndryshime

janë arsyeja që, tani, kemi nevojë për sisteme arsimore të afta që t'i edukojnë të gjithë - jo vetëm elitën - në nivelin universitar. Ndërkaq, dhe kjo është e rëndësishme, formimi universitar nuk do të jetë ashtu si e njohim atë tani.

Këto tendenca, nëse merren seriozisht, e sfidojnë fort modelin arsimor me rëndësi në shekullin 19 dhe të formësuar në shekullin 20. Përgjigja e praktikës shkollore ndaj atyre nuk ka qenë e duhura. Në nivelin "teorik", p.sh., flitet për rëndësinë e "personalizimit" të mësimit; për ndërtimin e "fuqisë së nxënies"; për rishqyrtimin e marrëdhënieve mësues-nxënës (dhe shkollë-komunitet); për mënyra të reja të mendimit rreth barazisë dhe larmisë njerëzore. Shpesh, duken referenca për "zhvillimin e aftësive të nxënies" ose për "4K" e nxënies në shekullin 21 (komunikim, koordinim, mendim kritik dhe krijimtari). Në kontekstin strategjik, termi "të nxënies të shekullit 21" zakonisht lidhet me nevojën për infrastrukturë dixhitale, gjithnjë e më të sofistikuar - broadbande ultra të shpejtë - dhe përmirësimin e pajisjeve për nxënësit e mësuesit. Kjo, padyshim, është e rëndësishme: megjithatë, investimi në TIK nuk shkakton zhvendosjen njohëse të nevojshme për ndërtimin e sistemit arsimor të së ardhmes.

Në nivelin praktik, sistemet arsimore aktuale janë përqendruar në zhvillimin e "objektivave" të arrijve më të larta (p.sh. deri në vitin 2020, 85 përqind e 18-vjeçarëve të arrijnë notën 8 ose më lart apo 40 përqind e nxënësve të mësojnë një gjuhë të dytë). Kërkohej matje më formale dhe të rregullta të arrijve të nxënësve në nivelet e sistemit. Këto strategji, megjithëse

të rëndësishme, nuk do ta prodhojnë sistemin e ri. Çaqet dhe përmasat e arrijve të nxënësve vijnë nga sistemi tradicional, i projektuar për të vlerësuar njohuritë dhe aftësitë e "vjetra" - të hartuara për shekullin e shkuar. Edhe pse disa nga këto dije "të vjetra" janë themelore (dhe do të jenë akoma të nevojshme), nxënësit e shekullit 21 kanë nevojë për orientim në dije dhe kompetenca shumë më të ndryshme nga ato të inkurajuara në sistemin e shekullit të shkuar. Përveç kësaj, në nivel më praktik, përqendrimi i tanishëm vetëm në arrijtë e matshme e largon shkollën nga fokusi për të ardhmen. Më tej, ai marginalizojnë "aftësitë e buta" (soft skills) si mendimi kritik, bashkëpunimi, krijimtaria, e kështu me radhë.

Disa shkolla në vende të ndryshme - pohojnë studiuesit - po përdorin ide dhe mjete të zhvilluara nga edukatorët e vendeve të tjera, por ecjen e tyre drejt së ardhmes. P.sh., disa shkolla në Zelandën e Re kanë përdorur strategjitë e ofruara nga "Nëntë portat" ("Nine Gateways") dhe "Katër thellësitë" (Four Deeps) të zhvilluara në Angli nga D. Hargreaves dhe kolegët. Të tjerë mbështeten në konceptin "Tablloja e madhe e nxënies" (Big Picture Learning) të zhvilluar në SHBA, ndërsa në mjaft shkolla të reja, për të projektuar hapësirat mësimore, përdoret koncepti i Mjediseve të Nxënies Moderne (Modern Learning Environments).

Shkollat, megjithësisht, po i përdorin këto ide, jo për të zhvilluar "atë praktikën tjetër mësimore" që kërkohet, por për të plotësuar dhe përsosur prak-

tikat tradicionale. Kjo nuk është e dobishme. Së pari, shkollat, tani, edhe pa iu shtuar detyra të reja, kanë shumë për të bërë. Së dyti, dhe ndoshta më e rëndësishmja, nuk e ndihmojnë ndryshimin idetë e importuara e të shtuara në kornizat ekzistuese. Idetë e reja janë të rëndësishme, por vetë, të marra nga të tjerët, nuk janë të mjaftueshme për të prodhuar të renë që duam. Siç kanë argumentuar teoricienët konstruktivistë, për tridhjetë apo më shumë vite, shtimi i ideve të reja në skemën mendore ekzistuese, zakonisht, nuk e ndryshon atë. Idetë e reja asimilohen apo i përshatën skemën ekzistuese, por, kur kjo nuk mund të bëhet, ato mënjanohej dhe / ose refuzohen. Ndryshimi për të njohur kërkim ndryshim në skemën themelore të të menduarit. Ai kërkim ndryshim, jo për atë që mendon individi, por në mënyrën se si ai mendon. Ndryshim në sistemin që përdoret për të shpërfaqur, organizuar dhe për t'u dhënë kuptim ideve të reja. Ky lloj ndryshimi është i vështirë. Shumica e njerëzve, ose nuk janë të gatshëm, ose nuk mund ta bëjnë këtë ndryshim në nivelin e skemës, nëse nuk ekzistojnë kushte të caktuara.

Në tërësi, nxënia që të transformon është e vështirë dhe jo të gjithë mësuesit dhe pedagogët janë të gatshëm ta ndërmarrin atë. Kjo do të thotë se ajo që bëjmë për të ndërtuar mësuesit e ardhshëm, në fakultete apo me programe trajnimit, duhet të jetë "e personalizuar" për nevojat e zhvillimit vetjak, si alternativë e fortë e qasjes "të gjithë bashkë, të gjithë njësoj". Kjo nuk duhet nënkuptuar si dizajnim i një larmie programesh të ndryshme, por si ofertë programore me aktivitetë dhe detyra "psikologjish të bollshme" që lejojnë mënyra të ndryshme angazhimi, nga pikënisje të ndryshme formimi.

Ajo që po mësojmë nga kërkimet në këtë fushë është se formimi apo zhvillimi i mësuesve të së ardhmes nuk arrihet duke iu shtuar programeve akademike apo trajnuese ide dhe qasje të reja, por duke i ndihmuar mësuesit të mendojnë dhe punojnë si duhet me pasigurinë, me ndërlikim dhe ndryshimet e vazhdueshme që i sfidojnë vazhdimisht. E ardhmja kërkon që studentët e mësuesit apo ata në detyrë të marrin pjesë në diskutime kolegjiale përmes shkëmbimit, të flurorit dhe veprimt; të nxënies profesionale, të diskutojnë paqartësitë, kontraktat ose arsyetimin e gabuar, të shqyrtojnë pikëpamjet për mënyrat alternative të mendimit dhe sjelljes, në nivele gjithnjë e më të thella etj., përtej leksioneve apo trajnimeve shtrëps, bisedave në sallën e mësuesve apo në hapësirat e ngushta, shpesh sipërfaqësore, të medie sociale.



Opinioni *i* Ditës

NGA Ilir Çumani

(vijon nga faqja 1)

... të mazhorancës në parlament. Mendoj se në radhë të parë, ai duhet të gjejë shkaku, pastaj pasojën...(!) I gjithë burimi kryesor i kësaj të keqeje që e ka sëkëllidur zotërinë e tij dhe e ka kontaminuar si një epidemi shoqërinë shqiptare me sindromin e shpifjes, ka të bëjë me një personazh mjaft të njohur në Tiranë, që nga koha e komunizmit. Këtë personazh e njih fare mirë edhe zoti kryeministër: Mban një emër të madh, historik dhe të lavdishëm. Jam i bindur se, sapo t'ia kujtoj, do të mallëngjehet fort, do t'i ngjallen shumë kujtime dhe nostalgji që lidhen me fëmijërinë dhe rininë e tij të hershme. Ky personazh mjaft i njohur, që për drejt ka ndikuar ndjeshëm si me magji tek të gjithë të "paudhët" të cilët i kanë prishur terezinë kryeministrit me shpifje, (veçanërisht gjatë qeverisjes së tij triumfatore përmes fasadës në këtë epokë të ndritur të rillindjes), quhet Enver. Të gjithë e njohin atë me nofkën "Ver Llapa", veçanërisht tiranasit e para viteve '90. Besoj se me këtë nofkë e ka e thërritur e thumbuar në fëmijërinë dhe adoleshencën e tij edhe vetë kryeministri ynë. Dikur, ai dhe personazhi me nofkën "Ver Llapa" kanë qenë banorë të një lagjeje në Tiranë, atje tek "21 Dhjetori". Atëherë, kryeministri ynë nderuar ishte një fëmijë solar dhe i përkëdhelur; lozanjar e tekanjor, ëndërrimtar dhe me temperament. Më pas u rrit dhe u bë një adoleshent ambicioz e plangprishës, i mikluar nga fakti se ishte djalë i një familjeje me emër në kryeqytet, biri i një deputeti të nderuar i nomenklaturës. Qysh nga ajo kohë, ai ka pësuar një metamorfozë të paimaginueshme. Ka ecur nxitimthi dhe në mënyrë të rrufeshme si një maratonomak, ka bërë goxha rrugë kilometrike në karrierën e tij për të kapur majat e pushtetit. Sot është kryeministër i vendit, ndërsa lagjari i tij i dikurshëm, "Ver Llapa", mbeti po ai, gaztori i pafajshëm, shakatar i kryeqytetit. I vetmi mjet për mbi jetesë me anë të së cilës mjerani fatkeq siguron qindarkat nga "puna" si gaztor rruge, i ka mbetur gjuha, me përmasa përtej normale që ka çdo njeri i zakonshëm. Gjuha e Verit, prej dekadash ka fituar një status krejt të veçantë. Me të, ai përdor sarkazmën e tij, qesh e përgjesh gjithçka normale dhe anormale që e rrethon në këtë vend të çuditshëm: edhe zhurmën marramendëse të metropolit, edhe britmat në parlament, edhe tam-tamet e qeverisë, edhe varfërinë e tij, edhe mjerimin e të tjerëve... Pra, gjuha e tij ka simbolikë dhe vet domethënëse. Tashmë, ajo është kthyer në legendë urbane qysh nga koha e komunizmit. Sa herë që Verit i kërkohet nga kalimtarë të ndryshëm që të nxjerrë gjuhën,



në këmbim të saj, ai shtrin dorën dhe kërkon pak lëmoshë, fare pak qindarka...(!) Me sa duket, ai e di fare mirë se jeton në kohën e ekonomisë së tregut dhe se çdo kërkesë që bëhet, ka edhe ofertën e vet. Gojë të liga thonë se, "lënda e parë" me të cilën punon sot industria e "kazanit mediatic" dhe ajo e "kazanit politik", sigurohet nga gjuha e "gojëpërdalit" "Ver Llapa". Pra, nga ish-lagjari i dikurshëm i kryeministrit, i cili e ka dhënë instrumentin e tij magjik (gjuhën), me "koncesion", si në parlament, ashtu edhe tek shumë media të shkruara dhe ato vizive...(!) Me sa duket, ky paska qenë shkak i kryesori i të gjithë asaj katrahure thashethemnjash që e ka sëkëllidur keqas kryeministrin tonë, aq sa i ka prishur jo vetëm avërin, por edhe gjumin e natës. Mirëpo, tashmë si kryeministër i vendit, z. Rama ka në dorë edhe gurin, edhe arën. Ndaj, i ka të gjitha mundësitë, me ushtri e polici, me prokurori e gjykatë që ta kapë e ta arrestojë qytetarin dhe ish-bashkëlagjari në emrin "Ver Llapa", ta lidhë këmbë e duar dhe pastaj ta bëjë "synet" nga gjuha. Pra, me një fjalë, t'ia presë llapën... Vetëm kështu kryeministri ynë ka për të parë se do të mund të bëjë "synet" të gjitha gojë e liga, që deri më tani janë xhelozuar nga ylli e tij i shndritshëm i suksesit. Në të kundërt, kryeministrit tonë të nderuar nuk i ngelet gjë tjetër, veçse të pranohet dhe të zbrisë me këmbë në tokë, të zvogëlohet, të zvogëlohet, të zvogëlohet..., aq sa të mos ngjallë smirën e të tjerëve,

sepe vetëm kështu ai edhe PPP-të e qeverisjes së tij do të kenë më shumë paqe dhe qetësi. Vetëm kështu nuk do të mund ta ngasë më njeri duke shpifur pafund për të dhe qeverinë e tij. Pastaj do të çelët një epokë e re: epoka e paqes dhe e begatisë, ku çfarë thotë partia, do të bëjë populli; çfarë do të kërkojë partia, populli-dele nuk do t'i kursejë edhe jetën.

\*\*\*

Në fakt, kryeministri me të drejtë thotë se shpifja është një fenomen negativ që Gjermania, Franca, Italia, e gjithë bota e qytetëruar, e konsiderojnë si një kundrvajtje që penalizon cilindo që e përdor atë. Por, ai nuk ka kurajë të na thotë se këto vende me demokraci solide kanë dhe zbatojnë një standard të njëjtë dhe të barabartë para ligjit për të gjithë shtetasit e tyre, si për qytetarin e thjeshtë, ashtu edhe për kryeministrin, deputetin, ministrin, gazetarin, cilindo që përmes pushtetit shpërdoron detyrën dhe vë dorë në paratë publike. Përtja që do të dëshironite të bënte sot çdo qytetar i këtij vendi është se, a mundet të na thotë kryeministri ynë i nderuar se kur do të gjejë zbatim në vendin tonë ky standard...!? Në parim, jam kundër të gjithë atyre që shpifin, por në bindjen time të brendshme kam dyshime të arsyeshme se nuk është ky shqetësimi real i kryeministrit. Në fakt, shpifja ka qenë dhe është një problem ekskluziv vinitoz dhe i ulët e luftës së pandershme e të paprincipitë e një klase politike infantile dhe e pamaturuar, i të gjithë spektrit politik shqiptar në këtë periudhë të tranzicionit. Ajo është një sjellje destruktive, agresive dhe e pamoralshme ndaj kundërshtarit politik dhe anasjelltas. Mbi të gjitha, është një luftë e vrazhdët dhe pa principë në garën me konkurrentëve të pandershmë, e më të "fortëve" të pushtetit të djeshëm dhe të sotëm, si edhe atyre që kanë qenë dhe janë të përfshirë e të zhytur në llumin e pistë të korrupsionit, të verbuar dhe të etur vetëm për pushtet e para. A nuk kanë bërë të njëjtën gjë si ata që ishin dje në opozitë dhe sot në pushtet, ashtu edhe ata që dje ishin në pushtet dhe sot janë në opozitë...!? Personalisht mendoj se ligjet janë të mjaftueshme dhe të qarta për kundrvajtësit e shpifjes. Por, kjo nisimë, e gjithë kjo përpjekje e kryeministrit tonë të nderuar nuk është e mjaftueshme dhe bindëse, është thjesht një tymnaje që nuk synon gjë tjetër veçse, intimidimin dhe gojëmbjelljen e zërit qytetar dhe atë opozitar; shuarjen e frymës së kritikizmit ndaj fenomeneve abuzive që lidhen me shpërdorimin e pushtetit dhe korrupsionin administrativ. E gjitha kjo vjen në kundërshtim me parimet bazë të informimit në favor të interesit publik, transparencës, të së Drejtës të Lirisë së mendimit dhe të shprehjes, në themel të së cilës duhet të prevalojnë vetëm standardet e një demokracie të pastër, të shëndetshme e funksionale.

HOROSKOPI

DASHI

Përdorni energjinë tuaj për të ndihmuar dikë pranë jush të çlirohet nga stresi. Të ardhurat financiare do të rriten, teksa ka gjasa t'ju krijohet një mundësi e re fitimi. Familja dhe miqtë do t'ju zënë pjesën më të madhe të kohës. Ndërsa sa i përket lidhjes romantike, nuk do të jetë dita juaj me fat.

DEMI

Bëni kujdes me shëndetin dhe kushtojni më shumë rëndësi. Mos humbtisi pas fantazive dhe tregohuni më realiste. Shpenzoni më shumë kohë me miqtë tuaj, pasi do të kaloni momente shumë të këndshme. Mos tregoni idetë dhe planet derisa ato të realizohen.

BINJAKET

Nisni meditimin dhe jogën për t'u ndjerë sa më mirë si fizikisht ashtu edhe psikologjikisht. Dikush do të tërheqë vëmendjen tuaj sot, megjithatë sigurohuni mirë para se t'i besoni atij. Tregohuni të vëmendshëm, pasi dikush mund të fitojë me ju.

GAFORJA

Sjellja juaj do të vlerësohet dhe shumë persona do të të komplimentojnë lidhur me këtë. Do të keni dëshirë të udhëtoni, por nuk është dita e përshtatshme për këtë. Romanca do të udhëheqë zemrën dhe mendjen tuaj sot.

LUANI

Kontrolloni peshën trupore duke bërë ushtrime fizike. Gjendja juaj financiare do të përmirësohet, por jo aq sa prisnit. Kushtojni kohën e duhur familjes. Bëjini ata të besojnë se ju vërtet kujdeseni për ta. Në punë do të kaloni një ditë frutdhënëse.

VIRGJERESHA

Ka gjasa që një projekt shumë i rëndësishëm t'ju bllokohet për shkak të gjendjes jo të duhur financiare. Mund t'ju vijë një letër që do t'ju sjellë një lajm të mirë për të gjithë familjen. Marrëdhënia juaj romantike po shndërrohet në magjike, ndaj shijojeni sa më shumë atë.

PESHORJA

Përpjekjet tuaja të mëdha dhe mbështetja e familjarëve do t'ju sjellë rezultatet e duhura. Megjithatë vazhdo të punosh fort për të arritur rezultatet e duhura. Miqtë do t'ju këshillojnë për jetën tuaj personale.

AKREPI

Neglizhenca e partnerit/partneres suaj mund të shkaktojë marrëdhënien. Përpuni të kujtoni momentet e bukura të lidhjes suaj në mënyrë që të riktheheni bashkë. Përshatjuni teknikave të reja për të rritur efikasitetin në punë.

SHIGJETARI

Rritja e papritur e shpenzimeve do t'ju sjellë shqetësim. Shmangni personat që përpunat të përfijtojnë prej jush. Një hapësirë personale është e rëndësishme në jetën tuaj në çift, megjithatë sot do të qëndroni shumë pranë njëri-tjetrit.

BRICJAPI

Mund ta gjeni veten në një situatë shumë emocionuese, që do t'ju bëjë të mendoheni gjatë. Përpuni të gjeni më shumë kohë për disa rregullime në shtëpi, çfarë do të kënaqë edhe anëtarët e familjes suaj. Ka gjasa të nisni një lidhje të re.

UJORI

Sot mund të merrni një vendim shumë të rëndësishëm, çfarë do t'ju tensionojë dhe do t'ju bëjë të ndihen nervoz. Përpuni të kontrolloni veten teksa do të përballeni me një situatë të vështirë. Ka gjasa të vlerësoheni me rritje në detyrë.

PESHQIT

Përpuni të mendoni pozitivisht. Mos shpenzoni shumë për t'u tërhequr vëmendjen të tjerëve. Anëtarët e familjes suaj do të rritohen sot për shkak të veprimeve tuaja. Përpuni ta zgjidhni sot një problem që iu mundon, pasi nesër do të jetë vonë.

**Presidenti i FIFA-s kërkon ndryshime thelbësore**

**Planet miliardere të Infantinos, UEFA kundër**

Presidenti i FIFA-s, Xhani Infantino është gati të publikojë një tjetër ide inovative për Botërorin e klubeve, për të përfshirë skuadrat më të mëdha. Pas kërimit të investitorëve për të paguar 12 miliardë dollarë për një turne që do të zhvillohej çdo 4 vjet, tani zvicerani që drejton qeverinë e futbollit



global, avancojnë sërish. FIFA ka premtuar se do të shpërndajë fitimet për Botërorin e klubeve të federatave dhe milionat nga kontratat me sponsorët do të gjenerohen edhe nga një tjetër turne që është propozuar të quhet Liga e Kombeve të botës. Kështu, në total do të përfitojnë 25 miliardë

në 12 vjet për të dy turnetë, një xhiro stratosferike financiare që ka opionencën e fortë nga UEFA dhe shoqata e klubeve europiane. Këtë javë Xhani Infantino do të prezantojë dy propozimet në këshillin administrativ të FIFA-s, që përbëhet nga 36 anëtarë. Mes opsioneve është dhe ai për një turne

vjetor, që do të zhvillohet mes korrikut dhe gushtit, gjithsesi mbetet për t'u vendosur. Mundësitë megjithatë janë thuajse zero që planet e presidentit të FIFA-s të realizohen me përpikëri. UEFA rrezon këto opsione me frikën se turnetë në fjalë do t'i heqin miliona dhe prestigji Ligës së Kampioneve.

**Mrumbullaku: Shpresoj të rikthehem sa më shpejt**

Mrumbullaku ka qenë shumë i pafat në këtë sezon të ri, pasi në takimin kundër Kastriotit ka pësuar dëmtimin e dytë. I sapo kthyer nga një dëmtim i mëparshëm, këmbëmbajtja e skuadrës verilindore u dëmtua sërish. Në rrjetet e tij sociale, 26-vjeçarë konfirmoi dëmtimin e tij, si dhe shprejtoi se do të mungojë për disa kohë. Duke mos haruar të falënderojë të gjithë për mbështetjen, mes të tjerave shkroi: "Ndonjëherë gjërat nuk na vijnë ashtu siç ne i dëshirojmë apo i presim. Rendësi ka të mundemi të menaxhojmë një situatë që na është shfaqur. Një dëmtim tjetër në kohë të fundit do të më lërë jashtë fushave disa kohe akoma, por shpresoj të rikthehem sa më shpejt dhe akoma më i fortë. Dua t'iu falënderoj për mbështetjen!"

Liverpuli 'shkërmoq' Zvezdën, Porto fitore në Moskë, Gallatasaraji barazon me Shalken

**Barça shumë e fortë për Interin, Napoli ndaj Paris Sën Zhërmenin**

*Dortmundi, poker golash Atletikos së Madridit*



Jeton Selimi

Barcelona-Inter ishte kryendeshja e mbremjes dhe justifikoi pritshmëritë, teksa katalanasit fituan 2-0 ndaj zikaltrëve, duke dominuar gjërë e gjatë në fushën e lojës. Përfundimi i ndeshjes ishte 2-0, ku zikaltrit u shfaqën kërcënues, blaugranat ishin zotër në pjesën tjetër, duke shënuar nga një gol në çdo pjesë loje. Braziliiani Rafinja çel rezultatin e ndeshjes në pjesën e parë, pas një pasimi fantastik të Luiz Suarezit. Ish-mbrojtësi i Interit ndëshkon Handanoviçin me një të majtë të saktë dhe çon ekipet në pushim me epërsinë minimale të të zotëve të shtëpisë. Edhe pjesa e dytë do të jetë fotokopja e së parës. Interi kërkon barazimin në 10 minutat e para, por më pas është Barcelona ajo që kontrollon dhe krijon pafund. Kutinjo do të ndalet nga shtylla, por do të jetë Zhordi Alba ai që i vë kapak ndeshjes pas një depërtimi të mirë në zonë dhe e dërgon topin në shtyllën e dytë të portierit slloven. 2-0, Barcelona me pikë të plota në grup, ndërsa Interi ndalet pas dy fitoreve radhazi.



Salah, 50 gola me Liverpoolin. Goli i dytë personal në takimin

kundër Cverna Zvezdës kishin një vlerë të veçantë për yllin egjiptian, Mohamed Salah.

Sulmuesi 25-vjeçar u ngjiti në kuotën e 50 golave me fanellën e Liverpoolit dhe iu desh vetëm

LIGA E KAMPIONEVE		
TË MARTEN		
<b>GRUPI E</b>		
AEK - Bajern Mynih		0-2
Ajaks - Benfica		1-0
<b>GRUPI F</b>		
Hofenheim - Lion		3-3
Shakhtar - Man.Siti		0-3
<b>GRUPI G</b>		
Real Madrid - Viktoria		2-1
Roma - CSKA Moskë		3-0
<b>GRUPI H</b>		
Jang Bojz - Valencia		1-1
Man.Junajtid - Juventus		0-1
TË MËRKURËN		
<b>GRUPI A</b>		
Klub Bryzh - Monako		1-1
Borussia - Atletico Madrid		4-0
<b>GRUPI B</b>		
PSV - Totenham		2-2
Barcelona - Inter		2-0
<b>GRUPI C</b>		
Liverpul - Cverna Zvezda		4-0
Paris Sën Zhërmen - Napoli		2-2
<b>GRUPI D</b>		
Gallatasaraji - Shalke		0-0
Lokomotiv Moskë - Porto		1-3

pak më shumë se një sezon për të arritur këtë numër jubilar. Golin e parë me fanellën e të kuqve, Salah e shënoi në takimin kundër Uotford, pas një asistimi nga Firminjo, ndërsa goli i 50-të erdhi falë një penalltie kundër Cverna Zvezdës, sfidë e vlefshme për Ligën e Kampioneve.

**TË TJERAT**

Napoli bëri një ndeshje të shkëlqyer përballë PSG-së, por djetmë e Ançelotit nuk ia dolën të merrnin tri pikët në Francë. Insinje dhe Mertens shënuan, por një autogol i Ruit dhe një gol në sekondat e fundit nga Di Maria ndanë pikët. Dortmundi mposhti thellë Atletikon 4-0, falë golave të Vitsel, Sañço dhe Rafael Gerrerros dy herë. Tri pikët i mori dhe Liverpooli, që shkatërroi 4-0 serbët e Cverna Zvezdës.

**SULMUESI KUQEZI**

**Shkëlqimi i Uzunit në Kroaci, i pesëfishohet vlera**

Myrto Uzuni është futbollisti i momentit nga Kombëtarja shqiptare, duke qenë se po kalon një moment fantastik në kampionatin kroat me Lokomotivën e Zagrebit. Paraqitjet e tij të mira, asistet, golat e shënuar dhe ambientimi i shpejtë me skuadrën e re e kanë bërë Uzunit një nga futbollistët më të dashur në Kroaci. Mediat kroate nuk i kanë kursyer elozhet në

drejtim të sulmuesit kuqezi, i cili në javën e fundit në kampionat u shpall edhe lojtari më i mirë falë golit dhe asistit në fitoren ndaj Hajdukut. Lokomotiva e Zagrebit, me këshilla nga Besnik Prenga e bleu futbollistin nga ekipi i Laçit, ndërkohë që shifrat e sakta nuk bëhen të ditura në Kroaci, por janë të bindur se vlera e tij nuk krahasohet me shpenzimet e bëra. "Megjithëse shuma është një sekret, Lokomotiva ka paguar më pak se 500 mijë

euro dhe pa marrë parasysh se sa është paguar, pas dy muajve Uzuni vlerësohet në treg së paku pesë herë më shumë se sa është paguar", shkruajnë mediat kroate për sulmuesin shqiptar. Sakaq, në kohën që Uzuni ishte te Laçi, "Transfermarkt" e vlerësonte 250 mijë euro, ndërkohë që një muaj më parë vlera e tij ka shkuar në 450 mijë euro. Për muajin tetor, "transfermarkt" ende nuk ka bërë përditësimet.

**Mozambikasi do të përballë me ish-ekipin e tij, Laçin**

**Rexhinaldo: Dua të fitoj "Këpucën e Artë"**


Në Kukës të gjithë i kanë sytë te mozambikasi Rexhinaldo, një lojtar me potencial, por edhe që e njeh shumë mirë rrugën e rrjetës. Sulmuesi erdhi tri vite më parë në Superiore, fillimisht për llogari të Luftëtarit, e më pas ka luajtur me Laçin e Kukësin. "I respektoj, por vetëm kaq, dua 3 pikët me Kukësin, nuk është momenti që unë të flas për të kaluarën time në radhët e skuadrës së Laçit, por të mëndojmë për

Kukësin. Kam dëshirë që të shënoj, madje nëse e bëj një gjë të tillë, e deklaroj hapur se nuk do të festoj. Golat? Unë dua që të shënoj sa më shumë në çdo ndeshje, por në radhë të parë vjen skuadra, pastaj golat që unë shënoj. Objektivi im personal është të jem golashënuesi më i mirë i sezonit. Kam shumë besim që do ta realizoj, të paktën të kaloj shifrën e 13 golave që shënona kampionatin e kaluar. Natyrisht dua edhe një trofë". Në fund, Rexhinaldo ka dashur që të

sqarojë një herë e mirë marrëdhëniet me trajnerin edhe në opinion publik. "Nuk kam shumë dëshirë ta diskutoj këtë pjesë, jam profesionist dhe mendohem të bëj më të mirën për skuadrën time, jam këtu për të luajtur futboll dhe nuk më intereson çfarë ndodh jashtë fushë. Nuk dua të flas për marrëdhëniet, sepse mendohem të respektoj shokët e skuadrës, trajnerët, presidentin, dua vetëm të bëj maksimumin për Kukësin".



**Fjalëkryqi (1)**



**HORIZONTAL**

- Niven që që akto.
- Little... kryeqyteti i Arkansas.
- Janë tek në lakër.
- Nuk ka akoma një bebe.
- Kufizojnë katete.
- Penn aktor.
- Hector që shkroi Pa familje.
- Thahen me bonifikime.
- Mbyllin takimin.
- Ndërmarrje Industriale Mat.
- Mbyllen me epilop.
- Tregohen indiferentë dhe aspak të gjallë.
- Ishin sandalet e lëkurëkuqve.
- Njëlljo për latinë.
- Eshhtë vend si Katari.
- Pupi regjisor.
- Janë strëhat e çobanëve.
- Eshhtë centrali si Chernobyl.
- Fillojnë një argument.
- Të parat në stadium

- Mund të sjellin shi.
- Kështu fillon Odisea.
- Një mund të jetë emërore.
- Thirrje edhe kështu Persefoni.
- Ai dhe ajo.
- E ka lënë atë që s'ka fuqi
- Para es Salaam.
- Ylli i Londrës.
- Eshhtë syzë... në komo.

**VERTIKALI**

- Hyskja aktor.
- Kush e thotë lutet.
- Një tis mjegulle.
- Maiden që këndojnë.
- Gjysmë rekord.
- Antonio skulptor i famshëm.
- David regjisor.
- Janë brinjë në skuadër.
- Ruan në kufij.
- Mban mikrofonin.
- Janë edhe ato të fytyrës.
- Qureshin edhe Eumenide.
- Demek pa kufij.
- Mund të jetë atomike.
- Qyteti i përjetshëm.
- Kitara e Ravi Shankar.
- Janë katrore në sipërfaqe.
- Një fjalë si goja.
- Pak daktilografi
- Eshhtë si divan.
- Një pjesë e amerikanëve.
- Bernhardt që që akto.
- Eshhtë infeksion në veshë.
- Një mund të jetë unik
- Gjysma e sasisë.
- Pak marramendëse.
- Eshhtë dhomë.
- Fillojnë takimin.
- Në fund majtas.
- Të fundit në manastir.

**Fjalëkryqi (2)**


**HORIZONTAL**

- E bardhë ajo Moby Dick.
- Fillojnë amplifikimin.
- Eshhtë vit që parashikohet.
- Mbyllin pamjen.
- U printe jeniçerëve.
- Thurman akto.
- Një reaksion në provëz.
- Një sport me brez të zi.
- Në fund të fundit.
- Janë në gjyq.
- I është hequr të dënuarit.
- Eshhtë shahu i fundit
- Janë fletë trëndafil.
- Kufizojnë një metër.
- Tregojnë pallate në miniaturë.
- Një fjalë pa shkak.
- Janë përlogaritje.
- Mbyllin një dritare.
- Të parat në muzg.
- Me të nxjerrin një letër.


- Janë me ngjyra të tilla si tunxhi.
- Toromani balermë.
- Iniciale e Reitman regjisor.
- Fillojnë politikën.
- Një piktor si Antonio Ligabue.
- Difong në dietë.
- Një lind në kokë.
- Kush ka... do të pijë.
- Punojnë në galeri.
- Fillojnë titrat.
- Mund të jetë ekspres.
- Mund të skadojë.

**VERTIKALI**


- Ishte titulli i Hiro Hitos.
- Ekberg akto.
- Eshhtë skuadra.
- Dy asa.
- Binjaket në klasa.
- Qe dhet sajdisur.
- Nuk i bihet me kokë.
- Sharif aktor.
- Janë organet e taksave.
- Me Haensel në përallat e vëllezërve Grimm.
- Vihen për të mbyllur.
- Janë vegla.
- Eshhtë medalja e të parit.
- I dhimbset frikacakut.
- Mund të jetë mbi xhiro.
- Eshhtë llahtar.
- Janë inate të akumuluar
- Eshhtë vëlla i gruas.
- Një tip për të këcyer.
- Edoardo piktor.
- Lumë në Francë.
- Janë djemtë e... nënës.
- Lindi Aklilin.
- Kodi i celularit.
- Mbledh basket separatistë
- Një është edhe Egjeu.
- Fillojnë një metodë.
- Dy anët e një neni.
- Fillojnë ofensivën.



**Gjeni ndryshimin**



Dy figurat kanë ndryshime nga njëra-tjetra



Përgjigja, ja cilat janë ndryshimet e figurave

**SUDOKU**

7				4	9		6
2	9	3		8	5		
		6	3			5	
8	2	1		6			
9	5						
3				9	2		4
	3	8			1		
1		7	4		3	6	
			1	5		4	

Plotësoni vendet bosh në mënyrë që çdo kolonë të ketë numrat nga 1-9

**Përgjigje e sudokut të numrit të kaluar**

8	1	9	7	2	4	6	5	3
2	6	3	5	8	9	4	7	1
7	4	5	1	3	6	8	2	9
5	9	8	6	1	2	7	3	4
6	7	2	8	4	3	9	1	5
1	3	4	9	5	7	2	6	8
9	5	1	2	6	8	3	4	7
3	8	6	4	7	5	1	9	2
4	2	7	3	9	1	5	8	6

*Argëtim filozofik*

- Gjëja më e vështirë për t'u parë është ajo që ke para syve.
- Njeriu të zgjaur i duket çdo gjë qesharake, njeriu të ndjeshëm i duket çdo gjë e rëndë.
- Ai që zë vendin e parë rrallë e luan rolin kryesor.
- Besoj vetvetes dhe do të dish të jetosh.
- Më i zoti i njerëzve është ai që është i zoti ta përmbajë vetveten!

**KRIPTOSKEME**

**KRIPTOSKEME**  
Përgjigja e numrit të djeshëm

2	11	2	11	1	7	1	13	4	1	3
4	6	2	15	1	3	6	4	1	3	6
5	2	7	8	7	2	11	1	8	1	3
17	1	13	6	12	9	5	1	3	5	5
17		1	7	9	13	9	12	6	2	4
5	2	8	9	7	1	12	1	3	11	1
2	13	3	1	13	2	2	3	2	2	15
13	2	13	3	1	16	3	8	2	5	2
7	13	1		6	6	8	6	5	1	3
6	15	2	13	2	7	2	1	7		
15	2	16	3	6	2	17	2	3	6	

K	A	N	T	D	I	S	K	E	T	A	T
A	R	M	I	K	S	T	O	L	I	T	E
N	I	O	R	O	M	I	N	A	T		
T	U	C	A	B	A	R	E	T	L	A	
A	B	A	T	E	R	I	T	E	A	R	
T	R	I	M	E	R	I	T	E	A	N	E
A	R	T	U	R	O	U	I	M	A	T	T
A	A	R	S	E	N	E	A	A			
P	A	I	T	M	E	T	R	I	A	C	
D	U	A	L	I	T	E	T	I	E	R	
L	E	C	I	L	I	N	D	U	K		

**PËRGJIGJET E FJALËKRYQVE TË NUMRIT TË KALUAR**

**FJALËKRYQI (1)**

HORIZONTAL

1. NIVEN QË QË AKTO: **REKLA**

5. LITTLE... KRYEQYTETI I ARKANSAS: **LITTLE ROCK**

7. JANË TEK NË LAKËR: **WORMS**

10. NUK KA AKOMA NËJË BEBE: **INFANT**

11. KUFIZOJNË KATETE: **EDGES**

12. PENN AKTOR: **PENN**

13. HECTOR QË SHKROI PA FAMILJE: **HECTOR BARTELEME**

17. THAHEN ME BONIFIKIME: **DISCOUNT**

18. MBYLLIN TAKIMIN: **CLOSURE**

19. NDËRMARRJE INDUSTRIALE MAT: **MATRIAL**

21. MBYLLEN ME EPILOP: **EPILEPSY**

23. TREGOHEN INDIFFERENTË DHE ASPAK TË GJALLË: **INDIFFERENT**

25. ISHIN SANDALET E LËKURËKUQVE: **RED SHOES**

27. NJËLLJO PËR LATINË: **LATIN**

30. ESHËTË VEND SI KATARI: **QATAR**

31. PUPI REGJISOR: **PIPPIN**

32. JANË STRËHAT E ÇOBANËVË: **GOAT**

33. ESHËTË CENTRALI SI CHERNOBYL: **REACTOR**

35. FILLOJNË NËJË ARGUMENT: **DISCUSS**

36. TË PARAT NË STADIUM: **STADIUM**

**FJALËKRYQI (2)**

HORIZONTAL

1. E BARDHË AJO MOBY DICK: **WHITE-JACKET**

5. FILLOJNË AMPLIFIKIMIN: **AMPLIFY**

7. ESHËTË VIT QË PARASHIKOHET: **FORECAST**

11. MBYLLIN PAMJEN: **CLOSURE**

11. U PRINTË JENIÇERËVË: **JEAN COCTEAU**

13. THURMAN AKTO: **JEAN MARCUS**

14. NJË REAKSION NË PROVËZ: **PROTEST**

16. NJË SPORT ME BREZ TË ZI: **BLACK-BELT**

19. NË FUND TË FUNDIT: **END**

20. JANË NË GJYQ: **TRIAL**

23. I ESHËTË HEQUR TË DËNUARIT: **ACQUITTED**

24. ESHËTË SHAHU I FUNDIT: **LAST MOVE**

25. JANË FLETË TRËNDAFIL: **ROSE PETALS**

27. KUFIZOJNË NËJË METËR: **METER**

28. TREGOJNË PALLATE NË MINIATURË: **MINIATURE**

29. NJË FJALË PA SHKAK: **WHOLE**

30. JANË PËRLOGARITJE: **LOGIC**

32. MBYLLIN NËJË DRITARE: **CURTAIN**

33. TË PARAT NË MUZG: **IN THE DARK**

34. ME TË NXJERRIN NËJË LETËR: **LETTER**

35. JANË ME NGJYRA TË TILLA SI TUNXHI: **RAINBOW**

37. TOROMANI BALERMË: **TOROMAN**

39. INICIALET E REITMAN REGJISOR: **REITMAN**

40. FILLOJNË POLITIKËN: **POLITICS**

42. NJË PIKTOR SI ANTONIO LIGABUE: **LIGABUE**

44. DIFONG NË DIETË: **DIET**

46. NJË LIND NË KOKË: **HEADACHE**

48. KUSH KA... DO TË PIJË: **DRINK**

49. PUNOJNË NË GALERI: **GALLERY**

52. FILLOJNË TITRAT: **TITLES**

53. MUND TË JETË EKSPRES: **EXPRESS**

54. MUND TË SKADOJË: **WITHER**

55. SHARIF AKTOR: **SHARIF**

59. JANË ORGANET E TAKSAVE: **TAXES**

12. ME HAENSEL NË PËRRALLAT E VËLLEZËRVE GRIMM: **GRIMM**

15. VIHEN PËR TË MBYLLUR: **CLOSE**

17. JANË VEGLA: **VEHICLE**

18. ESHËTË MEDALJA E TË PARIT: **MEDAL**

21. I DHIMBSET FRIKACKAKUT: **FRODO BAGGINS**

22. MUND TË JETË MBI XHIRO: **OVERHEAD**

26. ESHËTË LLAHTAR: **LAZARUS**

28. JANË INATE TË AKUMULUAR: **ACCUMULATED**

30. ESHËTË VËLLA I GRUAS: **SISTER**

31. NJË TIP PËR TË KËCYER: **TRICK**

33. EDOARDO PIKTOR: **EDOARDO**

36. LUMË NË FRANCË: **LOIRE**

38. JANË DJEMTË E... NËNËS: **SONS**

41. LINDI AKLILIN: **AKILIN**

43. KODI I CELULARIT: **PHONE**

45. Mbledh basket separatistë: **SEPARATIST**

47. NJË ESHËTË EDHE EGJEU: **EGYPT**

49. FILLOJNË NËJË METODË: **METHOD**

50. DY ANËT E NËJË NENI: **PARAGRAPH**

51. FILLOJNË OFENSIVËN: **OFFENSIVE**

*Thënie të mençura*

- Tregohu aq i fortë në veprime, sa je në mendime (William Shakespeare)
- Imagjinata i është dhënë njeriut për të kompensuar atë që ai nuk është, dhe një sens humori për të ngushëlluar veten për atë që është (Oscar Wilde)
- Nëse në botë do të kishte një numër më të madh njerëzish që dëshirojnë më shumë lumturinë e tyre se sa jo-lumturinë e të tjerëve, do të jetonim në parajsë tani (Bertrand Russell).

